

PASOJAT JURIDIKE TË SHKURORËZIMIT
VËSHTRIM KRAHASUES: KOSOVË-SHQIPËRI

Nga:

Nehat Idrizi

Dorëzuar:

Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Juridik, me profil E
DREJTA CIVILE, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor:

Prof. Asoc. Dr. Endira Bushati

Numri i fjalëve: 53.747

Tiranë, Dhjetor 2018

DEKLARATA E AUTORESISË

Unë i nënshkruari Nehat Idrizi, bazuar në Urdhrin nr. 105, datë 23.03.2012 të ministrit të Arsimit dhe të Sportit të Republikës së Shqipërisë, për miratimin e rregullores “Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese”, deklaroj në dijeninë time të plotë se punimi i doktoratës “Pasojat juridike të shkurorëzimit” është punë origjinale e përgatitur nga unë. Kjo temë, si punë e bazuar mbi rastet praktike, në konsultimin dhe studimin e literaturës së gjerë shkencore, prezantohet për herë të parë si kërkim në kuadër të marrjes së gradës shkencore “Doktor” pranë Universitetit European të Tiranës. Çdo pjesë e këtij punimi respekton rregullore mbi të drejtën e autorit dhe të gjitha referimet ndaj autorëve, rasteve gjyqësore apo vendimeve gjyqësore, raportet e ndryshme, shënimet e tjera statistikore dhe punimet shkencore apo artikuj të ndryshëm, janë përcjellë me citime të sakta dhe adekuate, sipas rregullave përkatëse. Punimi i doktoratës është rezultat i punës kërkimore dhe shkencore të kandidatit dhe aty zbatohet me saktësi ligji mbi të drejtat e autorit.

© **Nehat IDRIZI**

ABSTRAKT

Martesa është institucioni juridik më i lashtë dhe më i rëndësishëm shoqëror dhe juridik. Martesa ka rëndësi të madhe dhe disa qëllime kryesore. Ajo është bazë e familjes dhe ka për detyrë të kryejë funksione të shumta shoqërore, në ngritjen dhe vetëdijesimin e brezave të rinj. Pikërisht për shkak të karakterit shoqëror dhe rëndësisë që ka, ajo është vënë nën përkujdesjen dhe mbrojtjen shtetërore dhe shoqërore. Pra, martesa është institucion juridik i rregulluar kryesisht me dispozita urdhëruese. Zgjidhja e saj mund të bëhet me dispozitat e parashikuara ligjore.

Ashtu siç ekzistojnë kushte ligjore për lidhjen e martesës, ekzistojnë edhe dispozita të veçanta për zgjidhjen e saj. Mënyrat e zgjidhje së martesës janë të parashikuara një nga një me dispozita ligjore dhe ato janë: vdekja e njërit bashkëshort, shpallja e njërit bashkëshort i zhdukur, shkurorëzimi (zgjidhja gjyqësore e martesës së vlefshme) dhe anulimi i martesës (mënyrë e vetme e mbarimit të martesës së pavlefshme).

Pra njëra nga format e shuarjes së martesës, respektivisht shuarjes së martesës së vlefshme, është shkurorëzimi. Me shkurorëzimin e martesës paraqiten një varg pasojash juridike, të cilat mund të jenë si pasoja të natyrës personale juridike, ashtu edhe pasoja të natyrës pasurore, për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët bashkëshortore.

Pasojat juridike pasurore kanë të bëjnë me mbarimin e regjimit pasuror martesor, ndërsa pasojat juridike jo-pasurore të cilat rrjedhin nga kjo, mund t'i ndajmë në dy grupe themelore: a) pasojat juridike për bashkëshortët, dhe b) pasojat juridike për fëmijët.

Fjalë kyçe: Martesë, shkurorëzim, pasojat juridike, fëmijë, pasurore-jo pasurore.

ABSTRACT

Marriage is an ancient juridical institution and most important social and legal terms. Marriage has a major importance and serves other main purposes as well. It is fundamental of the family and it is its duty to perform numerous social functions in increasing the awareness of young generations. Precisely, because of the social nature and importance of marriage, marriage it is placed under state and social care and protection. Hereupon, marriage is a juridical institution regulated mainly by mandatory provisions, and also its dissolution it is regulated by legal provisions foreseen in law.

Just as there are legal conditions regarding marriage, there are also special provisions regarding the dissolution of the marriage. Forms of dissolution of marriage are foreseen one by one, by legal provisions and these forms are: Death of the spouse, declared the spouse as missing person, divorce (judicial dissolution of valid marriage) and marriage annulment (the only form of termination of the invalid marriage).

So, one of the forms of termination of marriage, namely suppression of valid marriage is divorce. Divorce induces a range of legal consequences, which may be consequences of personal legal nature and consequences of monetary nature, all this because of the interruption of conjugal life.

Legal monetary consequences are followed with the monetary marriage regime, whereas non-monetary legal consequences can be divided into two basic groups: a) legal consequences for spouses, and b) legal consequences for children.

Key words: marriage, divorce, legal consequences, children, monetary-non-monetary.

DEDIKIM

Ky punim i kushtohet familjes sime, që më ka përkrahur në çdo sfidë dhe në çdo kohë. Ai iu kushtohet edhe prindërve të mi, nga të cilët trashëgova dhe mora gjithçka për t'u bërë ky që jam.

FALËNDERIME

Punimi për mbrojtjen e disertacionit “Pasojat juridike të shkurorëzimit” nuk do ishte bërë i mundur pa ndihmën e palodhur, të pakursyer dhe përkushtimit maksimal të udhëheqësit tim shkencor, që në vazhdimësi më ka dhënë përkrahje në krijimin e ideve frytdhënëse dhe opinioneve të zgjeruara, në lidhje me grumbullimin e materialit shkencor dhe mënyrës së shtjellimit të punimit. Punimi nuk do të kishte dalë në dritë pa mbështetjen e vazhdueshme, udhëzimet dhe këshillat profesionale të profesorit gjatë gjithë fazës së punimit; që nga grumbullimi i materialit, konsultimet e vazhdueshme, deri në fazën e strukturimit përfundimtar. Për këtë arsye, këtë punim e quaj si produkt të përbashkët timin si kandidat për gradën “Doktor” dhe udhëheqësit tim shkencor Prof. Asoc. Dr. Endira Bushati.

Të parealizuara, ose vetëm një ëndërr do të mbeteshin synimet e mia për ngritjen profesionale dhe akademike, pa ndihmën e profesorit, sukseset dhe virtytet e të cilit kanë qenë frymëzim për vazhdimin e karrierës time si jurist.

Një falënderim të veçantë edhe për familjen time, për qëndrimet koherente të shfaqura në përkrahje të realizimit të synimeve të mia profesionale. Sido që iu kam munguar në shumë momente të bukura, familja ime ka qenë gjithmonë e vetëdijshme dhe e mirëkuptuese për mundin, që duhet, për të realizuar një punim të këtij niveli.

Me gjithë lodhjen dhe kohën që më është dashur për punimin e disertacionit, përfundimi i tij më ka dhënë kënaqësi, e cila buron nga ngritja ime e mëtejshme profesionale e akademike; nga pasurimi me informacione dhe përvoja, të cilat, padyshim, do t'i përcjell edhe te studentët tanë në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës me qëllim nxitjen e debateve doktrinarë për legjislacionin civil.

Gjithashtu një falënderimi madh i takon edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, anëtarët e të cilët më kanë lejuar të kem qasje në dosjet gjyqësore në gjykata, në arkivat e gjykatave dhe komunikim të lirshëm e të papenguar me personelin tjetër gjyqësor, për sigurimin e materialit të nevojshëm studimor.

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI I: HYRJJE

1. Struktura e punimit.....	3
2. Qëllimi dhe rëndësia e studimit.....	4
3. Pyetjet kërkimore.....	5
4. Hipotezat.....	6
5. Metodologjia.....	7
6. Përparësitë dhe kufizimet.....	8

KAPITULLI II: VËSHTRIM HISTORIK MBI INSTITUTIN E MARTESËS

2.1 Instituti i martesës në Romën e Lashtë.....	9
2.2 Instituti i martesës gjatë shekujve.....	10
2.3 Vështrim historik në Kosovë.....	12
2.4 Vështrim historik në Shqipëri.....	14
2.5 Ndikimet fetare dhe kanonike në Kosovë e në Shqipëri	17

KAPITULLI III: ZGJIDHJA E MARTESËS DHE PASOJAT JURIDIKE TË SHKURORËZIMIT

Aspekti Krahësimor Kosovë / Shqipëri

3.1 E drejta martesore, objekti dhe subjektet e të drejtës martesore.....	18
3.1.2 Objekt i të drejtës martesore	19
3.1.3 Subjektet e të drejtës martesore	19
3.1.4 Kuptimi i martesës.....	19
3.1.5 Fejesa.....	21
3.2 Roli aktiv i gjykatës, kushtet dhe procedura e shkurorëzimit.....	22
3.3 Kuptimi, llojet e të drejtave dhe të detyrimeve të bashkëshortëve.....	30
3.3.1 Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje.....	31
3.3.2. Të drejtat dhe detyrat personale, për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.....	33
3.4 Parimet e procedurës në kontestet martesore.....	34
3.5 Mënyrat e shkurorëzimit.....	36

3.5.1 Propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje.....	36
3.5.2 Shkurorëzimi i njëanshëm apo me padi.....	38
3.5.3 Tërheqja e padisë.....	39
3.6 Kundërpadia.....	40
3.7 Fazat e procedurës së shkurorëzimit.....	40
3.7.1 Procedura e përpjekjes së pajtimit të bashkëshorteve	41
3.7.2 Caktimi i masave të përkohshme.....	45
3.7.3 Shqyrtimi kryesor.....	47
3.7.3.1 Përjashtimi i publikut.....	49
3.7.3.2 Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm.....	49
3.7.4 Marrja e aktgjykimit.....	50
3.8 Mënyra e vendosjes në procedurën e shkurorëzimit dhe mjetet e goditjes.....	50
3.9 Rastet nga praktika gjyqësore në Kosovë.....	52
3.10 Rastet nga praktika gjyqësore në Shqipëri.....	53
3.11 Shqyrtim i të dhënave statistikore lidhur me numrin e shkurorëzimeve, lëndëve të bartura, të pranura, të zgjidhura dhe të pazgjidhura rreth zgjidhjes së martesës në Republikën e Kosovës.....	54
3.12 Pasojat e zgjidhjes së martesës.....	55
3.12.1 Regjimi pasuror i bashkëshortëve.....	56

KAPITULLI IV: PASOJAT JURIDIKE PASUORE TË SHKURORËZIMIT

Aspekti Krahësimor Kosovë / Shqipëri

4.1 Pasojat juridike pasurore në kontestet martesore.....	64
4.2 Llojet e pasurisë së bashkëshortëve.....	64
4.2.1. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve.....	65
4.2.2 Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve.....	65
4.3 Të drejtat e bashkëshortëve mbi pasurinë e patundshme.....	68
4.3.1 Administrimi i pasurisë së përbashkët	69
4.3.2 Marrëdhëniet pasurore, jashtëmartesore, të bashkëshortëve	71
4.4 Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.....	71
4.4.1 Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nga ana e gjykatës	72
4.4.2 Kriteret për vlerësimin dhe llogaritjen e kontributit të bashkëshortëve.....	74
4.4.2.1 Vlerësimi i kontributit për punët e amvisërisë.....	75

4.5 Raste nga praktika gjyqësore.....	76
4.6 Kthimi i dhuratave.....	77
4.7 E drejta e banesës.....	78
4.8 E drejta e trashëgimisë.....	78
4.9. E drejta dhe detyrimi i ushqyerjes së fëmijëve.....	81
4.10 Mbajtja financiare dhe ushqimi	84
4.10.1 Kushtet për caktimin e masës së ushqimit.....	86
4.10.2 Pushimi i të drejtës për ushqim.....	87
4.11 <i>Vendimi ex officio i gjykatës</i>	88
4.11.1 Parimet për caktimin e alimentacionit	89
4.11.2 Mospagimi i detyrimit ushqimor.....	90

KAPITULLI V: PASOJAT JURIDIKE JOPASUORE TË SHKURORËZIMIT

Aspekti Krahësor Kosovë / Shqipëri

5.1. Pasojat juridike jopasurore për bashkëshortët.....	91
5.1.1. Statusi martesor pas zgjidhjes së martesës.....	91
5.2 Mbiemri.....	92
5.2.1 Raste nga praktika gjyqësore.....	93
5.3. E drejta e lidhjes sërish të martesës.....	94
5.4. Pasojat që rrjedhin nga statusi martesor edhe pas zgjidhjes së martesës.....	94
5.4.1 Zotësia për të vepruar e fituar me martesë.....	94
5.5. Pasojat juridike të zgjidhjes së martesës për fëmijët e përbashkët.....	95
5.5.1. Kujdestaria e fëmijëve në rastin e shkurorëzimit.....	95
5.5.2 Dhënia e fëmijës te njëri prind.....,.....	97
5.5.3 Kujdestaria ndaj fëmijës te një personi tretë.....	99
5.5.4 Roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën e dhënies së kujdestarisë për fëmijën.....	102
5.6. Kontaktet personale.....	104
5.6.1 Mosrealizimi i të drejtës së kontaktit.....	107
5.6.2 Mosdhënia e prokurës apo pëlqimit.....	108
5.7 Rastet nga praktika gjyqësore.....	108
5.8 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit.....	110
5.9 Parimet për mbrojtjen e fëmijëve gjatë shkurorëzimit.....	121

KAPITULLI VI: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM KRAHASUES KOSOVË-SHQIPËRI

6.1 Aspektet krahasuese të rregullimit ligjor në Kosovë dhe Shqipëri.....	124
6.1.1 Mbiemri.....	124
6.1.2 Fejesa	125
6.1.3 Pasojat e zgjidhjes së martesës	125
6.1.4 Interesat e fëmijëve	125
6.1.5 Masa mbrojtëse për bashkëshorten dhe fëmijët.....	126
6.1.6 Kujdestaria ndaj fëmijëve	126
6.1.7 Detyrimi Ushqimor dhe e drejta e kontaktit	126
6.1.8 Mbajtja financiare	127

KAPITULLI VII: VËSHTRIM KRAHASUES MIDIS SHTETEVE ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN

7.1 E drejta martesore në Bashkimin European	128
7.2 E drejta martesore në Francë.....	129
7.3 E drejta martesore në Gjermani	132
7.4 E drejta martesore në Itali	133
7.5 E drejta martesore në Angli dhe Uells	135
7.6 Martesa midis çifteve homoseksuale: perspektiva europiane.....	136

KAPITULLI VIII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIMET

7.1 Përfundime.....	138
7.2 Rekomandime	141

BIBLIOGRAFIA	145
--------------------	-----

GRAFIKË

Grafiku nr. 1 Shkurorëzimet sipas viteve, lëndët e pazgjidhura, të pranuar si dhe mënyra e vendosjes për vitet 2012-2016

Grafiku nr. 2 Lëndët e bartura–të trashëguara nga periudha paraprake e viteve 2012-2016

Grafiku nr. 3 Lëndët e pranuar sipas viteve 2012-2016

Grafiku nr. 4 Lëndët e zgjidhura sipas viteve 2012-2016

Grafiku nr. 5 Mënyra e lëndëve të zgjidhura – në rastet kur nuk është kontestuar padia

Grafiku nr. 6 Rastet e zgjidhura në mungesën e të paditurit

Grafiku nr. 7 Rastet e zgjidhura në të cilat është aprovuar kërkesëpadija e paditësit

Grafiku nr. 8 Rastet e zgjidhura në të cilat është refuzuar kërkesëpadija e paditësit

Grafiku nr. 9 Rastet e zgjidhura me marrëveshje të bashkëshortëve

Grafiku nr. 10 Rastet e zgjidhura me hedhjen poshtë të padisë

Grafiku nr. 11 Rastet e zgjidhura me tërheqjen e padisë

Grafiku nr. 12 Rastet e zgjidhura me ndërprerje të procedurës

Grafiku nr. 13 Rastet e zgjidhura në mënyrë tjetër

TABELA

- Tabela 1. Fillimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, mosha e bashkëshortëve, kujdestaria ndaj fëmijëve.
- Tabela 2. Fillimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, mosha e bashkëshortëve, kujdestaria ndaj fëmijëve.
- Tabela 3. Përkatësia gjinore e paditësve, kohëzgjatja e martesës, jetesa në fshat apo në qytet, mosha e paditësve, marrëdhëniet e punës dhe vendimet gjyqësore.
- Tabela 4. Përkatësia gjinore e trashëgimlënësit, trashëgimtarëve , heqja dorë nga trashëgimia.
- Tabela 5. Përkatësia gjinore e paditësve, kohëzgjatja e martesës, jetesa, statusi i punës dhe vendimet gjyqësore.
- Tabela 6. Fillimi procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, besimi i fëmijëve, si dhe ruajtja apo kthimi i mbiemrit.
- Tabela 7. Fillimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, kujdestaria ndaj fëmijëve, caktimi i detyrimit ushqimor, kontakti i fëmijës me prindin dhe mosha e fëmijëve.

LISTA E SHKURTIMEVE:

DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KCF	Kodi Civil i Francës
KCI	Kodi Civil i Italisë
KCSH	Kodi Civil i Shqipërisë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore
KFSH	Kodi i Familjes i Shqipërisë
KLD	Kanuni i Lekë Dukagjinit
KRK	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
KRSH	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
LFK	Ligji për Familjen i Kosovës
LPDTS	Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës
LPJK	Ligji për procedurë jokontestimore i Kosovës
LPK	Ligji për procedurë kontestimore i Kosovës
RFSJ	Republika Federative Socialiste e Jugosllavisë

KAPITULLI I: HYRJE

Dukuria e shkurorëzimit është bërë një ndër temat me interes të studimit, si nga aspekti social, psikologjik, ashtu edhe ai ligjor. Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirisht vendosin të jetojnë së bashku me qëllim krijimin e familjes.¹

Nga aspekti juridik, martesa cilësohet si bashkëjetesë e vazhdueshme e burrit dhe e gruas, e rregulluar me norma juridike. Ndërsa familja, si institucion juridik, është një bashkësi apo bashkim i personave të lidhur në martesë dhe gjini, midis të cilëve ekzistojnë të drejta dhe detyrime të caktuara.²

Ashtu siç ekziston e drejta e lidhjes së martesës, po ashtu ekziston edhe e drejta e zgjidhjes së saj, veprim i cili bëhet kryesisht me anë të shkurorëzimit. Nga aspekti ligjor kjo është një e drejtë e të dy bashkëshortëve (burrit dhe gruas), mirëpo si e drejtë ligjore, shkurorëzimi mbart edhe pasojat e tij juridike personale dhe pasurore në mes të bashkëshortëve dhe fëmijëve.

Shkurorëzimi është zgjidhje e martesës se vlefshme, gjatë jetës së bashkëshortëve për shkaqe të parashikuara me ligj dhe me procedurë ligjore, me aktgjykim të gjykatës.³ Në dallim nga legjislacioni kosovar, i cili përdor shprehjen: “Shuarja e Martesës” {ku përfshihet edhe shkurorëzimi}; Kodi i Familjes i Shqipërisë (KFSH) përdor shprehjen: “Përfundimi i Martesës” që do të thotë se martesa përfundon: me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort, ose me zgjidhjen e martesës së tyre.⁴ Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm me padi private, e paraqitur në gjykatë nga ndonjëri bashkëshort; ose, të dy bashkëshortët bashkërisht mund të parashtrajnë propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje. Zgjidhja e martesës bëhet në ato raste kur plotësohen kushtet, apo shkaqet e parashikuara në Ligjin për Familjen të Republikës së Kosovës (LFK).

¹ Ligji për Familjen i Kosovës, Neni 14, paragrafi 1.

² Dr. Syrja Pupovci, Përmbledhje Punimesh, Fakulteti Juridike në Prishtinë, Prishtinë, 1977, f. 9

³ Podvorica Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011, f.118

⁴ Kodi i Familjes i Shqipërisë, Neni 123

Meqenëse interesi shoqëror është që të ruhet bashkësia martesore, veçanërisht në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë, me qëllim që të mbrohet interesi i fëmijëve, mbajtja e seancës së tentim pajtimit të bashkëshortëve ka një rëndësi të dorës së parë. Gjatë procedurës së shkurorëzimit rëndësi të veçantë ka edhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve të mitur, e cila parashikohet me LFK. Po ashtu edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, zbatohet drejtpërsëdrejti në territorin e Republikës së Kosovës. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës përmban disa dispozita lidhur me gjykimin e rasteve familjare të cilat prekin të drejtat e fëmijëve. Dispozitat e Konventës parashikojnë se “autoritetet duhet të respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri, apo të dy prindërit, për të mbajtur marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit rregullisht, përveç rastit kur kjo është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës.”⁵

Në kontestet martesore gjykata është e detyruar që përgjatë gjithë procedurës të tentojë të arrijë pajtimin formal të bashkëshortëve.⁶

Gjatë procedurës së shkurorëzimit, gjykata me aktvendim mund të caktojë masat e përkohshme për detyrimin e ushqimit, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur. Aktvendimi mbi masën e përkohshme mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës.

Me rastin e shkurorëzimit, në bazë të kriterit të objektit lindin edhe dy llojet e pasojave: pasojat personale pasurore dhe ato jopasurore.

⁵ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Neni 9

⁶ Neni 77, paragrafi 1 i LFK-së

1. Struktura e punimit

Struktura e punimit është ndarë në shtatë kapituj, përmbajtja e të cilëve vijon si më poshtë:

Kapitulli i parë, i titulluar “Hyrje”, përmbledh arsyet e studimit të këtij institucioni të së drejtës familjare, duke u përqendruar te Qëllimi i studimit dhe Rëndësia e tij. Më tej janë përfshirë pyetjet kërkimore dhe hipotezat, të cilat kanë qenë si pikënisje për kërkimin shkencor të këtij studimi, metodat e kërkimit, përparësitë dhe kufizimet e punimit si dhe mënyra e strukturimit të tij.

Kapitulli i dytë i titulluar, “E Drejta Martesore”, përfshin objektin dhe subjektet e së drejtës martesore, martesën dhe fejesën, trajtimin historik të martesës, llojet dhe martesën religjioze e më tej, ndikimin e të drejtës kanonike dhe sheriatit. Vazhdon me Kodin Civil francez dhe italian; vështrimin historik në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve: ato për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje dhe ato për të cilat ata mund të bëjnë marrëveshje.

Kapitulli i tretë: “Zgjidhja e martesës dhe pasojat juridike të shkurorëzimit”, shtjellon rolin aktiv të gjykatës, kushtet dhe procedura e shkurorëzimit. Të drejtat dhe detyrat personale, për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje, si dhe për ato të cilat nuk mund të bëjnë marrëveshje; parimet e procedurës, mënyrat e zgjidhjes së martesës, fazat e procedurës së shkurorëzimit, mjetet e goditjes. Gjithashtu janë paraqitur edhe shembuj nga praktika gjyqësore lidhur me mënyrat e zgjidhjes së martesës. Në fund, janë paraqitur pasojat e zgjidhjes së martesës, si dhe pasojat e shkurorëzimit sipas Kodit Civil të Shqipërisë të vitit 1929.

Kapitulli i katërt: “Pasojat juridike pasurore të shkurorëzimit”, paraqet pasojat juridike pasurore të bashkëshortëve, të pasurisë së veçantë dhe të përbashkët, administrimin e pasurisë, pjesëtimin e pasurisë, kriteret dhe llogaritjen e kontributit; kthimin e dhuratave, të së drejtës së banesës, të së drejtës në trashëgimi, në ushqim, si dhe rastet nga praktika gjyqësore. Temat trajtohen në vështrimin krahasues Kosovë / Shqipëri.

Kapitulli i pestë : “Pasojat juridike jopasurore të shkurorëzimit”, paraqet pasojat juridike jopasurore, mbiemrin, të drejtën e lidhjes së bashku të martesës. Më tej, pasojat juridike për fëmijët e përbashkët, besimi i tyre, kontaktet personale me fëmijët, roli i Organit të Kujdestarisë, rastet nga praktika gjyqësore dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Temat trajtohen në vështrimin krahasues Kosovë / Shqipëri.

Kapitulli i gjashtë: “Legjislacioni kosovar dhe ai shqiptar- vështrim krahasues i përgjithshëm”, paraqet aspektet krahasuese të rregullimit ligjor në Kosovë dhe Shqipëri.

Kapitulli i shtatë : “Vështrim Krahasues me shtetet anëtare të BE-së” , i cili trajton pasojat juridike të shkurorëzimit në shtetet : Francë, Gjermani, Itali dhe Angli & Uells.

Kapitulli i tetë: “Përfundime dhe Rekomandime”, jep përfundimet dhe rekomandimet për ndryshimin e legjislacionit kosovar dhe atij shqiptar, si dhe tregon veprimet që duhet të ndërmerren për përmirësimin e pozitës së gruas dhe fëmijëve, veprime të cilat kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e tyre.

2. Qëllimi dhe rëndësia e studimit

Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i pasojave juridike të shkurorëzimit e në veçanti pasojat juridike për gratë dhe fëmijët, në kontestet e shkurorëzimit e sidomos realizimi i të drejtave të tyre.

Gjatë punimit të kësaj teme do të angazhohemi të japim përfundime për përmirësimin e punës së gjykatave në rastin e zbatimit të procedurës së shkurorëzimit e, në veçanti, të pasojave juridike si dhe studimin e rasteve nga praktika gjyqësore e gjykatave të Kosovës, në mënyrë që të identifikohen zgjidhjet më të përshtatshme në raport me këtë institucion si dhe të jepen rekomandimet konkrete. Në këtë punim është me rëndësi analizimi dhe studimi i detajuar i kuadrit ligjor si dhe i qëndrimeve të teorisë juridike dhe praktikës gjyqësore, posaçërisht në aspektin që i referohet mënyrës së zgjidhjes së saj, procedurës që zhvillohet si dhe pasojave personale dhe pasurore që rrjedhin nga shkurorëzimi për bashkëshortët dhe fëmijët.

Studimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë, për faktin se numri i madh i shkurorëzimeve shkakton pasoja të mëdha në raportet familjare, sidomos në mes të bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre.

Po ashtu, me anë të punimit synohet të bëhet një analizë krahasuese e ligjeve përkatëse Kosovë-Shqipëri, në mënyrë që të jepen rekomandimet për përmirësime legislative, të cilat në mënyrë më efikase dhe përmbajtësore do të rregullojnë pasojat juridike të shkurorëzimit. Gjyqësori i Kosovës është kritikuar, si nga Organizatat e ndryshme vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare se nuk ndërmerr masa të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të gruas dhe fëmijëve. Ky punim do të paraqesë një bazë të mirë për institucionet, veçanërisht për gjykatat, në mënyrë që ato të ndërmarrin veprimet e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fëmijëve, në rastin e shkurorëzimit të bashkëshortëve.

3. Pyetjet kërkimore

Duke pasur parasysh çështjet e theksuara dhe qëllimin e këtij punimi, i cili ka për synim të bëjë një prezantim në aspektin krahasues mes dy legjislacioneve, për sa i përket pasojave juridike të shkurorëzimit, shtrohen këto pyetje:

Pyetje kërkimore:

1. A është diskriminues Kodi i Familjes i Shqipërisë në aspektin gjinor, atëherë kur përcakton pasojat juridike të shkurorëzimit, në lidhje me mbiemrin e fëmijës?
2. A e rregullon Ligji i Familjes i Kosovës, regjimin kontraktues martesor, i cili ndikon në pasojat juridike pasurore të shkurorëzimit?
3. Cili prej ligjeve objekt krahasimi mbron më shumë gruan shtatzënë në procedurën e shkurorëzimit?
4. Si e kanë të rregulluar ligjet objekt-aspekt krahasimi, çështjen e ushqyerjes së njërit prej bashkëshortëve pas shkurorëzimit?
5. A ka dallime në legjislacionet përkatëse në lidhje me rrethin e personave që mund të vazhdojnë procedurën për shkurorëzim?

4. Hipotezat

Rreth pyetjeve kërkimore shtrohen këto hipoteza:

1. Kodi i Familjes i Shqipërisë paraqitet diskriminues në aspektin gjinor, në lidhje me pasojat juridike të shkurorëzimit që kanë të bëjnë me mbiemrin e fëmijës. Kjo për faktin se KFSH, në rastin e mospajtimeve në mes të bashkëshortëve, për caktimin e mbiemrit të fëmijës, i jep përparësi mbiemrit të babait; në dallim prej zgjidhjes ligjore së ofruar në LFK, sipas së cilës, në rastin e mosmarrëveshjeve në mes të bashkëshortëve lidhur me mbiemrin e fëmijës, fëmija nuk merr automatikisht mbiemrin e babait, por mbiemri caktohet në procedurën administrative të Organit të Kujdestarisë.
2. Ligji i Familjes i Kosovës paraqitet i mangët në lidhje me regjimin kontraktues të pasojave juridike të shkurorëzimit. Në këtë drejtim LFK paraqitet jo i plotë, sepse nuk rregullon një materie të rëndësishme të raporteve juridiko-pasurore të bashkëshortëve.
3. Ligji i Familjes i Kosovës përcakton mbrojtje më përmbajtësore të gruas shtatzënë në procedurën e shkurorëzimit. Me këtë parashikim ligjor LFK tenton të ruajë martesën, si një prej institucioneve më të rëndësishme në vend. Periudha e shtatzënisë dhe ajo një vjeçare nga lindja e fëmijës do t'u japë rast bashkëshortëve të rregullojnë marrëdhëniet e tyre personale, sidomos nëse merret parasysh fakti se lindja e fëmijës ndikon detyrimisht në mënyrën se si bashkëshortët e konceptojnë familjen.
4. Në gjyqësorin e Republikës së Kosovës, për dallim prej atij të Shqipërisë, nuk ka ndasi për trajtimin e rasteve familjare. Specializimi i gjyqtarëve në lëmin e të drejtës familjare do të ndikonte që procedurat të zhvillohen pa zvarritje të panevojshme dhe cilësia e vendimeve gjyqësore do të ishte në nivel më të lartë.

Për t'i dhënë përgjigje hipotezës kërkimore të këtij punimi dhe pyetjeve kërkimore, është e nevojshme analiza e detajuar dhe krahasuese e kuadrit ligjor, doktrinës juridike dhe jurisprudencës, mbi aspekte të veçanta të zgjidhjes së martesës si: kushtet për zgjidhjen e martesës, mënyrat dhe aspektet procedurale për zgjidhjen e saj, pasojat personale, pasurore dhe jopasurore ndaj ish-bashkëshortëve dhe marrëdhëniet e tyre me fëmijët.

5. Metodologjia

Punimi është realizuar në bazë të një metodologjie të caktuar, në të cilën janë përdorur teknika të ndryshme.

Identifikimi i problematikave të studimit. Çështjet familjare rregullohen në bazë të ligjeve në fuqi. Në këtë kuadër, edhe Ligji për Familje i Kosovës edhe Kodi i Familjes në Shqipëri, bëjnë një rregullim të caktuar të së drejtës martesore, martesës, rolit të gjykatës, rolit të subjekteve të procedimit në çështjet familjare. Ligji i Familjes në Kosovë është nxjerrë në vitin 2006. Ligji i Familjes përmban një sërë problematikash, të cilat identifikohen dhe shqyrtohen në kapitujt e këtij punimi, duke realizuar kështu një metodë, e cila lejon të nxirren në pah veçoritë për disa prej instituteve më të rëndësishme të procesit në kontestet martesore dhe problemet që hasen gjatë zbatimit praktik të tyre.

Kërkimi doktrinar. Metodë tjetër e rëndësishme e përdorur për realizimin e këtij punimi është ajo e kërkimit doktrinar, zbatimi i së cilës ka bërë të mundur identifikimin, mbledhjen dhe shfrytëzimin e literaturës juridike në këtë fushë, duke përdorur tekste të së drejtës, artikuj, traktate të së drejtës, studime shkencore të autorëve nga fusha e së drejtës familjare vendore dhe të huaj.

Metoda e analizës së legjislacionit. Përmes realizimit të metodës së analizës dhe të sintezës është bërë i mundur identifikimi i problemeve ligjore, gjë që rregullon procesin e shkurorëzimit në Kosovë dhe Shqipëri. Kjo metodë ka shërbyer për t'i interpretuar këto dispozita sipas qëllimit që iu ka dhënë ligjvënës.

Metoda e analizës së praktikës gjyqësore. Zbatimi në praktikë i normave të të drejtës familjare dhe interpretimi i tyre gjyqësor përbëjnë një tjetër metodë kërkimi të këtij punimi. Përmes kësaj metode është bërë i mundur identifikimi i një numri të konsiderueshëm rastesh nga praktika gjyqësore e gjykatave të cilat kanë trajtuar çështje gjyqësore në Kosovë, raste që kanë të bëjnë me proceset familjare e në veçanti me zgjidhjet e martesës dhe pasojave të tyre.

Metoda historike. Aplikimi i kësaj metode synon krijimin e një pasqyre të parashikimeve ligjore për të drejtat në çështjet familjare, duke shqyrtuar dhe trajtuar çështje nga aspekti i të drejtave në etapa të ndryshme të zhvillimit të së drejtës familjare në përgjithësi dhe asaj kosovare dhe shqiptare në veçanti.

Metoda krahasuese. Kjo metodë paraqet mbledhjen e të dhënave lidhur me mënyrat e trajtimit të çështjeve familjare në legjislacionin aktual të Kosovës dhe Shqipërisë.

6. Përparësitë dhe kufizimet

Punimi në fjalë ka përparësitë e veta qoftë në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Nga këndvështrimi teorik, ky studim shqyrton debatin doktrinar në çështjet e veçanta që lidhen me zgjidhjen e martesës, siç janë për shembull; roli i autonomisë së palëve dhe kufizimet në ushtrimin e kësaj autonomie, shkurtimi i afateve në këtë procedurë, roli i palëve në procedurë dhe i organeve kompetente, qasja e organeve kompetente ndaj efekteve të vendimeve me karakter personal dhe pasuror që lidhen me bashkëshortët dhe fëmijët, dhe çështjet tjera.

Analiza e institucionit të zgjidhjes së martesës në veçanti, pasojat juridike të saj, në vështrimin krahasues paraqet zhvillimin aktual të rregullimit normativ të këtij institucioni, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet këtyre dy sistemeve. Në aspektin praktik, punimi shërben si një kontribut për zbatuesit e ligjit në shumë drejtime, duke përfshirë: gjyqtarët, avokatët, ndërmjetësuesit, noterët dhe të tjerë.

KAPITULLI II: VËSHTRIM HISTORIK MBI INSTITUTIN E MARTESËS

Qëllimi i këtij kapitulli është t'i prezantojë lexuesit një analizë të evolucionit të institutit të martesës gjatë shekujve. Fillimisht, analiza e prezantuar në këtë kapitull do të fokusohet konceptin e martesës sipas të Drejtës Romake, duke qenë se kuadri ligjor i shumë shteteve europiane bazohet pikërisht në të Drejtën Romake. Më pas, analiza e përmbajtur në këtë kapitull do të fokusohet në zhvillimin e konceptit të martesës dhe shkurorëzimit ose divorcit ndër shekuj. Në përfundim, do të paraqitet një përmbledhje historike e zhvillimit të dispozitave ligjore të cilat janë të aplikueshme gjatë dhe pas martesës në Shqipëri dhe në Kosovë, duke pasur parasysh edhe influencën që kanë pasur fe të ndryshme mbi zhvillimin e kuadrit ligjor në Shqipëri dhe Kosovë.

2.1 Instituti i martesës në Romën e Lashtë

Në Romën e Lashtë bashkësitë ishin egzogame; meshkujve iu lejohej të martoreshin vetëm me vajza të lindura jashtë rrethit të familjes, ndërsa vajzave, që të martoreshin me meshkuj të grupeve të tjera familjare.⁷ Sipas të drejtës romake, martesë mund të lidhnin vetëm personat që ishin në kohën e pubertetit, respektivisht femrat duhet të kishin së paku moshën dymbëdhjetëvjeçare, ndërsa meshkujt duhet të kishin mbushur moshën katërbëdhjetëvjeçare. Sipas të drejtës romake martesë është përkufizuar si lidhja midis burrit dhe gruas, që përbën bashkësinë e pandarë të jetës.⁸ Me rastin e lidhjes së martesës shtroheshin dy çështje kryesore:

- a) Çështja se në cilat kushte vajza mund ta linte familjen e saj dhe të bëhej pjesëtare e familjes së burrit.
- b) Çështja se çfarë pozite juridike kishte gruaja në familjen e re.

Lidhur me çështjen e parë kanë ekzistuar disa zgjidhje. Kështu, në fillim, kërkohej vetëm pëlqimi i kryetarit të familjes, ndërsa më vonë edhe pëlqimi i bashkëshortëve. Sa i përket çështjes së dytë, gruaja pas martesës bëhej person *alieni juris*, e cila, në mënyrë të ngjashme sikurse edhe personat tjerë në këtë pozitë, u nënshtrohej direkt urdhrave të

⁷ Dr. Ivo Puhani, *E Drejta Romake*, Prishtinë, 1980, f. 179

⁸ Po aty, f. 180

pater familiasi.⁹ Në kohën e formës fetare të lidhjes së martesës, kushtet për lidhjen e martesës ishin të rënda, por me reformat e bëra ndryshuan edhe kushtet dhe ato bëhen gjithnjë e më të volitshme dhe më të lehta për personat që lidhin martesë. Rëndësi të veçantë i kushtojë lirisë së vullnetit të personave që të lidhin martesë.

2.2 Instituti i martesës gjatë shekujve

Përhapja e fesë së krishterë krijoi stimuj për të ruajtur bërthamën familjare.¹⁰ Kisha, si institucioni më i lartë përgjegjës për martesën, vazhdimisht miratonte ligje dhe praktika të cilat kishin si qëllim shfarosjen e martesave fisnore.¹¹ Duke filluar që nga shekulli i katërt, Kisha dekurajonte çdo praktikë, e cila zgjeronte rrethin familjar, si për shembull, adoptimin, poligaminë, divorcin dhe martesat e dyta. Kisha gjithashtu u hoqi prindërve të drejtën të ruanin lidhjet fisnore ndërmjet martesave të parapërcaktuara duke ndaluar martesat për të cilat nusja nuk ishte plotësisht dakord.¹² Këto rregulla nuk u aplikuan në të gjithë Europën por përgjithësisht, sidomos mbas gjysmës së dytë së periudhës mesjetare, bërthama familjare ishte ngushtuar në mënyrë të tillë që përfshinte vetëm burrin, gruan dhe fëmijët dhe ky trend ishte dominues sidomos në Europën Qendrore dhe Perëndimore.¹³ Mbas rënies së Perandorisë Romake, Kisha, në bashkëpunim me shtetin kaluan ligje akoma më rigorozë, qëllimi i të cilave ishte të mos lejonin zgjerimin e bërthamës familjare, një problem i cili kishte marrë dimensione më të mëdha për shkak të rënies së Perandorisë Romake dhe fuqizimit të klaneve të ndryshme në Europë. Duke filluar që nga vitet 800 e më tej, ligjet të cilat rregullonin institutin e martesës kishin si qëllim kryesor shuarjen e konceptit të solidaritetit ndërmjet shoqërisë, pengesën e zhvillimit të një ndërgjegjeje kolektive dhe rrjedhimisht pengesën e zhvillimit të ideve politike në shoqëri.

Pas viteve 1100, fuqia e perandorive europiane ishte konsoliduar në një pikë të tillë që Kisha dhe Shteti e mendonin të panevojshme kontrollin e imët të institutit të martesës. Gjithashtu, në këtë periudhë mund të vihen re fillimet e periudhës së martesës me konsensus.¹⁴ Moshë mesatare e martesës pësoi një rritje të vazhdueshme duke filluar nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë si pasojë e stabilizimit të numrit të popullsisë mbas murtajës

⁹ Po aty, f. 180

¹⁰ Djupe & Gilbert, "The political Influence of Churches" Cambridge University Press, 2008, f.132

¹¹ Po aty, f. 135

¹² S. Turner, "The New Blackwell Companion to the Sociology of Religion", Wiley- Blackwell 2010, f.23

¹³ Po aty, f. 31

¹⁴ Djupe & Gilbert, "The political Influence of Churches" Cambridge University Press, 2008, f. 152

së zezë dhe mungesës së mundësisë për punësim.¹⁵ Në dekadat e fundit të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, mosha mesatare e martesës ishte 25 vjeç për femrat dhe 27 vjeç për meshkujt.

Në shekujt e shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë, mendimtarët popullarizuan idenë se kuptimi i jetës qëndronte te gjetja e lumturisë dhe se martesat duhet të bazohen në dashurinë që ekziston midis një çifti.¹⁶ Ky trend u përforcua nga revolucioni industrial dhe zgjerimi i shtresës së mesme në shoqëri.

Rritja ekonomike, e cila erdhi si pasojë e revolucioneve industriale në shumicën e shteteve europiane dhe rritja e liberalizmit bëri të mundur që meshkuj të rinj të zgjidhnin një partnere dhe të paguanin për dasmën, edhe në raste kur prindërit e bashkëshortëve nuk ishin dakord. Duke qenë se popullata e përgjithshme filloi të kishte më shumë kontroll mbi institucionin e martesës dhe me kalimit e kohës ata filluan të kërkonin të drejtën për të zhbërë martesat në rastet kur ishin të palumtur, ndaj edhe divorci u bë si fenomen më i zakonshëm.

Në vitet 1900 e drejta familjare pësoi një ndryshim rrënjësor, veçanërisht në shtetet të cilat janë sot anëtare të Bashkimit Europian. Mbas Luftës së Parë Botërore, në shtete si Italia, Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë filluan të organizoheshin me qëllimin që të kërkonin një trajtim të barabartë për gratë, të cilat deri më tani ishin krejtësisht të pafavorizuara nga këndvështrimi juridik lidhur me procedurat e shkurorëzimit.¹⁷ Kështu, në këto vite mund të vihet re se dispozitat ligjore, të cilat i përkasin gjerësisht procesit të shkurorëzimit u zhvilluan në dy mënyra kryesore. Fillimisht, ligjvënësit kanë lehtësuar këto procedura duke ligjëruar shkaqe të ndryshme për shkurorëzim, të cilat deri në atë kohë, në sajë të ndikimit të kishës mbi shtetin, ishin përjashtuar. Së dyti, u morën masa të qëllimshme për të parandaluar diskriminimin e grave.

Ky ndryshim mund të vihet re në kuadrin ligjor të vendeve të përshkruara më lart. Në Gjermani, në fillimet e viteve 1900, palët në martesë mund të aplikonin për divorc vetëm në raste kur bashkëshortja kishte kryer tradhti. Në mënyrë të ngjashme, sipas Aktit të vitit

¹⁵ Po aty, f. 153

¹⁶ S. Turner, "The New Blackwell Companion to the Sociology of Religion", Wiley- Blackwell 2010, f. 31.

¹⁷ S. Turner, vepra e cituar, f. 29.

1857,¹⁸ në Angli bashkëshortët mund të aplikonin për divorc bazuar në faktin se bashkëshortet kishin kryer një tradhti, kurse grave iu imponoheshin kushte më të rënda ligjore, të cilat kërkonin të provohej se bashkëshorti ishte sjellë në mënyrë absolutisht të pamoralshme. Në Itali, futja e konceptit të shkurorëzimit erdhi si rezultati i një beteje të gjatë midis Kishës dhe Shtetit, që vazhdoi për më shumë se 100 vjet. Brenda dekadave të fundit të shekullit të njëzetë regjimi juridik, i cili rregullon procesin e shkurorëzimit në këto shtete, kishte ndryshuar rrënjësisht, duke adoptuar parimin se palët mund të divorcohen nëse bien dakord ose nëse martesë faktikisht nuk funksionon më.

Në vitet 1980 e më tej u zhvillua një debat i rëndësishëm mbi të drejtat e fëmijëve dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve. Shtetet europiane nënshkruan bashkërisht Konventën Ndërkombëtare për Të Drejtat e Fëmijëve, dispozitat e së cilës përcaktojnë disa detyrime të prindërve ndaj fëmijëve dhe të drejtat, të cilët prindërit duhet t'u garantojnë fëmijëve. Këto përfshijnë gjerësisht të drejtën për t'u edukuar, të drejtën e sigurimit të mjeteve të jetesës dhe të drejtën për t'u siguruar fëmijëve një rritje të suksesshme në komunitet. Këto principe bazë u aplikuan dhe në regjimet juridike të së drejtës familjare në shtetet europiane.

2.3 Vështrim historik në Kosovë

Në Kosovë, institucioni i familjes dhe i martesës, në varësi edhe nga zhvillimi ekonomik shoqëror, ka kaluar historikisht nëpër faza të ndryshme të zhvillimit. Faktor i rëndësishëm ka qenë faktori tradicional. Pa dyshim, se ndikim të padiskutueshëm ka lënë tradita dhe zakonet, qoftë të pashkruara apo edhe të shkruara dhe të përmbledhura, siç mund të jenë rregullat e përmbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit apo variantet e tjera të tij. Sidoqoftë, rregullat e të drejtës familjare dhe ato të martesës fillojnë të marrin trajtën e rregullimit institucional pas Luftës së Dytë Botërore, kur për herë të parë (përfshirë një periudhë të shkurtër gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës, edhe në pjesë të caktuara të territorit të Kosovës gjeti zbatim Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare të vitit 1929), familja dhe martesë rregullohen me ligj, përkatësisht me Ligjin Themelor për Martesën, të datës 13 prill 1946, i cili gjeti zbatim në tërë territorin e ish-RFPJ-së.

¹⁸ Po aty, f.35

Për herë të parë, Kosova i rregulloi marrëdhëniet familjare dhe martesore në mënyrë vetjake me Ligjin për Martesën, të cilin e kishte aprovuar asokohe Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK) në vitin 1974.¹⁹ Ky ligj bazohej në parimet kryesore të së drejtës familjare të asaj kohe, të parashikuara edhe me konventa ndërkombëtare, si p.sh.: parimi i barazisë së plotë të gruas me burrin në të gjitha sferat e marrëdhënieve familjare, parimi i laicitetit, parimi i martesës civile, institucioni i pasurisë së përbashkët etj. Kësisoj, pra, edhe në territorin e Kosovës kishte filluar etapa e demokratizimit dhe institucionalizimit të marrëdhënieve familjare dhe martesore.

Në vitin 1985, Kuvendi i KSAK miraton Ligjin për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, si një ligj i cili ishte aprovuar ekskluzivisht vetëm për territorin e KSAK-së dhe i cili ngërthen parimet kryesore të familjes dhe të martesës. Përfundimisht, më datën 01.09.2006, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji për Familjen i Kosovës me nr. 2004/32, i aprovuar asokohe nga ana e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës. Ky ligj shënon një përparim të mëtejshëm të marrëdhënieve familjare dhe martesore, duke e renditur Kosovën në grupin e vendeve me rregullore juridike familjare të kodifikuara dhe të harmonizuara me standardet ndërkombëtare.²⁰ Ky ligj përmban gjithsej tetë pjesë, të cilat do të paraqiten në vijim: Pjesa e parë, përmban dispozitat e përgjithshme të cilat janë të përbashkëta për të gjitha marrëdhëniet juridike-familjare të rregulluara prej këtij ligji. Në këtë pjesë, (neni 1-24), ligjvënësi ka vënë në fillim parimet dhe institutet themelore të cilat përshkojnë marrëdhëniet familjare dhe ato janë si udhërrëfyes për rregullimin e marrëdhënieve familjare. Pjesa e dytë, rregullon fejesën (neni 9-13) dhe martesën (neni 14-58). Në këtë pjesë, fejesa është rregulluar si institut i veçantë juridik, ku edhe janë përcaktuar rregulla lidhur me detyrimet që dalin nga fejesa. Pjesa e tretë, përmban dispozitat për shuarjen, respektivisht mbarimin e martesës (neni 59-98). Në këtë pjesë janë rregulluar të gjitha format e shuarjes së martesës. Pjesa e katërt, rregullon marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve (neni 99-155). Në këtë pjesë ligjvënësi i kushton rëndësi marrëdhënieve në mes prindërve dhe fëmijëve, rregullon statusin juridik të fëmijëve martesorë dhe jashtëmartesorë, raportet prindërore, kufizimin dhe heqjen e së drejtës prindërore etj. Pjesa e pestë, rregullon format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror (neni 156-214).

¹⁹ Podvorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005, f.18.

²⁰ Podvorica, Hamdi, vepra e cituar, f.24

Në kuadër të saj, janë rregulluar edhe format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore, siç janë; vendosja e fëmijës në familjen tjetër, adoptimi etj. Pjesa e gjashtë, rregullon kujdestarinë (neni 215-270). Kjo pjesë përmban dispozita të hollësishme, me të cilat rregullohet vendosja e një personi nën kujdestari etj. Pjesa e shtatë, rregullon marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare (neni 271-277), kurse me një përmbledhje të veçantë janë rregulluar marrëdhëniet pasurore midis anëtarëve të familjes. Pjesa e tetë, rregullon mbajtjen financiare (neni 278-355), ndërsa gjerësisht rregullohet detyrimi ligjor i mbajtjes midis anëtarëve të familjes, raportet e mbajtjes në mes bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, si dhe të personave të tjerë në lidhje familjare, si dhe ka dispozita që rregullojnë procedurën në kontestet familjare, dispozita kalimtare dhe përfundimtare.

2.4 Vështrim historik në Shqipëri

Në dallim nga Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë qysh në fillim të shekullit 20 e kishte kodifikuar të drejtën e saj civile. Kështu, në vitin 1929, në Mbretërinë e atëhershme shqiptare është aprovuar Kodi Civil, i njohur ndryshe edhe si Kodi Civil i Zogut, apo edhe si Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare. Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare është hartuar kryesisht duke u bazuar në Kodin Civil Francez. Ky kod në strukturën e tij është i ndarë në 4 libra (pjesë). Libri i Parë ka të bëjë me Personat dhe Familjen, Libri i Dytë me Trashëgimin, Libri i Tretë me Sendet, zotimin e tyre si dhe modifikimet, kurse Libri i Katërt me Mënyrat e fitimit dhe të transmetimit të zotimit dhe të të drejtave të tjera mbi sendet. Kodi në vetvete përmban 2047 nene, pa përfshirë edhe pjesën e Ligjit për zbatimin e Kodit Civil, i cili përmban edhe 64 nene. Me nenin 63 të Ligjit për zbatimin e Kodit Civil parashihet se Kodi Civil dhe ky Ligj hyn në fuqi me 1 prill të vitit 1929.²¹

Siç u tha më lart, dispozitat të cilat i kanë rregulluar marrëdhëniet familjare në këtë kod gjenden në pjesën e parë të tij, përkatësisht në Librin e parë, i cili ka të bëjë me Personat dhe Familjen. Me nenin 109 të këtij Kodi parashikohet se “gjinia është hallkë midis personave që zbresin nga një trung. Ligji nuk njeh hallkë tej shkallës së dhjetë”. Neni 110 i tij përcakton se afërsia e gjinisë caktohet sipas numrit të brezave dhe se çdo brez formon një shkallë. Në lidhje me martesën, Kodi përcakton se “nuk ekziston martesë kur mungon

²¹ Kodi Civil i vitit 1929, Tiranë, 1998

hiri i palëve”.²² Po ashtu, sipas këtij Kodi parashihet edhe mosha minimale për martesë e që për mashkullin është 18 vjeç, kurse për femrën është 16 vjeç. Është interesante të vihet re se me Kod parashikohet edhe situata kur Mbreti, për arsye të rënda, lejon një mashkull që ka mbushur moshën 15 vjeç, ose një femër që ka mbushur moshën 14 vjeç, të lidhin martesë, me kusht që edhe prindërit e tyre, ose të parëlindurit të japin pëlqimin e duhur.²³

Kodi sanksionon parimin e monogamisë në martesë, duke parashikuar se nuk mund të lidhet një martesë tjetër, para se të zgjidhet ajo e mëparshmeja.²⁴ Sipas Kodit, martesë celebrrohet botërisht përpara ofiqarit të gjendjes civile të komunës apo të bashkisë, ku njëri nga bashkëshortët ka banesën ose vend-qëndrimin në vazhdimësi, të paktën prej një muaji para datës së shpalljes së martesës; ose, në rast shkarkimi nga formalitetet e shpalljes, para ditës së këtij shkarkimi.²⁵ Në bazë të Kodit parashikohet se martesë në mes palëve krijon të drejta dhe detyrime të posaçme në mes të martuarve. Ata janë të detyruar për respektimin e këtyre dispozitave, përkatësisht të detyrimeve ndaj njëri tjetrit.

Sipas Kodit, martesë zgjidhet me: vdekjen e njërit nga bashkëshortëve; me shkurorëzim të vendosur ligjërisht dhe me deklarimin e mungesës sipas nenit 106 të Kodit.²⁶ Kodi parashikon një varg efektesh të shkurorëzimit. Kështu, gruaja e shkurorëzuar mund të rimartohet, me t’u transkriptuar vendimi i cili ka deklaruar shkurorëzimin, në qoftë se kanë kaluar treqind ditë, që prej momentit kur në atë padi - e cila ka përfunduar me shkurorëzim- është dhënë urdhri përmes të cilit autorizohet bashkëshorti paditës për të pasur një qëndresë të veçuar. Bashkëshorti kundër të cilit është vendosur shkurorëzimi, humb të gjitha fitimet totale si dhe fitimet e tjera të akorduara nga bashkëshorti tjetër me kontratën e martesës dhe uzufruktin legal. Gruaja ka të drejtë që pas shkurorëzimit të rimarrë mbiemrin e saj. Bashkëshorti në favor të të cilit është vendosur shkurorëzimi, ruan të drejtën në fitimet dhe në të gjitha dobitë, që rrjedhin nga kontrata e martesës edhe sikur këto të jenë të përcaktuara me reciprocitet.²⁷

²² Kodi Civil i vitit 1929, Tiranë, 1998, f. 48

²³ Po aty, f. 48

²⁴ Po aty, f. 49

²⁵ Po aty, f. 57

²⁶ Po aty, f. 71

²⁷ Po aty, f. 74

Renta jetësore e cila i është akorduar bashkëshortit me vendim, ose me konvencion si dëmshpërblim, riparim moral ose pension ushqimor, pushon së vepruari nëse ky bashkëshort rimartohet. Po ashtu parashikohet mundësia që, në rast të ndryshimit të kushteve, pensioni ushqimor i caktuar si ndihmë të suprimohet, apo të pakësohet, varësisht prej shkallës së ndryshimit të kushteve të atij që i ishte akorduar ky pension, aq sa në rastet kur pensioni nuk ndodhet më në kushte të vështira, pensioni mund edhe të suprimohet në tërësi.

Në Kodin Civil të Shqipërisë të vitit 1929, në rastin e shkurorëzimit janë parashikuar një mori pasojash dhe efektsh. Në fakt, Pjesa e Parë apo Libri i Parë i Kodit përmban dispozitat mbi familjen dhe të drejtën familjare, por rrjedhimisht edhe mbi të drejtën martesore. Kështu, në Nenin 211 përcaktohet se gruaja e shkurorëzuar mund të rimartohet pas transkriptimit të vendimit, me anën e të cilit është vendosur shkurorëzimi, në qoftë se nga ajo padi, që ka përfunduar me shkurorëzim, kanë kaluar 300 ditë dhe është dhënë urdhri, me të cilin bashkëshorti paditës autorizohet të qëndrojë më vete. Në Nenin 214 parashihet në qoftë se bashkëshortit të pafajshëm i dëmtohen interesat për shkak të shkurorëzimit, atëherë ai ka të drejtë të kërkojë një shpërblim të arsyeshëm nga bashkëshorti fajtor.

Në qoftë se faktet, që janë paraqitur si shkaqe për shkurorëzimin, kanë lënduar shumë rëndë interesat personale të bashkëshortit të pafajshëm, atëherë gjyqtari mund t'i akordojë atij si kompensim moral edhe një shumë të hollash. Në Nenin 215 të këtij Kodi parashihet gjithashtu se në rast se bashkëshorti i pafajshëm ka ranë në një varfëri të madhe për shkak të shkurorëzimit, atëherë gjyqtari mund t'i akordojë atij, për një kohë të caktuar ose për sa të jetë e nevojshme, një pension ushqimor në proporcion me pasurinë e bashkëshortit tjetër, edhe sikurse ky i fundit të mos i këtë qenë shkak i shkurorëzimit. Në Nenin 218 të Kodit parashikohet se cilido qoftë personi, të cilit i besohen fëmijët, babai dhe nëna e ruajnë të drejtën që të vëzhgojnë mbajtjen dhe mirëritjen e tyre.

Këtu ia vlen të thuhet në Nenin 216 të Kodit Civil parashikohet se renta mujore, e cila i akordohet bashkëshortit si dëmshpërblim me vendim apo me marrëveshje, si riparim moral ose pension ushqimor, pushon në qoftë se ky rimartohet.

2.5 Ndikimet fetare dhe kanonike në Kosovë e në Shqipëri

Sipas të drejtës kishtare të ritit katolik, martesë bëhej përpara kishës, kurse sipas të drejtës kishtare të ritit ortodoks, martesë bëhej përpara priftit-klerikut. Kjo ka bërë që rregullat e lidhjes dhe të zgjidhjes së martesës të jenë të llojeve të ndryshme, varësisht se kush e lidh martesën dhe ku lidhet kjo martesë. Megjithatë, në Kodin Civil shqiptar të vitit 1929, përcaktohet se celebrimi (martesë) bëhet para nëpunësit të gjendjes civile të komunës ose të bashkësisë, ku të paktën njëri nga bashkëshortët ka vendbanimin. Kësisoj, me nenin 152 të këtij Kodi, parashikohet që përpara se të celebrimet martesë, nga ana e nëpunësit të gjendjes civile nuk mund të kryhet asnjë ceremoni tjetër fetare e asaj martese. Si rrjedhojë, Kodi Civil shqiptar njeh vetëm formën civile të martesës në Shqipëri, duke e bërë kështu të drejtën familjare shqiptare më të përparuar, krahas të drejtave të shteteve të tjera në rajon dhe më gjerë, ku martesë lidhet akoma në bazë të riteve fetare dhe përpara organeve fetare. Do theksuar se edhe Ligji mbi legalizimin e bashkëjetesave të ndara, që u zbatua në Republikën e Shqipërisë nga viti 1946, njihje vetëm martesën civile të lidhur para organit kompetent shtetëror, duke e fuqizuar të ashtuquajturin parim të shuarjes së ndikimit të organizatave fetare në të drejtën familjare, përkatësisht atë martesore.²⁸

Sipas të drejtës së shenjtë myslimane (e Drejta e Sheriatit), martesë konsiderohej si një çështje private, përkatësisht si një kontratë. Kështu martesë mund të lidhej para imamit, që ishte një teolog jurist konsulent, por kjo mënyrë e lidhjes së martesës nuk kërkohej për qenien (ekzistencën) e martesës (ad solemnitatem), por për provimin e saj (ad probationem). Imami kishte për detyrë që brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e martesës, t'i dërgonte administratës së gjendjes civile një certifikatë, e cila të vërtetonte se martesë ishte lidhur. Ndikimi i organizatave fetare në raportet familjare dhe martesore mënjanohej pas Luftës së Dytë Botërore edhe në Kosovë {Kushtetuta e ish Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë (RFPJ)}. Në fakt, Kushtetuta e RFPJ-së, e cila ishte miratuar në vitin 1946 dhe që zbatohej edhe në territorin e Kosovës, përmbante disa parime themelore mbi të drejtën familjare, siç ishin: mbrojtja shtetërore e familjes dhe e martesës; rregullimi me ligj i marrëdhënieve familjare dhe martesore, barazia e burrit dhe e gruas në sferën e marrëdhënieve familjare si dhe forma civile e martesës. Me 13 prill të vitit 1946 ishte nxjerrë Ligji Themelor për Martesën e RFPJ-së, i cili zbatohej edhe në territorin e Kosovës.

²⁸ Podvorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005, f. 17

KAPITULLI III:

I. ZGJIDHJA E MARTESES DHE PASOJAT JURIDIKE TË SHKURORËZIMIT

Aspekti krahasimor Kosovë - Shqipëri

3.1 E drejta martesore, objekti dhe subjektet e të drejtës martesore

E drejta martesore është një përmbledhje normash juridike me të cilat rregullohet martesa dhe marrëdhëniet martesore, norma të cilat kryesisht janë të natyrës urdhëruese.

Mirëpo, përveç me norma urdhëruese, për shkak të natyrës së marrëdhënieve midis bashkëshortëve, ekzistojnë edhe shumë marrëdhënie martesore të tjera, të cilat rregullohen me norma të karakterit dispozitiv, përkatësisht me marrëveshjen e bashkëshortëve, për shembull, çështja e mbiemrit, vendbanimit të përbashkët, shtetësisë etj. E drejta martesore është në të njëjtën kohë edhe pjesë e shkencës familjare juridike. Ajo merret me studimin e martesës dhe të marrëdhënieve martesore.

Detyra e shkencës juridike qëndron në sistematizimin e normave të së drejtës martesore, si dhe në përcaktimin e parimeve të saj themelore.

Fakti se martesa është e rregulluar me ligj, nënkupton se ajo ka rëndësi të posaçme shoqërore, pasi që konsiderohet se martesa është bazë e familjes, ndërsa familja bazë e shoqërisë.²⁹ Për këtë arsye, me këtë ligj, rëndësi e veçantë i kushtohet mbrojtjes shoqërore dhe juridike të familjes dhe anëtarëve të saj e në veçanti fëmijëve dhe nënës.

²⁹ Dr. Arsim Bajrami, Mr.sc. Xhavit Shala, Dr. Sc. Fejzulla Hasani, Adem Vokshi, Suzana Sejdiu. Meleqe Bexheti, Dr. Sc. Mirlinda Batalli, Mr. Sc. Flamur Mrasori “Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudence”, Prishtinë 2015, f. 419.

3.1.2 Objekt i të drejtës martesore

Objekt i të drejtës martesore është martesa dhe marrëdhëniet martesore, të cilat janë të shumëllojshme; si të natyrës personale juridike, ashtu edhe pasurore juridike. Edhe marrëdhëniet pasurore martesore, të cilat lindin nga martesa, përbëjnë gjithashtu objektin e së drejtës martesore. Kohët e fundit, në objektin e së drejtës martesore është përfshirë edhe studimi dhe rregullimi i marrëdhënieve juridike të cilat lindin nga bashkësia jashtëmartesore. Ndërsa, objektin e së drejtës familjare e përbën tërësia e marrëdhënieve martesore dhe familjare, d.m.th. marrëdhëniet personale jopasurore familjare, raportet pasurore të lidhura me to. Marrëdhëniet familjare krijohen midis bashkëshortëve me anë të martesës. Marrëdhëniet e shëndosha dhe harmonike në familje krijojnë ambient të përshtatshëm për zhvillim normal të individit dhe përbëjnë bazën e përparimit të shoqërisë, sepse midis familjes, si një bashkësi më themelore sociale dhe shoqërisë nga ana tjetër, ekziston një raport i drejtë.³⁰ Sa më e shëndoshë, e fortë dhe harmonike të jetë familja, aq më e fortë dhe e shëndoshë do të jetë shoqëria në tërësi.

3.1.3 Subjektet e të drejtës martesore

Subjektet e të drejtës martesore janë bashkëshortët, mirëpo, gjithnjë e më shumë po shtohet numri i bashkëshortëve jashtëmartesorë. Si subjekt të së drejtës martesore mund të paraqiten vetëm personat fizikë. Shumë marrëdhënie familjare lindin midis dy subjekteve të së drejtës, ndërmjet dy personave fizikë (për shembull, midis burrit dhe gruas). Mirëpo shpesh ndodh të themelohen marrëdhënie juridike familjare midis tre subjekteve (p.sh. në mes të dy prindërve a dy adoptuesve dhe fëmijës), kështu që raporte të tilla mund të vështrohen edhe si dy marrëdhënie të thjeshta (midis secilit prind apo adoptues dhe fëmijës).³¹

3.1.4 Kuptimi i martesës

Martesa është institucioni kryesor që i paraprin familjes. Familja përbën bashkimin e personave që për shkak të lidhjes së martesës, gjinisë, ose birësimit, janë të lidhur mes tyre në marrëdhënie psikologjike, morale, ekonomike dhe juridike; jetojnë në një ekonomi

³⁰ Dr. Syrja Pupovci, Përmbledhje Punimesh, Fakulteti Juridike në Prishtinë, Prishtinë, 1977, f. 10

³¹ Dr. Syrja Pupovci, vepra e cituar, f. 21

të përbashkët familjare dhe mbajnë para shoqërisë përgjegjësi shoqërore për njëritjetrin.³² Nga ky përkufizim arrijmë në përfundimin se martesë i paraprin familjes. Martesa shfaqet si bazë e familjes dhe krijon marrëdhënie të cilat, për nga pasojat e tyre, janë shumë më komplekse se sa lidhjet e miqësisë. Në martesë lindin fëmijë për të cilët duhet kujdesur. Po ashtu, brenda martesës mund të lindin edhe konflikte, të cilat duhet zgjidhur me ndërhyrjen e organeve shtetërore.³³

Martesa përcaktohet si bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin të jetojnë së bashku, me qëllim krijimin e familjes.³⁴ Nga ky përcaktim konstatojmë se martesë është bazë e familjes, ndërsa familja përbën bazën e shoqërisë. Bashkëshortët janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore. Ata janë të detyruar të jenë besnikë ndaj njëritjetrit dhe reciprokisht të ndihmojnë financiarisht kur ata kanë nevojë.

Sipas Kodit të Familjes së Shqipërisë, martesë është një bashkëjetesë ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si bazë e unitetit të familjes.³⁵ Sipas legjislacionit të dy shteteve, martesë dhe familja gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Martesa dhe marrëdhëniet familjare në Kosovë janë të rregulluara më Ligjin e Republikës së Kosovës për familjen, ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", 2005/12). Me këtë ligj rregullohen raportet familjare, fejesa, martesë, marrëdhëniet martesore, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror, adoptimi, kujdestaria, ushqyerja, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat gjyqësore në kontestet nga marrëdhëniet martesore dhe familjare.

Në teorinë juridike të së drejtës familjare, ka pasur mendime të ndryshme, për konceptin e natyrës juridike të martesës. Mirëpo kuptimi më i plotë për familjen mund të jetë se: "familja është një grup personash të lidhur në martesë, apo në bashkësi jashtëmartesore,

³² Santhipi, Begeja: "E drejta familjare e RPS të Shqipërisë". Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 1985, f. 4.

³³ Dr. Syrja Pupovci, Përmbledhje Punimesh, Fakulteti Juridik në Prishtinë, Prishtinë, 1977, f. 6

³⁴ Neni 14 i Ligjit për Familjen i Kosovës

³⁵ Neni 1 i Kodit të Familjes të Shqipërisë

ose në gjini, të cilët kanë të drejta dhe detyrime ligjore, mosrespektimi i të cilave do të shkaktonte sanksione juridike”.³⁶

Sipas LFK, familja është bashkësia e jetës e prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave tjerë në gjini. Nga ky përkufizim arrijmë në përfundimin se ligji, përpos prindërve dhe fëmijëve të tyre, nuk përcakton konkretisht se kush tjetër përveç tyre konsiderohet anëtar i familjes.

3.1.5 Fejesa

Ligji i Republikës së Kosovës për Familjen për herë të parë rregullon çështjen e fejesës. Sipas tij, akti i fejesës konsiderohet premtimi reciprok i dy personave me gjini të kundërt për t’u martuar ndërmjet tyre (neni 9). Nga fakti se është dhënë premtimi për martesë, pra është lidhur fejesa, nuk mund të paraqitet padi në gjykatë dhe të kërkohet që ajo martesë edhe të lidhet. Për këtë arsye, është e pavlefshme çfarëdo marrëveshje me të cilën do të parashikohet çfarëdo lloj shpërblimi, nëse nuk mbërrihet deri te martesa ndërmjet të fejuarve.³⁷

I fejuari që është fajtor, apo pa ndonjë shkak heq dorë nga fejesa, ka detyrim t’i kompensojë dëmin e shkaktuar të fejuarit tjetër. Ai përgjigjet për çdo shpenzim të bërë gjatë pritjes së martesës. Padia për dëmshpërblim mund të paraqitet brenda dy viteve nga dita e heqjes dorë nga fejesa.³⁸ Sipas traditës, të fejuarit, me rastin e fejesës, shkëmbejnë dhurata ndërmjet njëri- tjetrit. Në rastet kur ata nuk lidhin martesë, gjegjësisht e prishin fejesën, secili nga të fejuarit ka të drejtë të kërkojë nga tjetri kthimin e dhuratave që i kanë dhuruar njëri- tjetrit me rastin e fejesës. Nëse nuk i kthejnë, atëherë këtë mund ta bëjnë me paraqitjen e padisë në gjykatën kompetente, duke u bazuar në dispozita ligjore për begatim të pabazë, sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kodi i Familjes i Shqipërisë në dispozitat e tij nuk e parashikon aspak fejesën si paraprijëse e lidhjes së martesës në të ardhmen.

³⁶ Dr. Marina. Janic-Komar, Dr. Radoje Korac, Dr. Zoran Panjovic: "Porodicno pravo" Izdovacko produzece "Homoc" d.o.o. Beograd, 1999, f.7.

³⁷ Dr. Arsim Bajrami, Mr.sc. Xhavit Shala, Dr. Sc. Fejzulla Hasani, Adem Vokshi, Suzana Sejdiu. Meleqe Bexheti, Dr. Sc. Mirlinda Batalli, Mr. Sc. Flamur Mrasori "Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës", Prishtinë 2015, f. 418.

³⁸ Po aty, f. 418

3.2 Roli aktiv i gjykatës, kushtet dhe procedura e shkurorëzimit

Bota sot është duke u ballafaquar me një problem social shumë serioz, siç është shkurorëzimi, i cili sikur është bërë një normë në jetën tonë. Shkurorëzimi mund të ndodhë për shkak të arsyeve të ndryshme, si konflikti në martesë, problemet financiare, stresi dhe arsye tjera, por e përbashkëta është se pasojat që lë ai te palët dhe sidomos te fëmijët, janë të shumëfishta.

Ajo që e bën shkurorëzimin edhe më të vështirë, është fakti se shumica e çifteve të shkurorëzuara kanë fëmijë, të cilët, në shumicën e rasteve, janë shumë të vegjël dhe janë të papërgatitur se si të sillen në këto raste. Kjo gjendje pasigurie ndikon drejtpërdrejt në personalitetin e fëmijëve që në rrethana normale, nuk janë të përgatitur për të përballuar raportet e acaruar të prindërve e rrjedhimisht edhe procedurën e shkurorëzimit.

Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë, për nga mënyra e rregullimit, e përcakton martesën si një institucion të rëndësishëm për shoqërinë, pasi ajo është bazë e krijimit të familjes. Në këtë kuptim pra, është bërë përpjekje që martesës, edhe në pikëpamje ligjore t'i jepet rëndësia e duhur, sepse ajo përfaqëson një institucion shoqëror dhe juridik. Është institucion shoqëror, sepse është formë e organizuar shoqërore, ndërsa është institucion juridik, sepse me krijimin e martesës, krijohen të drejta dhe detyra për bashkëshortët.³⁹

Qëllimi shoqëror qëndron në faktin se martesa është bazë e familjes e familja është bazë e shoqërisë. Në martesë realizohen edhe interesat e shoqërisë, prandaj shoqëria ka për detyrë që, me instrumente juridike dhe me instrumente të tjera, të krijojë kushte të nevojshme për martesë të harmonishme.⁴⁰

Thujse qëllimi më kryesor i martesës ishte dhe mbetet edhe më tej, lindja dhe mirërritja e fëmijëve.

Martesa zgjidhet me anulimin e saj ose me shkurorëzim, kur aktgjykimi merr formën e prerë. Nëse bashkëshorti i zhdukur është shpallur i vdekur, martesa zgjidhet ditën kur me aktvendimin e formës së prerë, është konstatuar si dita e vdekjes e bashkëshortit të zhdukur. Martesa është institucion juridik i rregulluar kryesisht me dispozita ligjore urdhëruese, ndërsa zgjidhja e saj mund të bëhet vetëm në një mënyrë të parashikuar me dispozita ligjore.⁴¹ Me nenin 60, paragrafi 1, të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), është parashikuar shuarja e martesës me shkurorëzim, ndërsa me dispozitën e nenit 68, paragrafi 1, është parashikuar se martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim, vetëm në

³⁹ Aliu, Abdullah dhe Gashi, Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, f. 35

⁴⁰ Oruçi, Gani, Ligjërata të autorizuara, E Drejta Familjare, Prishtinë, 1994, f. 40.

⁴¹ Podvorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011, f. 40.

bazë të vendimit të gjykatës. Shkurorëzimi është mënyrë e zgjidhjes së martesës së vlefshme.

Shkurorëzimi është përfundim ligjor i martesës.⁴² Procedura në kontestet martesore fillon përmes parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente nga njëri prej bashkëshortëve apo me propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje.

Kushti themelor për fillimin e procedurës së shkurorëzimit është që padia, apo propozimi i përbashkët i bashkëshortëve për shkurorëzim, t'i dorëzohet gjykatës kompetente. LFK parashikon rregulla të veçanta për shqyrtimin e kontesteve martesore dhe të atyre familjare. Në rastet kur bashkëshortët nuk kanë pajtim për shkurorëzim, atëherë paraqitet padia. Ndërsa në rastet kur bashkëshortët pajtohen që të shkurorëzohen, atëherë paraqitet propozimi i përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje. Në rastet kur paraqitet padia dhe i padituri në seancën gjyqësore nuk e konteston kërkesën për shkurorëzim, padia e paraqitur nga njëri bashkëshort konsiderohet si propozim i përbashkët i bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje.⁴³ Bashkëshortët së bashku me propozimin për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, duhet që propozimit t'i bashkëngjisin marrëveshjen me shkrim lidhur me ruajtjen, edukimin, ushqimin e fëmijëve si dhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijët. Pavarësisht nga fakti se bashkëshortët paraqesin propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës, ata përsëri i kanë disa kufizime. Gjykata kompetente në rastet e caktuara ligjore mund ta refuzojë propozimin për shkurorëzim, në rast se kjo është në interes të fëmijëve të mitur.

Deri në vitin 2012, ish-Gjykatat e Qarkut kanë qenë kompetentet lëndore për shqyrtimin e kontesteve lidhur me shkurorëzimin; ndërsa nga janari i vitit 2013, Gjykatat Themelore. Sa i përket kompetencës territoriale, përpos kompetencës së përgjithshme sipas vendbanimit të të paditurit, kompetente është edhe gjykata, në territorin e së cilës bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët. Nëse bashkëshortët, gjegjësisht i padituri, nuk ka pasur vendbanimin, përkatësisht vendqëndrim në Kosovë, kompetente është gjykata sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të paditësit. Në kontestet martesore, procedurën e zhvillon dhe vendos në shkallë të parë trupi gjykues, i përbërë nga një gjyqtar profesionist dhe dy gjyqtarë porotë, ndërsa në shkallë të dytë vendos kolegji prej tre gjyqtarëve profesionistë.

⁴² Leonard, Robin dhe Elias, Stephen, "Child Custody", shih te: <http://www.lectal.com>

⁴³ Neni 84 i LFK-së

Duhet theksuar se në procedurën e shkurorëzimit gjykata ka rol aktiv në hetimin dhe shqyrtimin e çështjes lidhur me mbrojtjen e interesit më të mirë të të miturve, të cilët përfshihen në procedurën e shkurorëzimit që zhvillohet në mes të prindërve të tyre. Në këtë rast, LFK ka përcaktuar rolin aktiv të gjykatës për mbrojtjen e interesave të të miturve.

Në rastet kur shkurorëzimi bëhet në bazë të propozimit të përbashkët të bashkëshortëve, gjykata mund të mos i hetojë faktet të cilat palët i kanë paraqitur në propozim, me përjashtim kur është në pyetje mbrojtja e të drejtave të fëmijëve të mitur. Edhe faktet të cilat janë të pakontestueshme për palët, gjykata mund t'i konsiderojë si të kontestueshme, nëse ato nuk janë në interesin e palëve, apo të fëmijëve. Palët duhet të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre dhe të propozojnë prova dhe dëshmitarë nga të cilët konstatohen faktet e tilla. Gjykata vendos për pranimin e çdo prove sipas çmuarjes dhe vlerësimit të lirë të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, të cilat nxirren dhe administrohen në seancën e shqyrtimit kryesor. Fëmijët e mitur nën moshën 14 vjeçare përjashtimisht mund të propozohen dhe të thirren si dëshmitarë, vetëm kur dëshmitë e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes. Për shkak të rëndësisë që i jepet mbrojtjes së interesave të të miturve në konteste martesore, LFK gjithashtu ka paraparë që gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore në kontest martesor, gjykata dhe subjektet e tjerë të përfshirë në këto procedura detyrohet të zbatojnë disa parime për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilat do të trajtohen në vijim të këtij punimi.

Përveç parimeve bazë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, LFK ka përcaktuar edhe disa kufizime për zhvillimin e procedurës së shkurorëzimit e të cilat i referohen mbrojtjes së interesave të të miturve, pasi që më dispozitën e nenit 70, pika 1, parashikohet se “bashkëshortët nuk do të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të mbushë një vit”. Më këtë kufizim ligjor parashikohet një masë mbrojtëse për nënën e fëmijës dhe për fëmijën, duke e ndaluar paraqitjen e padisë, për sa kohë zgjat shtatzënia dhe derisa fëmija të mbushë moshën një vjeçare. Qëllimi i kësaj dispozite ligjore është jo të ndalojë shkurorëzimin, por të pengojë zhvillimin e procedurës gjatë kësaj kohe, duke pasur parasysh rrethanat rënduese shëndetësore ku gjendet bashkëshortja, respektivisht nëna e fëmijës si rrjedhojë e shtatzënisë.⁴⁴ Kjo ndalesë e zhvillimit të procedurës duhet kuptuar në kuadrin e parimeve

⁴⁴ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, “Komentar mbi Ligjin për Familjen në Kosovë, f. 199

për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilat në mënyrë specifike do të trajtohen në pjesën e parimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Roli aktiv i gjykatës në hetimin, shqyrtimin dhe ofrimin e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit, i referohet edhe detyrës së gjykatës që *ex officio* të caktojë masë të përkohshme në kuptim të dispozitave nga neni 327 dhe 328 të LFK-së (të cilat do të trajtohen në pjesën e caktimit të ushqyerjes për fëmijët).

Gjatë procedurës së shkurorëzimit, përveç gjykatës, rol thelbësor për të ofruar mbrojtjen e drejtave të fëmijëve, jo vetëm në kuptimin formal, por edhe përmbajtjesor, ka edhe organi i kujdestarisë.

Kujdesi i gjykatës dhe i organit të kujdestarisë gjatë procedurës së shkurorëzimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre duhet të jetë i veçantë, jo vetëm për faktin se këto dy institucione janë të ngarkuara më këtë përgjegjësi ligjore, por edhe për shkak të disa faktorëve të cilët ndikojnë që mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre të bëhet më komplekse e rrjedhimisht, më e vështirësuar.

Studimet dhe hulumtimet e praktikës gjyqësore për kontestet martesore ku janë të përfshirë edhe fëmijët, tregojnë se ekzistojnë një numër faktorësh-rrethanash të cilat e vështirësojnë dukshëm mundësinë e gjykatës dhe mekanizmave tjerë, që fëmijëve t'u sigurohet mbrojtje adekuate e të drejtave të tyre.

Rëndom në konteste martesore, ku janë të përfshirë edhe fëmijët, gjykata dhe institucionet tjera që janë të detyruar të ofrojnë mbrojtje për fëmijët përballen dhe do të përballen me: manipulimin e fëmijëve nga njëri ose prindi tjetër; ndryshimin e ambientit familjar pa njërin prind gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit; ndryshimin e vendbanimit, ambienteve sociale apo edhe shkollës; martesën e prindërve të shkurorëzuar pas ndarjes; detyrimin e fëmijëve me prindër të shkurorëzuar që të punojnë para moshës madhore dhe mundësinë e përfshirjes së këtyre fëmijëve në veprimtari kriminale. Zgjidhja e martesës nënkupton mbarimin e martesës. Mbarimi i martesës me zgjidhje i referohet fakteve juridike që burojnë nga vullneti i bashkëshortëve, njërit ose të dyve, e cila detyrimisht duhet të bëhet në rrugë gjyqësore.⁴⁵ Meqenëse martesë është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, ajo mund të zgjidhet vetëm në procedurën e parashikuar ligjore në gjykatën kompetente. Për dallim nga

⁴⁵ Mandro, Arta, E Drejta familjare, Tiranë, 2009, f. 301

bashkësia faktike, e cila nuk regjistrohet pranë organit kompetent të gjendjes civile, edhe për shuarjen e saj nuk kërkohen veprime ligjore zyrtare.⁴⁶

Dy bashkëshortët kanë të drejta të barabarta edhe gjatë shkurorëzimit. Gjatë gjithë procedurës së shkurorëzimit ata janë të barabartë dhe duhet të trajtohen si të tillë. Qëllimi i saj është mënjanimi i të gjitha formave të diskriminimit të gruas, i cili ka qenë i vrazhdë në periudha të caktuara të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.⁴⁷

Zgjidhja e martesës mund të bëhet në disa mënyra dhe ato janë: me vdekjen e njërit bashkëshort, me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, me anulimin e martesës (tek rastet e martesës së pavlefshme) dhe me shkurorëzim (te martesa e vlefshme). Me rastin e vdekjes së njërit nga bashkëshortët, apo me shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur, martesa shuhet. Te rastet e vdekjes së bashkëshortit martesa shuhet nga momenti i vdekjes, ndërsa te rastet e personit të zhdukur për të vdekur, martesa shuhet nga data e konstatuar si datë e vdekjes në aktvendimin me të cilin personi është shpallur për të vdekur. Në rastet kur nuk mund të vërtetohet data e vdekjes, merret data e plotfuqishmërisë së aktvendimit, me të cilin personi është shpallur i vdekur.

E drejta e ushtrimit të padisë të personave për anulimin e martesës pranë gjykatës kompetente ju takon: bashkëshortëve, prokurorit publik dhe të gjithë personave të tjerë, të cilët kanë interes juridik të drejtpërdrejtë për anulimin e martesës; kurse në dallim nga kjo, te procedura e shkurorëzimit, të drejtën e padisë e kanë vetëm bashkëshortët dhe kjo nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por trashëgimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë.⁴⁸

Zgjidhja e martesës me shkurorëzim është zgjidhje e martesës se vlefshme.

Martesa zgjidhet me shkurorëzim duke ushtruar padi apo propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, pranë gjykatës kompetente. Për t'u zgjidh një martesë me shkurorëzim, duhet të plotësohen disa kushte siç janë:

- ekzistenca e martesës se vlefshme (martesa e ligjshme);
- bashkëshortët të jenë gjallë (në jetë);
- të plotësohet ndonjëri nga shkaqet e parashikuara me ligj;
- shkurorëzimi të bëhet në procedurë gjyqësore –pra të zbatohet procedura gjyqësore e shkurorëzimit

⁴⁶ Neni 61, paragrafi 1 i LFK-së

⁴⁷ Podvorica, Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2011, f. 115

⁴⁸ Neni 68, paragrafi 3 i LFK-së

a. Ekzistenca e martesës së vlefshme (martesa e ligjshme)

Martesa është e vlefshme nëse lidhet para ofiqarit (nëpunësit të gjendjes civile), kur të dy bashkëshortët shprehin në mënyrë të lirshëm vullnetin e tyre dhe pajtimin për lidhjen e martesës.⁴⁹ Kjo nënkupton se martesa e vlefshme zgjidhet vetëm me shkurorëzim, për dallim nga martesa e pavlefshme, e cila anulohet nga gjykata. Në rastet kur në të njëjtën kohë paraqiten shkaqet e anulimit dhe të shkurorëzimit, është detyrim i gjykatës që, së pari, të shqyrtojë shkaqet e anulimit të martesës, pasi ato kanë peshë më të madhe ligjore, e pastaj të shqyrtojë shkaqet e shkurorëzimit.

b. Bashkëshortët të jenë të gjallë (në jetë)

Kushti i dytë është që bashkëshortët të jenë në jetë, pasi me vdekjen e njërit bashkëshort martesa, sipas fuqisë ligjore, shuhet. Në rastet kur ndonjëri nga bashkëshortët ka paraqitur padi për shkurorëzim, por ndërkohë njëri nga ta vdes, trashëgimtarët mund të vazhdojnë procedurën e iniciuar për të verifikuar bazën e padisë.

Në rast se gjykata vërteton bazën e padisë, ajo e zgjidh martesën, nëse ajo ka qenë e vlefshme dhe plotësohen shkaqet për shkurorëzim

c. Plotësimi i shkaqeve të parapara me ligj

Shkurorëzimi bëhet vetëm kur plotësohet ndonjëri nga shkaqet e parashikuara me dispozita ligjore. Shkaqet e zgjidhjes së shkurorëzimit janë të natyrave të ndryshme si: konfliktet në mes të bashkëshortëve gjegjësisht në rast se raportet në mes të bashkëshortëve janë prishur seriozisht: tradhtia bashkëshortore, shkaqet ekonomike (papunësia, varfëria e lartë), ushtrimi i dhunës ndaj bashkëshortit, pozita favorizuese e burrit në familje, kryerja e veprës penale ndaj bashkëshortit, sëmundja psikike e pashërueshme, ndërprerja paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit. Pa plotësimin e këtyre shkaqeve martesa nuk mund të shkurorëzohet, edhe nëse bashkëshortët kërkojnë zgjidhjen e saj.

d. Procedura gjyqësore e shkurorëzimit

Në bazë të dispozitave ligjore pozitive në Republikën e Kosovës, gjykatat janë të vetmet organe kompetente për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim. Gjykatat në konteste

⁴⁹ Po aty, Neni 28, paragrafi 1

martesore duhet të kujdesen dhe të angazhohen aq sa është e mundur që martesë të ruhet. Nëse kjo nuk është e mundur, që shkurorëzimi të prodhojë sa më pak shqetësime për fëmijët dhe bashkëshortët, duhet: të promovohen raporte sa më të mira në mes të fëmijëve dhe prindit që nuk i janë besuar fëmijët; procedura të përfundojë me sa më pak shpenzime dhe të evitohet çdo rrezik për dhunë ndaj fëmijëve dhe bashkëshortëve. Procedura e shkurorëzimit është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për Familjen të Kosovës. Përgjashtimisht në procedurën e shkurorëzimit zbatohen edhe dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës (LPK). Në procedurën e shkurorëzimit publiku përjashtohet dhe seancat janë jopublike. Arsyeja e këtij përjashtimi është që bashkëshortët të deklarohen lirshëm dhe t'i paraqesin pretendimet e tyre para gjykatës për të gjitha faktet nga sfera intime e martesës. Më këtë masë pamundësohet që publikut të informohet për marrëdhëniet e tyre intime; palët do të tregojnë shkaqet e vërteta që e bëjnë të pamundur bashkëjetesën e mëtejshme.⁵⁰

Sipas KFSH-së martesë mbaron me vdekjen e njërit bashkëshort, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort, ose me zgjidhjen e martesës në mes tyre.

Edhe sipas ligjit në fuqi në Shqipëri, martesë zgjidhet me shkurorëzim duke paraqitur padi, apo në rastet kur bashkëshortët pajtohen për zgjidhjen e martesës dhe të dy i paraqesin gjykatës për aprovim kërkesën, së bashku edhe me projekt- marrëveshjen me të cilën rregullojnë pasojat e zgjidhjes së martesës. Në dallim nga gjykata kosovare, e cila bashkëshortët i dëgjon bashkërisht, gjykata në Shqipëri fillimisht bën dëgjimin e bashkëshortëve veç e veç e më pas të dy së bashku dhe pa praninë e përfaqësuesve të tyre dhe në fund thërret edhe përfaqësuesit e bashkëshortëve, nëse ata kanë. Në vendim gjykata miraton edhe marrëveshjen e cila rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës e që ka të bëjë me rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në interes të bashkëshortit që ka nevojë dhe, nëse është e mundur, edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore. Në rastet kur gjykata vërteton se marrëveshja nuk i mbrohet interesat e fëmijëve të mitur, apo të njërit bashkëshort, ajo pezullon gjykimin në kohëzgjatje prej tre muajve dhe brenda kësaj kohe kërkon nga bashkëshortët që t'i bëjnë rregullimet e nevojshme në marrëveshje, me qëllim që të mbrohet interesat e fëmijëve apo të bashkëshortit. Nëse pas

⁵⁰ Podvorica, Hamdi, E Drejta familjare, Prishtinë, 2011, f. 126

kalimit të këtij afati palët nuk i bëjnë rregullimet e kërkuara, gjykata do ta refuzojë miratimin dhe rrëzon kërkesën për zgjidhjen e martesës.

Edhe sipas KFSH-së, për t'u zgjidhur martesë me anë të shkurorëzimit duhet të plotësohen këto kushte:

- ekzistenca e martesës së ligjshme
- bashkëshortët të jenë gjallë
- të plotësohet ndonjëri nga shkaqet e parashikuara me ligj për zgjidhjen e martesës
- shkurorëzimi të bëhet në procedurë gjyqësore⁵¹

a. Ekzistenca e martesës së ligjshme

Martesa është e ligjshme nëse është lidhur në formën e parashikuar sipas ligjit para nëpunësit të gjendjes civile, me pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve.

b. Bashkëshortët të jenë gjallë

Si kusht tjetër është që bashkëshortët të jenë gjallë, sepse me vdekjen e njërit bashkëshort, apo me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort, martesë mbaron sipas fuqisë së ligjit.

c. Plotësimi i shkaqeve të parashikuara me ligj

Shkurorëzimi mund të bëhet vetëm në rastet kur plotësohet ndonjëri nga shkaqet e parashikuara me ligj. Shkaqet e zgjidhjes së shkurorëzimit janë të natyrave të ndryshme si: ndërprerja e jetës së përbashkët, grindjet e vazhdueshme, keqtrajtimet, fyerjet e rënda, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, sëmundjet mendore, dënimi penal, jeta e padurueshme apo kur martesë humb qëllimin. Shkaqet e shkurorëzimit në të dy vendet janë identike, me përjashtim se si shkak LFK parashikon kryerjen e veprës penale kundër jetës së bashkëshortit; ndërsa KFSH parashikon dënimin penal të rëndë të bashkëshortit.

d. Procedura gjyqësore e shkurorëzimit

Në bazë të dispozitave ligjore pozitive në Republikën e Kosovës, gjykatat janë të vetmet organe kompetente për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim. Gjykatat në konteste martesore duhet të kujdesen dhe të angazhohen aq sa është e mundur që martesë të ruhet

⁵¹ Kushtet të njëjta me LFK-në

e nëse kjo nuk është e mundur, atëherë shkurorëzimi duhet të prodhojë sa më pak shqetësime për fëmijët dhe bashkëshortët; të promovohen raporte sa më të mira në mes të fëmijëve dhe prindit të cilit nuk i janë besuar fëmijët; procedura të përfundojë me sa më pak shpenzime dhe të evitohet çdo rrezik për dhunë ndaj fëmijëve dhe bashkëshortëve. Procedura e shkurorëzimit është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për Familjen të Kosovës. Përjashtimisht në procedurën e shkurorëzimit zbatohen edhe dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës (LPK). Procedura e zgjidhjes së martesës është e rregulluar me norma juridike ligjore imperative (*ius cogens*). Bashkëshortët janë plotësisht të barabartë në procedurën e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim. Barazia e gruas me burrin është e sanksionuar si në rastin e lidhjes së martesës edhe me rastin e zgjidhjes së saj.⁵² Në të drejtën e lashtë romake vetëm burrit i lejohej shpëputja e martesës për shkaqe të justifikuara si për shembull shkelja e besnikërisë bashkëshortore nga ana e gruas, dështimi i fëmijës etj.⁵³ Me kalimin e kohës kjo e drejtë u zgjerua edhe tek prindërit e bashkëshortëve dhe duke u kufizuar në fund vetëm si e drejtë ekskluzivisht vetëm e bashkëshortëve.⁵⁴

3.3 Kuptimi, llojet e të drejtave dhe të detyrimeve të bashkëshortëve

Martesa në fakt krijon një tërësi të drejtash dhe detyrimesh midis bashkëshortëve, në mënyrë të tillë që burri dhe gruaja të kenë të drejta dhe detyrime reciproke, andaj sot martesa ngrihet mbi bazën e barazisë morale dhe juridike, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, pa ndonjë diskriminim fetar, kombëtar, racor.

Nga plotësimi dhe respektimi i tërësisë së të drejtave dhe detyrimeve, varet cilësia dhe stabiliteti i bashkësisë martesore. Bashkëshortët kanë të drejta dhe detyrime reciproke në mes tyre dhe janë të barabartë në raportet e tyre. Marrëdhëniet martesore janë specifike, ku një numër prej të drejtave personale të bashkëshortëve, nuk mund të rregullohen me norma juridike. Ato paraqesin një shumëllojshmëri marrëdhëniesh dhe përbëjnë intimitetin e njeriut, si për shembull: psikologjike, biologjike e të karakterit moral. Këto marrëdhënie realizohen spontanisht dhe kanë mbetur jashtë sferës së rregullimit juridik, mirëpo nuk kanë mbetur jashtë sferës së interesimit shoqëror. Këto marrëdhënie janë objekt rregullimi me norma etike. Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve

⁵² Hamdi & Fatlum Podvorica, "Klinika juridike-E drejta familjare dhe trashëgimore", Prishtinë, 2016 f.27

⁵³ Asllan Bilalli & Bedri Bahtiri, vep. e cituar, fq.186.

⁵⁴ Po aty, fq.187.

ndahen në: a) të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje dhe b) të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.

3.3.1 Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje

Legjislacioni që rregullon raportet në mes të bashkëshortëve përfshin dispozita (norma) urdhëruese lidhur me ushqimin, besimin e fëmijëve, kontaktin dhe norma dispozitive për mbiemrin, vendbanimin, kryerjen e punëve në amvisni, zgjedhjen e profesionit etj.

Me rastin e lidhjes së martesës në mes të bashkëshortëve krijohen dy lloje marrëdhëniesh: marrëdhënie jopasurore, apo personale dhe marrëdhënie pasurore. Që nga momenti i lidhjes, martesa krijon një tërësi të drejtash dhe detyrimesh midis vetë bashkëshortëve, në mënyrë të tillë, që burri dhe gruaja të kenë detyrime reciproke, të cilat burojnë nga dispozitat ligjore, por edhe nga aspekti moral.

Varësisht nga fakti nëse bashkëshortët mund t'i disponojnë lirisht të drejtat dhe detyrimet e tyre, këto të drejta ndahen në: të drejtat dhe detyrimet personale, që nuk mund të bëjnë marrëveshje, apo që nuk varen nga vullneti i tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet personale, me të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje, apo t'i disponojnë lirisht me to.

Në këtë grup hyjnë të drejtat personale, të cilat janë të rregulluara me norma ligjore urdhëruese, si: jeta e përbashkët e bashkëshortëve, barazia e bashkëshortëve, pavarësia e bashkëshortëve në zgjedhjen e punës dhe të profesionit, besnikëria bashkëshortore dhe ndihma reciproke midis bashkëshortëve. Këto të drejta janë të rregulluara me norma të karakterit urdhërues (*jus cogens*), që do të thotë se bashkëshortët nuk mund t'i rregullojnë ndryshe, përpos siç janë parashikuar me dispozita ligjore.

a) *Bashkëshortët nuk mund të vendosin për jetën e përbashkët, sepse jeta e përbashkët nuk duhet ngatërruar me vendbanimin e përbashkët, pasi që jeta e përbashkët është kategori shumë më e gjerë sesa vendbanimi i përbashkët. Jeta e përbashkët është e*

rregulluar me norma të natyrës *jus cogens*, domethënë, bashkëshortëve nuk u lejohet mundësia e vendosjes, ndryshe nga ajo që parashikohet me dispozita ligjore.

b) *Barazia e bashkëshortëve*- është e garantuar me dispozita kushtetuese dhe ligjore. Ndërsa barazia garantohet jo vetëm në sferën e të drejtave personale, por edhe në të marrëdhënieve pasurore.

c) *Pavarësia e bashkëshortëve për të zgjedhur punën dhe profesionin*- kjo nënkupton faktin se bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin lirisht punën dhe profesionin e tyre. Kjo e drejtë u garantohet edhe me dispozitën e nenit 44, paragrafi 5 të LFK-së, ku përcaktohet se secili bashkëshort është i pavarur në zgjedhjen e punës dhe të profesionit. Në këtë drejtim secili bashkëshort mund të vazhdojë të njëjtin profesion që ka pasur para lidhjes së martesës apo të zgjedhë një tjetër, sipas vullnetit të tij të lirë dhe pa marrë pëlqimin e bashkëshortit tjetër.⁵⁵

Kjo është paraparë edhe në Legjislacionin Shqiptar.⁵⁶

d) *Detyrimi i ndihmës dhe i respektimit*- manifestohet në dy aspekte: në atë moral dhe material. Në aspektin moral shprehet në detyrimin që ka njëri bashkëshort për t'i ofruar mbështetje morale dhe emocionale bashkëshortit në nevojë; ndërsa në aspektin material ky është detyrim për ta mbajtur familjen, ose për t'i përmbushur të gjitha nevojat e jetës së bashkëshortit tjetër, që nuk është në gjendje t'i përmbushë ato vetë.

e) *Besnikëria bashkëshortore*- nënkupton faktin se bashkëshortët kanë për detyrë t'i qëndrojnë besnikë njëri tjetrit, sidomos në sferën e marrëdhënieve seksuale; në të kundërt, është paraparë mundësia ligjore që të ngrihet padi për zgjidhje të martesës për këtë shkak.⁵⁷ LFK-ja në dispozitën e nenit 42, përcakton të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, respektivisht të drejtat dhe detyrimet që dalin nga martesa ligjore civile e që nënkupton martesën e lidhur para ofiqarit të gjendjes civile. Neni 42 rregullon në veçanti barazinë e bashkëshortëve në marrëdhëniet personale dhe pronësore, përkufizimin e kohëzgjatjes së martesës, besnikërinë e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit, ndihmën reciproke të tyre, respektin reciprok, mbështetjen financiare të njëri tjetrit, solidaritetin

⁵⁵ Sonila Omari “E drejta familjare”, Tiranë, 2012 f.82

⁵⁶ Neni 63 i Kodit të familjes së Shqipërisë

⁵⁷ Neni 69, paragrafi 2 i LFK-së

reciprok të tyre si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë, apo të adoptuar.

3.3.2. Të drejtat dhe detyrat personale, për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje

Këto të drejta janë të rregulluara me norma të karakterit dispozitiv, që do të thotë se bashkëshortët mund t'i rregullojnë me marrëveshje dhe ndryshe nga sa parashikohet me ligj. Këto janë: caktimi i mbiemrit, caktimi i vendbanimit, lindja e fëmijëve, apo planifikimi i familjes, ekonomia e përbashkët familjare, caktimi i shtetësisë etj.

a) *Caktimi i mbiemrit*- mbiemri caktohet me marrëveshje të bashkëshortëve, ndërsa këtë LFK-ja e rregullon me dispozitën e nenit 43, ku bashkëshortët kanë shumë alternativa, p.sh. secili bashkëshort ta mbajë mbiemrin e vet, apo që njëri të marrë mbiemrin e bashkëshortit tjetër etj.

b) *Caktimi i vendbanimit*- për këtë vendosin lirisht bashkëshortët. Këtë moment e parashikon edhe LFK-ja⁵⁸, kur thekson se bashkëshortët vendosin vetë për vendin e banimit.

c) *Vendosja për numrin e fëmijëve dhe për kryerjen e punëve në bashkësi martesore*-bashkëshortët me marrëveshje vendosin bashkërisht sa fëmijë do të kenë, si do t'i rrisin, arsimojnë, edukojnë etj.

d) *Caktimi i shtetësisë*- dihet se shtetësia është lidhje juridike midis një njeriu dhe një shteti, ndërsa rregullorja ligjore u mundëson bashkëshortëve që ata të zgjedhin lirisht shtetësinë që duan të mbajnë.

Në legjislacionin e Shqipërisë janë të paraparë edhe disa të drejta tjera për të cilët bashkëshortët janë të pavarur në zgjedhjen e tyre si: Liria dhe fshehtësia e korrespondencës, e drejta e ndërprerjes së shtatzënisë së padëshiruar.

⁵⁸ Neni 44, paragrafi 3 i LFK-së

3.4 Parimet e procedurës në kontestet martesore

Parimet kryesore të procedurës së zgjidhjes së martesës janë:

a) Parimi i mbrojtjes së veçantë të personave në procedure.

Sipas këtij parimi, gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë fazës të zhvillimit të procedurës së shkurorezimit të kujdeset për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave më të larta të fëmijëve të mitur si dhe personave me sëmundje psikike dhe pazotësi veprimi, që nuk janë në gjendje që të kujdesen për të drejtat dhe interesat e tyre.

b) Parimi i përjashtimit të publikut.

Ky parim në konteste martesore është themelor. Me nenin 75 të LFK-së është rregulluar ky parim, ku është parashikuar se: “*Publiku përjashtohet në procedurat e kontestit martesor*”. Qëllimi i këtij parimi është ruajtja e fshehtësisë të marrëdhënieve martesore në mes të bashkëshortëve, sepse në këto konteste shqyrtohen dhe zbulohen fakte të cilat prekin të drejtat personale të pjesëmarrësve në procedurë e që lidhën ngushtë me privatësinë e tyre të garantuar me ligj.

Parimisht puna e gjykatave është publike dhe pjesëmarrja e publikut është e lejuar.⁵⁹ Megjithatë, në këto konteste, për arsyet e cekura më lart, përjashtohet publiku. Përveç kësaj, edhe LPK ka lejuar përjashtimin e publikut në raste të caktuara.⁶⁰ Ruajtja e privatësisë është një e drejtë e garantuar edhe me akte ndërkombëtare.⁶¹

Kuptimi i kësaj dispozite është zgjeruar në mënyrë të tillë që në procedurë të përfshihen edhe ekspertët, prokurori dhe Organi i Kujdestarisë, kur është kërkuar nga ligji.

c) Parimi i disponibilitetit

Bashkëshortët janë të lirë të paraqitin prova dhe material tjetër procedural, në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës, për zgjidhje, apo anulim të martesës. Mirëpo, nuk do të thotë se gjykata në këto kontekste ka rol pasiv në sigurimin e provave. Përkundrazi, gjykata ka rol aktiv dhe mundet të hetojë edhe ato fakte, mbi të cilat palët mbështesin kërkesat e tyre e të cilat nuk i kundërshtojnë. Me nenin 85.1 të LFK- së është përcaktuar se “*faktet mbi të cilat pala mbështet kërkesën e saj në kontestet martesore, gjykata mund*

⁵⁹ Neni 7, paragrafi 4, LGJ.

⁶⁰ Neni 4, paragrafi 3 i LPK-së, gjykata e shqyrton çështjen në seancë jopublike vetëm më rastet e përcaktuara me ligj.

⁶¹ Neni 8, paragrafi 1 i KEMDNJ-së

t'i konsiderojë si të kontestueshme, edhe atëherë kur ato fakte janë të pa kontestueshme ndërmjet palëve”.

Sipas dispozitës së nenit 70.2 të LFK-së, bashkëshortët, së bashku me propozimin për shkurorezim me marrëveshje të dyanshme janë të detyruar të parashtrojnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët, si dhe propozimin me shkrim mbi mënyrën se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të sigurohen në të ardhmen. Në qoftë se konstatohet se këto marrëveshje nuk janë në pajtim me interesat më të larta të fëmijëve, mundet që gjykata t'ua kthejë marrëveshjen palëve, në mënyrë që atë ta harmonizojnë me interesat e fëmijëve, apo ta rregullojnë atë me qëllim të mbrojtjes së interesave të fëmijëve të mitur.

d) Parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit

Veçori e procedurës për zgjidhjen e kontesteve martesore, e cila e dallon atë nga procedura kontestimore, është kufizimi i dukshëm i mundësisë së kryerjes së veprimeve disponibile. Palët, në të gjitha rastet, nuk mund të disponojnë objektin e kontestit; madje ekzistojnë raste të përcaktuara me dispozita ligjore, kur ato nuk mund të iniciojnë as procedurë gjyqësore. Kështu, sipas dispozitës së nenit 70.1 të LFK-së përcaktohet se *“bashkëshortët nuk do të parashtrojnë padi për shkurorezim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të këtë mbushur një vit”*. Ndërsa sipas nenit 137 të KFSH-së, në rastin e gruas shtatzënë, me kërkesën e saj gjykata mund të pezullojë gjykimin e padisë për zgjidhjen e martesës, por jo më tepër se një vit nga momenti i lindjes së fëmijës.⁶² Për dallim nga KFSH, i cili lejon paraqitjen e padisë në gjykatë, edhe në rastet kur gruaja është shtatzënë, legjislacioni kosovar ndalon paraqitjen e padisë për shkurorezim gjatë kohës, derisa gruaja është shtatzënë dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të mbushë një vit.⁶³

Rast tjetër kufizimi i këtij parimi është kur gjykata duhet të hetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë parashtruar e, edhe ato të cilat nuk janë kontestuar midis tyre.

Në këto konteste nuk mund të jepet aktgjykim në bazë të pohimit dhe aktgjykim për shkak të mungesës, siç mund të ndodhë në procedurat e tjera kontestimore.

⁶² Neni 137 i KFSH-së

⁶³ Neni 70 Paragrafi 1 i LFK-së

Procedura e anulimit të martesës mund të iniciohet për shkaqet e përcaktuara me ligj, edhe nga personat e tjerë e jo vetëm nga bashkëshortët. Sipas nenit 67 të LFK-së, përkatësisht paragrafit 1 të këtij neni, është parashikuar që:

“personat që kanë të drejtë të parashitrojnë padi për anulimin e martesës për shkaqet parapara në këtë Ligj janë bashkëshortët, prokurori publik dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë juridik për anulimin e martesës.”

Edhe kjo është një karakteristikë themelore e procedurës për zgjidhjen e martesës duke e bërë këtë procedurë specifike dhe të veçantë në shumë aspekte.

3.5 Mënyrat e shkurorëzimit

Procedura e shkurorëzimit ka disa specifika që e dallojnë atë nga procedurat e tjera civile. Meqenëse marrëdhëniet të cilat rregullohen në kontestet martesore janë të natyrës personale, ato dallojnë nga marrëdhëniet pasurore juridike si për nga rëndësia, ashtu edhe për nga natyra.⁶⁴ Ligjit mbi Familjen i Kosovës, parashikon dy mënyra të nisjes së procedurës së shkurorëzimit:

- Procedura e propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje.
- Procedura e paraqitjes së padisë për shkurorëzim.

3.5.1 Propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje

Të dy bashkëshortët, kur nuk janë pro pajtimit, mund të paraqesin propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje. Ata bashkërisht çmojnë se e vetmja zgjidhje për ta është t'i japin fund kësaj lidhjeje, ku nuk ka vend më as për dashuri, respekt dhe mirëkuptim reciprok.⁶⁵ Ligji i Kosovës për Familjen ka parashikuar mundësinë që bashkëshortët ta zgjidhin martesën me marrëveshje. Në këtë rast, që të dy bashkëshortët janë pajtuar dhe dëshirojnë që martesën ta zgjidhin me marrëveshje. Mirëpo procedura për zgjidhjen e martesës detyrimisht duhet të iniciohet para gjykatës kompetente, ngase martesë mund të zgjidhet me shkurorëzim, vetëm në bazë të vendimit të gjykatës kompetente. Deri me nxjerrjen e Ligjit të ri, mbi Gjykatat kanë vendosur Gjykatat e Qarkut, ndërsa tani, me riorganizimin e ri të gjykatave, kompetente për shkurorëzim janë Gjykatat Themelore. Edhe pse marrëveshja për shkurorëzim ka disa efekte në procedurën

⁶⁴ Po aty, f. 126

⁶⁵ Mandro, Arta, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009, f. 306

e shkurorëzimit, ajo dallon nga procedura e iniciuar me padi, sepse gjykata, me rastin e shqyrtimit të propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, nuk i vlerëson shkaqet e shkurorëzimit, meqë si shkak i zgjidhjes së martesës me marrëveshje është marrëveshja, gjegjësisht pajtimi i bashkëshortëve, që ta zgjidhin atë. Kjo mënyrë e shkurorëzimit dallon nga ajo e paraqitjes së padisë, pasi këtu, midis bashkëshortëve nuk ka çështje kontestuese dhe është një procedurë më e shkurtër dhe më me pak pasoja, se ajo me padi.

Gjykatat gjatë procedurës për zgjidhjen e martesës duhet të kenë parasysh parimin e përgjithshëm për ruajtjen e martesës. Për këtë qëllim, palët në procedurë, gjegjësisht bashkëshortët, duhet të inkurajohen dhe të ndërmarrin të gjitha aktivitetet e nevojshme përmes këshillimit, apo procedurës së pajtimit për ta ruajtur martesën. Gjatë zgjidhjes së martesës gjykata duhet t'i këtë parasysh që kjo të bëhet me sa më pak shqetësime për bashkëshortët dhe fëmijët; të promovohen sa më mirë marrëdhëniet e vazhdueshme në mes të prindërve dhe fëmijëve dhe sa më pak shpenzime.

Me rastin e ushtrimit të propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, nëse propozuesit kanë fëmijë, propozimit të tyre ata duhet t'i bashkëngjisin marrëveshjen me shkrim, e cila duhet të përmbajë edhe çështjen për përkujdesjen e fëmijëve të mitur, edukimin, rritjen e tyre; çështjen e bashkëshortit nevojtar, si dhe propozimin me shkrim mbi mënyrën se si do të sigurohet kontakti personal mes fëmijës dhe dy prindërve për të ardhmen. Gjykata mund ta refuzojë aprovimin e marrëveshjes, nëse vërteton se të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve janë caktuar në mënyrë të padrejtë. Në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë, gjykata ka një rol më aktiv sa i përket vërtetimit të ekzistencës të fakteve që shkojnë në drejtim të kufizimit të mundësisë së shkurorëzimit. Kjo është e paraparë edhe në legjislacionin e Shqipërisë.⁶⁶

Në rastet kur njëri bashkëshort ka paraqitur padi në gjykatë për zgjidhjen e martesës, ndërsa bashkëshorti tjetër nuk e kundërshton padinë, në këto raste padia e paraqitur nga njëri bashkëshort konsiderohet si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës. Bashkëshortët mund ta tërheqin propozimin e përbashkët për zgjidhjen e martesës, derisa aktgjykimi mbi shkurorëzimin të marrë formën e prerë.⁶⁷ Edhe në rastet kur vetëm njëri nga bashkëshortët heq dorë nga propozimi, konsiderohet se ai është tërhequr në tërësi dhe nga të dy propozuesit.

⁶⁶ Neni 70 i LFK-së

⁶⁷ Po aty, Neni 86, paragrafi 2

Edhe KFSH parashikon mundësinë që bashkëshortët, me pëlqimin e tyre reciprok, t'i bëjnë kërkesë gjykatës për miratim për zgjidhjen e martesës. Bashkëshortët mund ta paraqesin kërkesën personalisht, ose përmes përfaqësuesve të tyre. Me këtë rast gjykata do të vendosë që të bëjë zgjidhjen e martesës, kur krijon bindjen se pëlqimi dhe vullneti i bashkëshortëve është real dhe pëlqimin e kanë dhënë me vullnetin e lirë e pa ndonjë presion.

3.5.2 Shkurorëzimi i njëanshëm apo me padi

Kur njëri nga bashkëshortet ushtron padi kundër dëshirës së bashkëshortit tjetër, ky është vullneti i njëanshëm në zgjidhjen e martesës. Nga kjo rezulton se, procedura e shkurorëzimit me padi, në dallim nga ajo me marrëveshje, është kur kjo procedurë inicohet vetëm nga njëri prej bashkëshortëve, - ndërsa te shkurorëzimi me marrëveshje kemi vullnetin e të dy bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës.

Padia për shkurorëzimin e martesës ushtrohet pranë gjykatës kompetente. Sipas dispozitave të Ligjit për Familjen të Kosovës, si tek shkurorëzimi me marrëveshje, ashtu edhe tek shkurorëzimi me padi, gjykata e zgjidh këtë martesë gjithmonë me aktgjykim.

Përderisa te procedura e shkurorëzimit me marrëveshje nuk ka çështje kontestuese, kur inicohet padia për shkurorëzim, vetë procedura ka disa çështje kontestuese siç mund të jenë: mospajtimi i njërit bashkëshort për zgjidhjen e martesës, besimi i fëmijëve, ushqyerja, kontakti i fëmijëve si dhe çështjet pasurore. Meqenëse në procedurën me padi kemi kontest, nga kjo rrjedh se procedura e zgjidhjes së martesës është më e gjatë, më e vështirë dhe me pasoja më të mëdha për bashkëshortët dhe fëmijët. E drejta në padi është një e drejtë personale e individit dhe në emër të tij, askush nuk mund të paraqet padi në gjykatë. Nga ky rregull bën përjashtim vetëm rasti i kujdestarit që mund të paraqet padi për shkurorëzim në emër të bashkëshortit, kur ky vuan nga ndonjë sëmundje psikike e diagnostikuar, apo në emër të personit të paafte, për të vepruar vetëm me pëlqimin e mëparshëm të Organit të Kujdestarisë.⁶⁸

E drejta e paraqitjes së padisë si e drejtë personale nuk trashëgohet, mirëpo për të vërtetuar bazën e padisë së paraqitur nga njëri bashkëshort, trashëgimtari mund të vazhdojë procedurën pas vdekjes së paditësit dhe martesa zgjidhet me aktgjykim. Trashëgimtarët, vazhdimin e procedurës së zgjidhjes së martesës e bëjnë në rastet kur

⁶⁸ Po aty, Neni 74

kanë ndonjë interes juridik për vërtetimin e fajësisë, ose pafajësisë së njërit nga bashkëshortët me aktgjykim të gjykatës.⁶⁹

Pala e paditur gjatë zhvillimit të procedurës së shkurorëzimit ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kundër paditësit, nëse kërkesat e kundërpadisë kanë lidhje me kërkesëpadinë e paditësit. Kundërpadia mund të paraqitet deri në përfundimin e procedurës për zgjidhjen e martesës. Bashkëshortët kanë të drejtë ta tërheqin padinë, pasi ajo është e lidhur me personalitetin e tyre.

Gjithashtu, edhe sipas KFSH-së, çdo bashkëshort mund të paraqesë padi për zgjidhjen e martesës në gjykatën kompetente për shkaqet e parapara me ligj. Me rastin e zhvillimit të procedurës për zgjidhjen e martesës, gjykata vendos edhe për fajësinë, vetëm në rastet kur këtë e kërkon njëri bashkëshort, apo që të dy. LFK nuk parashikon mundësinë sipas së cilës gjykata të vendosë lidhur me fajësinë me rastin e vendosjes për zgjidhjen e martesës. Në praktikë, në disa pjesë të Kosovës, e drejta zakonore ende ka ndikim duke u nisur nga fakti se bashkëshortët paraprakisht me ndërmjetësimin e pleqve e bëjnë zgjidhjen e martesës dhe më pas i drejtohen gjykatës me padi për zgjidhjen e saj.⁷⁰

3.5.3 Tërheqja e padisë

Në kontestet për shkurorëzim paditësi mund ta tërheqë padinë, deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore pa pajtimin e të paditurit; kurse me pajtimin e të paditurit, derisa procedura nuk ka përfunduar në formë të prerë. Ndërsa propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje, bashkëshortët mund ta tërheqin derisa aktgjykimi mbi shkurorëzimin të marrë formën e prerë. Do të konsiderohet se është tërhequr propozimi edhe kur nga propozimi heq dorë njëri bashkëshort.⁷¹

Për dallim prej procedurave të tjera gjyqësore kontestimore, ku paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit, më së largu, deri sa i padituritë paraqesë përgjigje në padi⁷²; në kontestet e shkurorëzimit këtë të drejtë mund ta shfrytëzojë deri në përfundimin e seancës kryesore. Pas kësaj periudhe e deri sa procedura të përfundojë në

⁶⁹ Po aty, neni 68 paragrafi 3

⁷⁰ Procesverbali i datës 18.11.2011, i hartuar në fshatin Sibovc- Podujevë, Kosovë

⁷¹ Neni 86 i LFK-së

⁷² Neni 261, paragrafi 1 i LPK-së

formën e prerë, padia mund të tërhiqet, por për këtë duhet që të jepet pëlqimi nga i padituri. Nëse i padituri nuk jep pëlqimin, atëherë gjykata duhet të zhvillojë procedurën e rregullt dhe të marrë vendim. Në këto konteste, heqja dorë nga kërkesëpadia ka efekt të njëjtë, sikurse edhe tërheqja e padisë, apo e propozimit të përbashkët.⁷³

Bashkëshortët, në rast se kanë paraqitur propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, mund ta tërheqin propozimin, derisa aktgjykimi mbi zgjidhjen e martesës të marrë formë të prerë. Gjithashtu, edhe në rastet kur njëri bashkëshort tërhiqet nga propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës, do të konsiderohet se është tërhequr propozimi.

Në rastet kur në seancën gjyqësore nuk paraqitet paditësi dhe nuk e arsyeton mungesën, do të konsiderohet se është tërhequr padia e paditësit, gjithashtu edhe në rastet kur bashkëshortët paraqesin propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës.

3.6 Kundërpadia

Në LFK nuk është parashikuar shprehimisht se i padituri, gjatë gjykimit në kontestin martesor ka të drejtë kundërpadie. Mirëpo një gjë e tillë mund të bëhet sipas rregullave të LPK-së për kundërpadi.

I padituri mund ta ngrejë kundërpadinë sikurse në gjykimin sipas padisë për shkurorëzim, apo anulim të martesës. Në qoftë se në padi paditësi kërkon shkurorëzimin, i padituri në kundërpadi mund të kërkojë, për shembull, anulimin e saj. Për kërkesën e padisë dhe kundërpadisë, gjykata duhet të vendosë në mënyrë meritore me një aktgjykim të vetëm.⁷⁴

3.7 Fazat e procedurës së shkurorëzimit

Procedura në kontestet e zgjidhjes së martesës është e rregulluar me norma juridike ligjore imperative, siç është ligji i Kosovës për Familjen. Mirëpo ky ligj nuk e ka rregulluar në tërësi procedurën për zgjidhjen e martesës. Në rast të mungesës së këtyre dispozitave, zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Dispozitat e LFK kanë përparësi në raport me ato të LPK-së, sepse Ligji i familjes është ligj special.

⁷³ Dr. Faik Brestovci, E Drejta e Procedurës Civile, Prishtinë 2002, f. 285

⁷⁴ Dr. Faik Brestovci, vepra e cituar, f. 284

Procedura e shkurorëzimit inicohet me propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, apo me padi. Nga kjo rezulton se shkurorëzimi mund të bëhet vetëm me procedurë gjyqësore, pavarësisht a ekziston marrëveshja për zgjidhjen e martesës, apo është ushtruar padia, që do të thotë se kusht qenësor për fillimin e procedurës pranë gjykatës kompetente është parashtrimi i padisë, apo i propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës. Padinë mund ta paraqesë secili nga bashkëshortët, pavarësisht se cili është përgjegjës lidhur me mosmarrëveshjet gjatë bashkësisë martesore.

Pas dorëzimit të propozimit dhe të padisë, gjykata e shqyrton këtë çështje me prioritet për shkak se procedura e shkurorëzimit ka disa specifika të natyrës dhe të kompleksitetit të marrëdhënieve familjare, meqë kontestet familjare janë shumë të ndjeshme, posaçërisht në procedurën e shkurorëzimit, për shkak se shqyrtohen të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve dhe fëmijëve. Me rastin e shqyrtimit të padisë apo të propozimit për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, procedura e shkurorëzimit zhvillohet në disa faza:

- faza e procedurës së përpjekjes së pajtimit
- caktimi i masave të përkohshme,
- seanca e shqyrtimit kryesor,
- marrja e aktgjykimit.

Të njëjtat faza i parashikon edhe KFSH.

3.7.1 Procedura e përpjekjes së pajtimit të bashkëshortëve

Gjykata ka për detyrë që të mbajë seancën e pajtimit, me qëllim që, nëse bashkëshortët arrijnë deri te pajtimi, ata të mund t'i rikthehen bashkësisë martesore. Nga kjo rrjedh se gjykata nuk do ta bëjë zgjidhjen e martesës, derisa të mos tentohet për pajtimin e bashkëshortëve në seancë të veçantë dhe kur gjykata vjen në përfundim se seanca e tentim pajtimit nuk ka pasur sukses. Në procedurën e shkurorëzimit, të paditurit nuk i dërgohet padia para mbajtjes së seancës së pajtimit, por vetëm pasi ajo dështon, ndërsa, në dallim nga kjo, në procedurën kontestimore padia i dërgohet të paditurit para caktimit të seancës. Edhe sipas legjislacionit shqiptarë është e paraparë procedura e pajtimit, përkatësisht seanca e pajtimit të bashkëshortëve, e cila duhet të caktohet fillimisht gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës.⁷⁵

⁷⁵ Neni 134 i KFSH - së

Në Ligjin mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare të Kosovës ka qenë e parashikuar që, në kontekstet e zgjidhjes së martesës, padia i dërgohet palës së paditur për të dhënë përgjigje në padi (kundërshtuar padinë), vetëm pasi të ketë përfunduar pa sukses seanca e tentim pajtimit. Një dispozitë e tillë nuk është parashikuar në Ligjin e Kosovës për Familjen. Në një përgjigje (nr. 94/13 date: 12.02.2013) të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës, theksohet se duke u bazuar në dispozitat e nenit 349 të LFK-së, sipas të cilit, për rastet e parapara me këtë ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, dorëzimi i padisë, palës së paditur për të dhënë përgjigje në padi, edhe kur kemi të bëjmë për kontekstet e shkurorëzimit; duhet t'i dorëzohet palës së paditur para seancës së pajtimit në mënyrë analoge, ashtu siç veprohet në kontekste tjera për paditë civile.

Në bazë të nenit 2 paragrafi 2 të LFK-ës, parashikohet se familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje.⁷⁶

Seanca e tentim pajtimit është procedurë e rëndësisë së veçantë, përmes se cilës tentohet të arrihet pajtimi i bashkëshorteve në mënyrë që të rivendoset bashkësia martesore. Në bazë të nenit 77 të LFK-së, gjykata detyrohet që të organizojë seancën e tentim pajtimit të bashkëshorteve, sepse pa organizimin e seancës së tentim pajtimit, ajo nuk mund të nxjerrë aktgjykim për shkurorëzim, ngaqë është e domosdoshme përpjekja për pajtim të bashkëshorteve. Sipas KFSH-së kur procedura ka filluar sipas kërkesës së përbashkët me pëlqim reciprok gjykata nuk do të bëjë përpjekje për pajtim por do të caktojë menjëherë seancën gjyqësore për të shqyrtuar kërkesën e përbashkët të bashkëshortëve.⁷⁷

Në këtë seancë duhet të marrin pjesë domosdoshmërisht të dy bashkëshortët, në të kundërt, ajo nuk mbahet. Seanca e tentim pajtimit nuk do të mbahet në rast se: njëri nga bashkëshortët është i paafte për të vepruar, kur njëri apo dy bashkëshortet jetojnë jashtë vendit, kur nuk dihet vendbanimi i njërit nga bashkëshortët.⁷⁸ Dispozitat e Ligjit të Kosovës për Familjen kanë parashikuar mundësinë që seanca e tentim pajtimit të zhvillohet tek Organi i Kujdestarisë kur bashkëshortet kanë fëmijë, andaj ky organ duhet të zbatojë metodat e punës sociale, metodat tjera profesionale dhe duke shfrytëzuar shërbimet e këshillimores për martesë dhe familje si dhe institucioneve të tjera

⁷⁶ Sonila Omari, vepra e cituar, faqe 218

⁷⁷ Neni 2, paragrafi 2 i LFK -së

⁷⁸ Po aty, Neni 76

profesionale.⁷⁹ Kjo mundësi paraqitet të jetë shumë e arsyeshme kur dihet se Organi i Kujdestarisë, përkatësisht Qendrat për Punë Sociale, në kuadër të të cilit funksionon Organi i Kujdestarisë, kanë në përbërje të tyre ekspertë të fushave të ndryshme, andaj edhe procedura e tentim pajtimit të bashkëshortëve, do të zbatohet pranë Organit të Kujdestarisë shumë më mirë dhe në mënyrë të efektshme.

Në raport, do të vlerësohet se në çfarë kushtesh për jetën dhe zhvillimin ndodhen fëmijët e mitur dhe do të mbrohen interesat e tyre, duke ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar që edukimi, siguria dhe mbajtja financiare, janë marrë parasysh në çfarëdo marrëveshje nga ana e bashkëshorteve. Procedura e pajtimit nuk mund të zgjasë më tepër se tre muaj dhe QPS, pa vonesë do të hartojë raportin me shkrim lidhur me suksesin e pajtimit, duke ia dërguar më pas gjykatës.

Pas përfundimit të seancës se tentim pajtimit organi i kujdestarisë njofton gjykatën me anë të një raporti lidhur me rezultatin e seancës se tentim pajtimit. Procedura e tentim pajtimit pranë organit të kujdestarisë nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj, por mund të vazhdohet nëse bashkëshortet pajtohen që të vazhdojnë një procedurë të këtillë, pas përfundimit të këtij afati.⁸⁰ Kjo nënkupton se ky afat nuk është prekluziv. Arsyeja e seancës së pajtimit është që eventualisht bashkëshortët t'i analizojnë dhe rishqyrtojnë rrethanat dhe mundësitë për ruajtjen e martesës, që të mos nguten për shkurorëzim, duke marr parasysh pasojat e rënda që ka shkurorëzimi në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur.

LFK-ja parashikon procedurë të saktë në lidhje me vendosjen e gjykatës në kontestet martesore. Në vështrim të nenit 76 përcaktohet detyrimi i gjykatës që aktgjykimin për shkurorëzim duhet ta marrë pas një periudhe të përpjekjeve për pajtim të zhvilluar nga gjykata në seanca të veçanta. Kjo seancë mbahet para kryetarit të trupit gjykues. Në seancë mund të marrin pjesë vetëm bashkëshortët personalisht, e jo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Prandaj, gjykata as që do ta caktojë mbajtjen e kësaj seance kur njëri prej bashkëshortëve është i paaftë për të vepruar, kur njëri apo të dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit dhe kur nuk dihet vendbanimi i njërit nga bashkëshortët.⁸¹

Në qoftë se në seancën e caktuar për pajtim nuk vjen njëri ose që të dy bashkëshortët, edhe pse janë ftuar në mënyrë të rregullt dhe asnjëri prej tyre nuk e arsyeton mungesën, gjykata, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, do të çmojë nëse do të

⁷⁹ Po aty, Neni 80

⁸⁰ Neni 83 paragrafi i LFK - së

⁸¹ Po aty, Neni 6.4.

caktojë apo jo një seancë të re për përpjekjen e arritjes së pajtimit ose do të konsiderojë se pajtimi ka dështuar.⁸² Gjatë seancës gjykata u shpjegon bashkëshortëve rëndësinë e martesës dhe pasojat negative që mund të paraqiten në rast të zgjidhjes së martesës. Nëse në seancën e parë nuk arrihet pajtimi, gjykata mund të caktojë një ose disa seanca të reja, derisa të vlerësojë se nuk ka gjasa për një gjë të tillë.

Një seancë të tillë gjykata e cakton edhe në rastet kur shkurorëzimi kërkohet me anë të propozimit të përbashkët. Në këtë rast, kur njëri apo të dy bashkëshortët nuk paraqiten në seancën, ku bëhen përpjekje që të arrihet pajtimi dhe mungesa e tyre nuk arsyetohet, do të konsiderohet se ata e kanë tërhequr propozimin. Sipas kësaj dispozite, ligjvënësi i jep përparësi pajtimit të bashkëshortëve, kur ata mungojnë në seancën e pajtimit duke e autorizuar gjykatën që të vendosë vetë.

Organi i Kujdestarisë ka kompetencën që të kujdeset në çdo rast për mbrojtjen e interesave të fëmijëve duke përfshirë këtu edhe rastet e shkurorëzimit.⁸³

Me shkresën me të cilën gjykata ia kalon procedurën e zhvillimit të pajtimit Organit të Kujdestarisë, ky i fundit njoftohet lidhur me datën e fillimit të procedurës për shkurorëzim, shkaqet kryesore për të cilat kërkohet shkurorëzimi si dhe për faktin se bashkëshortët kanë fëmijë të mitur. Kompetent për procedurën e pajtimit, përveç organit të kujdestarisë në territorin e të cilit i padituri ka vendbanimin apo vendqëndrimin, është edhe organi në territorin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët (neni 81.1 LFK-së). Ndërsa kur procedura fillon me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, kompetent për procedurën e pajtimit të bashkëshortëve, përveç organit të kujdestarisë në territorin e të cilit e ka vendbanimin ose vendqëndrimin njëri prej bashkëshortëve, është edhe organi në territorin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

Organi i Kujdestarisë ka për detyrë që pa vonesë t'i dërgojë gjykatës raportin më shkrim lidhur me rezultatin e procedurës së pajtimit (neni 83 i LFK).

Faza e pajtimit të bashkëshortëve parashikohet si mundësi për ruajtjen e martesës, sepse është edhe në interes të shoqërisë, ruajtja e martesave dhe familjeve të shëndosha, sidomos kur merret në konsideratë fakti së shkurorëzimi shkakton pasoja lidhur më fëmijët, veçanërisht për mbajtjen e tyre.

⁸² Neni 75, paragrafi 2 i LFK-së

⁸³ Po aty Neni 79, paragrafi 2

Edhe KFSH parashikon seancën e pajtimit, në të cilën bashkëshortët duhet të paraqiten personalisht. Gjyqtari fillimisht mund t'i dëgjojë ata veç e veç dhe më pas, të dy bashkë, pa praninë e përfaqësuesve të tyre, nëse ata eventualisht kanë përfaqësues. Në rastet kur pajtimi ka sukses, gjykata mban procesverbal dhe gjykimi i çështjes pushohet. Në rastet kur në seancën e pajtimit nuk paraqitet paditësi dhe i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt por nuk e ka arsyetuar mungesën, gjyqtari merr vendim për pushimin e gjykimit të çështjes. Në rastin e kundërt, kur në seancë nuk paraqitet i padituri dhe i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjyqtari e shtyn seancën e pajtimit, duke e ftuar përsëri të paditurin. Nëse edhe në seancën e dytë nuk paraqitet i padituri dhe nuk e arsyeton mungesën, gjykata ka mundësi që gjykimin ta mbajë në mungesë të pranisë së palës së paditur dhe pasi ta dëgjojë palën paditëse, krijon bindjen se pajtimi nuk ka sukses; atëherë caktohet seanca e shqyrtimit, duke urdhëruar paraqitjen e provave të nevojshme. Sipas ligjit shqiptar, procedurën e pajtimit e zhvillon vetëm gjykata dhe asnjë organ tjetër jashtë saj. Në Kosovë, në të gjitha rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, seancën e pajtimit fillimisht e bën Qendra Për Punë Sociale, e cila përpilon raportin me shkrim duke u bazuar në metodat e punës sociale dhe profesionale dhe duke vlerësuar rrethanat sociale dhe ekonomike, raportet e bashkëshortëve dhe jep mendim lidhur me faktin se kujt duhet t'i besohen fëmijët.

3.7.2 Caktimi i masave të përkohshme

Në këto rrethana, gjykata me aktvendim mund të caktojë masa të përkohshme për çështjet që janë me interes për fëmijët apo bashkëshortin, të cilat nuk mund të shtyhen deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Këto masa mund të caktohen lidhur me detyrimin e ushqimit të fëmijëve, mbajtjen financiare të bashkëshortit, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur, si dhe caktimin e kontaktit të fëmijëve me prindin. Këto vendime mund të merren sipas propozimit të palës, apo edhe sipas detyrës zyrtare nga ana e gjykatës, kur ajo vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës. Masa e caktuar është e përkohshme dhe zgjat deri sa të përfundojë procedura me aktgjykim të formës së prerë. Me ndryshimin e rrethanave edhe aktvendimi mund të ndryshohet dhe ky vendim krijon efekte të përkohshme juridike për palët. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme. Ligji për Familjen, në nenin 327 parasheh caktimin *ex officio* të masave të përkohshme për mbajtjen financiare të fëmijëve të mitur, kur ka filluar procesi për zgjidhjen e

martesës. Mbajtja financiare e fëmijës vendoset sipas detyrës zyrtare. Gjykata pranë së cilës ka filluar procedura, ka për detyrë që, menjëherë pas njoftimit për nisjen e një procedure të tillë, në rastin kur të dy prindërit nuk kontribuojnë me efektivitet në mbajtjen financiare të fëmijës, të marrë zyrtarisht vendim për t'i detyruar këta të fundit që të kontribuojnë financiarisht në mbajtjen e fëmijëve të tyre.

Në rastet kur prindi, që në bazë të vendimit të gjykatës është i detyruar të ofrojë shumën e përcaktuar për mbajtje financiare nuk e kryen detyrimin rregullisht; atëherë Organi i Kujdestarisë në bazë të kërkesës së prindit tjetër, apo sipas detyrës zyrtare, duhet të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për t'i ofruar fëmijës mbajtje financiare të përkohshme, në përputhje me dispozitat mbi mbrojtjen sociale të fëmijës.⁸⁴ Këto masa zgjasin për aq sa prindi nuk i përmbush detyrimet e tij, kurse ndaj këtij të fundit do të nisë zbatimi i masave, nëse vlerësohet se është e domosdoshme.⁸⁵

Neni 328 i LFK-së parashikon mundësinë e nxjerrjes së masave të përkohshme për ushqimin e fëmijëve madhorë, por në këto raste gjykata vendos vetëm me kërkesë të paditësit, respektivisht përfaqësuesit të saj, e jo sipas detyrës zyrtare. Këto situata mund të paraqiten në rastet kur një fëmijë, edhe pse ka mbushur moshën madhore, i është zgjatur kujdesi prindëror për shkak të sëmundjes psikike të diagnostikuar, apo në situatën kur fëmija nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, për të cilin prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme, derisa fëmija të mbush moshën 26 vjeç.⁸⁶ LFK-ja në nenin 329 e detyron Organin e Kujdestarisë që të inkurajojë fëmijët dhe prindërit që të lidhin marrëveshje jashtëgjyqësore.

Në procedurat për kujdestarinë gjykata *ex officio* mund të caktojë masa të përkohshme për mbrojtjen, edukimin dhe vendosjen e fëmijës. Këto masa të përkohshme mund të zbatohen pavarësisht nga vendimi i marrë në kontestin themelor, ose natyra e procesit themelor, nëse kjo konsiderohet e domosdoshme. Në fund, kundërshtimi i paraqitur ndaj vendimit mbi masat e përkohshme nuk e ndal ekzekutimin e vendimit.⁸⁷ Nga kjo rezulton se gjykata cakton *ex officio* kujdes të veçantë për përkujdesje ndaj fëmijës duke përfshirë

⁸⁴ Neni 327, paragrafi 2 të LFK-së

⁸⁵ Po aty, Neni 327, paragrafi 4

⁸⁶ Po aty, Neni 290, paragrafi 2

⁸⁷ Po aty, Neni 344

edukimin dhe vendosjen e tij, mirëpo për të caktuar një përkujdesje të tillë *ex officio*, duhet paraprakisht të jetë zhvilluar ndonjë procedurë gjyqësore, ose të jetë në zhvillim e sipër, lidhur me përkujdesjen ndaj fëmijës. Andaj, derisa të gjendet kujdestari i përshtatshëm, me qëllim plotësimin e nevojave të veçanta, gjykata me vendim të veçantë, por të karakterit të përkohshëm, mund ta caktojë kujdestarin, përfshirë këtu edhe kujdes të veçantë për fëmijën. Gjithashtu, edhe në kontestet martesore, gjatë martesës, por edhe pas përfundimit të saj mund të zhvillohen konteste gjyqësore të lidhura me përkujdesjen, respektivisht mbajtjen dhe kontaktet me fëmijët. Në këto rrethana, derisa vendimi se cilit prind do t'i takojë përgjegjësia për përkujdesje ndaj fëmijës të jetë përfundimtar, gjykata cakton një kujdestar të veçantë, ose kujdes të veçantë, i cili mund të bëhet nga secili prej prindërve. Në këto raste gjykata e zhvillon procedurën sipas dispozitave ligjore të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Shembull: Gjykata e Shkallës së Parë, me aktvendimin C. nr. 224/2010 të datës 18.03.2011, e aprovoi propozimin e të paditurës dhe caktoi masën e përkohshme duke e detyruar paditësin, që në emër të ushqimit për dy fëmijët e mitur, të paguajë shumën prej 200 euro për çdo muaj deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Shembull: Gjykata e Shkallës së Parë, me aktvendimin C. nr. 57/13 të datës 30.01.2013, aprovoi propozimin e paditëses dhe caktoi masën e përkohshme si dhe caktoi kontaktin në mes të paditëses (nënës) dhe vajzës së mitur, një herë në javë, çdo të premte, duke filluar nga ora 15 e deri në ora 16 ditën e diel.

Sipas KFSH-së, gjykata, me kërkesën e palës, mund të marrë masa të përkohshme të cilat janë me interes për fëmijët dhe bashkëshortin në nevojë si: detyrimi për ushqim, edukimi dhe arsimimi i fëmijëve të mitur, sigurimi i banimit, si edhe administrimi e përdorimi i pasurisë së dhënë gjatë martesës, nëse plotësohen kushtet. Vendimi mbi masën e përkohshme i dhënë nga gjykata ka karakter të përkohshëm, sepse ai është në fuqi, derisa të jepet vendimi përfundimtar. Në rastet kur ndryshojnë rrethanat, gjykata, nëse e vlerëson, mund ta ndryshojë apo ta shfuqizojë atë vendim, në rast se konstaton se ai është bazuar në të dhënat jo të sakta.

3.7.3 Shqyrtimi kryesor

Pas dështimit të seancës së tentim pajtimit, gjykata cakton shqyrtimin kryesor. Në këtë fazë palët ndërgjyqësore qoftë personalisht, apo përmes të autorizuarve të tyre, prezantojnë provat. Edhe në këtë fazë roli i gjykatës është aktiv. Ajo mund ta aprovojë

apo refuzojë kërkesën e palës për zgjidhjen e martesës. Bashkëshorti paditës pretendon dhe provon përpara gjykatës se jetesa e përbashkët është bërë e pamundur dhe martesa e ka humbur qëllimin e saj për të, ose edhe për partnerin tjetër. Pra, në këtë rast, zgjidhja e martesës vjen si rezultat i cenimit të kushteve objektive dhe subjektive të cilat i japin jetë institutit të martesës.⁸⁸ Bashkëshorti paditës në këtë rast duhet të provojë përpara gjykatës se është plotësuar njëri, apo disa nga shkaqet që shpjen deri te shkurorëzimi si p.sh.: jeta e padurueshme në mes tyre, grindjet e vazhdueshme, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, sëmundja psikike e pashërueshme, kryerja e veprës penale ndaj bashkëshortit, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, keqtrajtimi serioz, ushtrimi i dhunës. Nga të gjitha shkaqet e përmendura më sipër, vetëm njëri paraqitet, pavarësisht vullnetit të bashkëshortëve: rasti i sëmundjes psikike të pashërueshme.

LFK-ja ka parashikuar se “gjykata mund t’i konsiderojë si të kontestueshme faktet në të cilat pala e mbështet kërkesën e vet në kontestet martesore, edhe atëherë kur ato fakte janë të pakontestueshme ndërmjet palëve.”⁸⁹

Gjatë shqyrtimit kryesor gjykata, me rastin e marrjes së vendimit meritator, në rend të parë duhet të ketë parasysh interesat më të mira të fëmijëve të mitur, e jo të bashkëshortëve. Gjykata nuk është e lidhur me propozimin e palëve sa i përket çështjes së prezantimit të provave, sepse ajo, sipas detyrës zyrtare mund të urdhërojë marrjen e provave me qëllim vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sidomos kur kemi të bëjmë me përkujdesjen, ushqimin dhe rregullimin e të drejtës së kontaktit të fëmijëve me prindërit. Në rastet kur procedura e shkurorëzimit ka filluar sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve, gjykata nuk heton dhe shqyrton arsyet e paraqitura në propozim, përveçse kur konstaton se martesa duhet të ruhet për shkak të interesave primare të fëmijëve të mitur. Jo vetëm legjislacioni vendor, por edhe Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) përfshin dispozita që kanë të bëjnë me gjykimin e çështjeve familjare. Neni 3 i Konventës parasheh se: në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të marra nga institucionet private apo publike të mirëqenies shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesat më të mirë të fëmijës do të jenë konsideratë primare.⁹⁰

⁸⁸ Mandro, Arta, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009, f. 315

⁸⁹ Neni 85 të LFK-së

⁹⁰ Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 3.1

3.7.3.1 Përrjashtimi i publikut

Parimisht puna e gjykatave është publike dhe pjesëmarrja e publikut është e lejuar.⁹¹

Përrjashtimisht në konteste martesore publiku përrjashtohet në këtë procedurë.

Në nenin 75 të LFK-së është parashikuar që: “*Publiku përrjashtohet në procedurat e kontestit martesor*”. Qëllimi i këtij përrjashtimi është ruajtja e fshehtësisë së marrëdhënieve martesore në mes bashkëshortëve, sepse në këto konteste shqyrtohen dhe zbulohen fakte që prekin të drejtat personale të pjesëmarrësve në procedurë e që lidhën ngushtë me privatësinë e tyre, e cila është e garantuar me ligj. Përveç kësaj, edhe LPK ka lejuar përrjashtimin e publikut në raste të caktuara.⁹²

Ruajtja e privatësisë është një e drejtë e garantuar edhe me akte ndërkombëtare.⁹³ Mirëpo kuptimi i kësaj dispozite është zgjeruar⁹⁴ në mënyrë të tillë që në procedurën e kontesteve martesore mund të përfshihen edhe ekspertët, prokurori dhe Organi i Kujdestarisë, kur paraqitet nevoja, pra, në rastet e parapara me ligj.

3.7.3.2 Caktimi i përfaqësuesit të përrkohshëm

Në praktikë paraqiten rastet ku të paditurit nuk i dihet adresa, apo gjendet në vendbanim të panjohur dhe me këtë pamundësohet që palës së paditur t’i dorëzohet ftesa në mënyrë të rregullt. Dështimi për t’ia dorëzuar ftesën palës së paditur mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për njërën apo të dy palët. Në këto raste, gjykata, në bazë të propozimit të palës paditëse do të caktojë përfaqësuesin e përrkohshëm me qëllim mbrojtjen e interesave të të paditurit. Kushti për t’u caktuar përfaqësuesi i përrkohshëm është kur të paditurit nuk i dihet vendqëndrimi, apo është i panjohur si dhe në rastet kur i padituri gjendet jashtë vendit. Propozimin për caktimin e përfaqësuesit të përrkohshëm paditësi e bën me qëllim që mos të zgjatet procedura dhe të paraqiten pasoja për palët.

Përfaqësuesi i përrkohshëm i caktuar me vendim të gjykatës i ka të gjitha të drejtat e përfaqësuesit ligjor, i cili është i detyruar që në këtë kontest të kryejë të gjitha veprimet në interes të paditurit, derisa të paraqitet i padituri ose i autorizuari i tij, apo derisa të caktohet kujdestari për të paditurin nga ana e organit të kujdestarisë.

⁹¹ Neni 7, paragrafi 4, LGJ.

⁹² Neni 4, paragrafi 3 i LPK-së, gjykata e shqyrton çështjen në seancë jopublike vetëm më rastet e përcaktuara me ligj.

⁹³ Neni 8, paragrafi 1 i KEMDNJ-së

⁹⁴ Komentar mbi Ligjin Për Familjen, i autorëve Haxhi Gashi/ Avdullah Aliu\Adem Vokshi, f. 206

3.7.4 Marrja e aktgjykimit

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, marrja e aktgjykimit është faza përfundimtare lidhur me shkurorëzimin. Pa marrë parasysh faktin nëse është iniciuar në gjykatë procedura për propozimin e zgjidhjen së martesës me marrëveshje apo me padi, gjykata, me aktgjykim mund të aprovojë kërkesën, apo ta refuzojë atë.

Në momentin kur aktgjykimi merr formën e prerë, konsiderohet se martesa është zgjidhur. Sipas detyrës zyrtare, gjykata ka të drejtë të vendosë për shumë çështje lidhur me mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve; se cilit prind i besohen fëmijët e përbashkët, për ruajtje, kujdes; për detyrimin e pagimit të ushqimit si dhe për kontaktin e fëmijës me prindërit. Si çdo aktgjykim, edhe aktgjykimi lidhur me zgjidhjen e martesës me shkurorëzim duhet të përmbajë: hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin për mjete juridike. Kundër aktgjykimit të shkallës së parë mund të ushtrohet ankesë si mjet i rregullt juridik nga ana e palës së pakënaqur në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Lidhur me ankesën vendos gjykata e shkallës më të lartë. Sa i përket aktgjykimit, kur kemi të bëjmë me propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, ankesa është paksa më e kufizuar, sepse aktgjykimi mund të goditet vetëm sa i përket shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ose për shkak se aktgjykimi është marrë pasi ndonjëri nga propozuesit ka dhënë propozimin nën rrethanën e çmendurisë, ose ka qenë nën ndikimin e dhunës, kanosjes apo mashtrimit.

Pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë, pala e pakënaqur nuk mund t'i shfrytëzojë mjetet e jashtëzakonshme juridike. Sipas nenit 88 të Ligjit për Familjen të Kosovës, mjetet e jashtëzakonshme juridike nuk lejohen nëse martesa është zgjidhur, ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë.⁹⁵ Aktgjykimi i dërgohet gjendjes civile pas plotfuqishmërisë së tij, me qëllim që të bëhen ndryshimet në librat amëz të të martuarve.

3.8 Mënyra e vendosjes në procedurën e shkurorëzimit dhe mjetet e goditjes

Me aktgjykim gjykata vendos për zgjidhjen e martesës, si në rastet kur është fjala për zgjidhje të martesës me shkurorëzim, ashtu edhe për zgjidhjet e martesës me anulim, apo me propozim të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje. Aktgjykimet me të cilat anulohet martesa, apo vendoset shkurorëzimi, janë të natyrës

⁹⁵ Mjetet e jashtëzakonshme lejohen për pjesën e aktgjykimit kur vendoset për besimin, ushqiminë edhe kontaktin e fëmijëve.

konstitutive dhe prodhojnë efekt në të ardhmen. Këtë efekt ai e prodhon nga momenti kur bëhet i formës së prerë.

Në kontestet martesore, nuk mund të nxirret aktgjykim për shkak të mungesës, ose në bazë të pranimit.⁹⁶ Në këto konteste, edhe kur pala mungon në seancë, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt, apo nuk jep përgjigje me shkrim, gjykata vazhdon me procedurë, duke i shqyrtuar të gjitha faktet relevante të nevojshme për nxjerrjen e vendimit. Në të njëjtën mënyrë vepron gjykata edhe nëse kemi pohim të ndonjë fakti. Gjykata vazhdon me vërtetimin e fakteve dhe provave pavarësisht pohimit të palës dhe nuk mund të dalë me ndonjë vendim vetëm duke u bazuar në pohimin e palës, pa i vërtetuar saktësitë e fakteve. Në dispozitiv të aktgjykimit për zgjidhjen e martesës gjykata vendos për të gjitha kërkesat e parashtruara në padi dhe për çështjet që duhet vendosë sipas detyrës zyrtare, si p.sh.: zgjidhja e martesës; besimi i fëmijëve në përkujdesje, mbajtje dhe edukim; kontaktet personale të fëmijëve me prindin të cilit nuk i janë besuar në përkujdesje; ushqimin e fëmijëve dhe për shpenzimet e procedurës.

Mjetet e goditjes së aktgjykimit në këto konteste janë dy llojesh:

- a) Mjetet e zakonshme të goditjes dhe
- b) Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes.

Me të parat goditen aktgjykimet që nuk kanë marrë formën e prerë, kurse me të dytat gjykimet që kanë marrë formën e prerë.⁹⁷

a) Mjetet e zakonshme të goditjes - Ankesa është mjeti rregullt i goditjes me të cilin pala e pakënaqur, në afat prej 15 ditësh nga marrja së kopjes së aktgjykimit të shkallës së parë, mund ta kundërshtoj atë. Lidhur me ankesën vendos gjykata e shkallës së dytë, e në rastin tone i bie të vendosë Gjykata e Apelit.⁹⁸

Sipas nenit 87 të LFK, aktgjykimi me të cilin është zgjidhur martesa sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje të përbashkët mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ose për arsye se propozimi është dhënë në lajthim, ose nën ndikimin e shtrëngimit, ose të mashtrimit. Shkaqet për ankesë kundër këtij aktgjykimi përputhen me ato për ankesë kundër aktgjykimit në bazë të pohimit ose tërheqjes së kërkesës.

⁹⁶ Nenin 85, paragrafi 2 i LFK-së

⁹⁷ Dr. Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, Prishtinë 1986, f. 420.

⁹⁸ Neni 176 i LPK-së, lidhur me Nenin 17 të LGJ.

Kundër aktgjykimit me të cilin refuzohet padia për shkurorëzim, apo për anulim të martesës, ankesa lejohet për të gjitha shkaqet e parapara me LPK.

b) Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes

Me dispozitën e nenit 88 të LFK-së nuk lejohet paraqitja e mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër aktgjykimit të formës së prerë, me të cilin është zgjidhur apo anuluar martesa. Kjo ka arsyetimin e vet sepse që nga momenti i plotfuqishmërisë së aktgjykimit dy ish-bashkëshortët mund të lidhin martesë të re dhe plotfuqishmëria e saj as që mund të vie në dyshim.⁹⁹ Mirëpo, kundër aktgjykimit me të cilin është refuzuar padia janë të lejuara mjetet e tilla të goditjes.¹⁰⁰

Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes nuk janë të lejuara vetëm sa i përket pjesës së aktgjykimit me të cilin është zgjidhur martesa, ndërsa në pjesë të tjera, kur është vendosur për mbajtjen dhe kujdesin për fëmijë, mbajtjen e bashkëshortit të pasiguruar etj, këto mjete janë të lejuara.

Mjetet e jashtëzakonshme juridike janë: revizioni dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. Mjetet e jashtëzakonshme nuk kanë karakter shtyrjeje dhe paraqiten kundër aktgjykimit të formës së prerë. Me këto mjete nuk mund të goditet pjesa e aktgjykimit të plotfuqishëm e cila ka të bëjë me zgjidhjen e martesës, por goditen vetëm pjesët e aktgjykimit që kanë të bëjnë me ushqyerjen dhe besimin e fëmijëve apo të bashkëshortëve; më pas, pjesa për kontaktet personale të prindit, të cilit nuk i është besuar fëmija në përkujdesje, arsimim dhe mbajtje; pjesa mbi shpenzimet gjyqësore si dhe pjesa e aktgjykimit për besimin e fëmijës.

3.9 Rastet nga praktika gjyqësore në Kosovë

Përveç aspekteve juridike teorike, gjatë punimit të kësaj teme janë marrë dhe analizuar pesëmbëdhjetë raste nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke paraqitur disa nga veçoritë personale të paditësve siç janë: rastet e inicimit të procedurës nga burri apo gruaja, inicimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, caktimi i kujdestarisë së fëmijëve babait apo nënës, mosha e bashkëshortëve, gjinia e fëmijëve .

⁹⁹ Hamdi Podvorica, vepra e cituar, faqe 135

¹⁰⁰ Dr. Faik Brestovci, E Drejta e Procedurës Civile, Prishtinë 2002, f. 286

Tabela 1. Inicimi procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, mosha e bashkëshortëve, kujdestaria ndaj fëmijëve.

Paditës		Propozim i përbashkët	Me padi	Kujdestaria ndaj fëmijëve		Mosha e bashkëshortëve		Gjinia e fëmijëve	
Burri	Gruaja			Babait	Nënës	Maksimale	Minimale	M	F
9 raste	2 raste	4 raste	11 raste	4 raste	8 raste	48 vjet	28 vjet	10 raste	9 raste

Nga studimi i 15 lëndëve të studiuara dhe analizuara, karakteristikë është se në këto raste, 11 prej tyre kanë filluar me paraqitjen e padisë, ndërsa me propozim të përbashkët kanë filluar vetëm 4 raste. Në 11 rastet e filluara me padi si palë paditëse, burri është paraqitur në 9 raste, ndërsa gruaja në 2 raste. Te rastet e ushtrimit të padisë për shkurorëzim gruaja (nëna) deri në momentin e fundit nuk paraqitet, pikërisht kur janë në pyetje fëmijët; pasi gruaja emocionalisht është më e lidhur me fëmijët dhe dëshiron ta ruajë martesën duke sakrifikuar veten. Nga tabela shihet se sa i përket besimit të fëmijëve, në 12 rastet e analizuara në 4 raste fëmijët i janë besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim babait, ndërsa në 8 raste nënës. Vetëm në 2 raste kontakti i fëmijëve me prindin i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore është caktuar të bëhet me ndërmjetësimin e Qendrës për Punë Sociale, për shkak të acarimit të raporteve në mes të ish bashkëshortëve. Mosha e bashkëshortëve të shkurorëzuar, minimumi ka qenë 28 vjeç, ndërsa ajo maksimale, prej 48 vjeç.

3.10 Rastet nga praktika gjyqësore në Shqipëri

Përveçse në Kosovë, gjatë punimit të kësaj teme janë marrë dhe analizuar tetëmbëdhjetë raste nga Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, duke paraqitur, edhe në këto raste disa nga veçoritë personale të paditësve si: rastet e inicimit të procedurës nga burri apo gruaja, inicimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, caktimi i kujdestarisë ndaj fëmijëve babait apo nënës, mosha e bashkëshortëve, gjinia e fëmijëve.

Tabela 2. Inicimi procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, mosha e bashkëshortëve, kujdestaria ndaj fëmijëve.

Paditës		Propozim i përbashkët	Me padi	Kujdestaria ndaj fëmijëve		Mosha e bashkëshortëve		Gjinia e fëmijëve	
Burri	Gruaja			Babait	Nënës	Max	Min	M	F
9 raste	5 raste	4 raste	14 raste	1 raste	9 raste	58 vjet	23 vjet	10 raste	4 raste

Nga studimi i 18 rasteve që janë analizuar dhe studiuar, karakteristike është se në këto raste, 14 prej tyre kanë filluar me paraqitjen e padisë, ndërsa me propozim të përbashkët kanë filluar vetëm 4 raste. Në 14 rastet e filluara me padi, si palë paditëse burri është paraqitur në 9 raste, ndërsa gruaja, në 5 raste. Fakti se si palë paditëse në të shumtën e rasteve paraqitet burri, na jep të kuptojmë se gruaja (nëna) deri në momentin e fundit nuk paraqet padi sikurse në rastet praktike në Kosovë, pikërisht kur janë në pyetje fëmijët, pasi ato, emocionalisht, janë të lidhura më tepër me fëmijët dhe dëshirojnë ta ruajnë martesën duke sakrifikuar veten. Nga tabela shihet se sa i përket besimit të fëmijëve, nga 18 rastet e analizuara, në 1 rast fëmijët i janë besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim babait; ndërsa në 9 raste nënës. Mosha e bashkëshortëve të shkurorëzuar, minimumi ka qenë 23 vjeç, ndërsa ajo maksimale ka qenë prej 58 vjeç. Nga këto 18 raste të analizuara, në 10 raste bashkëshortët kanë pasur fëmijë të përbashkët, ndërsa në 8 raste nuk kanë pasur. Në 10 raste gruaja ka kërkuar që t'i kthehet mbiemri i vajzërisë.

3.11 Shqyrtim i të dhënave statistikore lidhur me numrin e shkurorëzimeve, lëndëve të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura rreth zgjidhjes së martesës në Republikën e Kosovës

Në grafikët e poshtëshënuar janë analizuar të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me zgjidhjet e martesës prej vitit 2012-2016, për Kosovë, sipas veçorive kryesore si: numri i lëndëve sipas viteve, mënyrat e zgjedhjes. Burimet e shfrytëzuara janë marrë nga zyra e statistikave e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të dhënat statistikore janë grumbulluar nga të gjitha Gjykatat Themelore të Kosovës.

Lidhur me çështjet e zgjidhjes së martesës dhe çështje të tjera familjare, deri në fund të muajit Dhjetor të vitit 2012, kanë vendosur ish gjykatat e Qarkut që kanë qenë gjithsej pesë. Me ligjin e ri për gjykatat, i cili është i zbatueshëm nga muaji Janar i vitit 2013, kompetentë për të vendosur lidhur me çështjet familjare janë Gjykatat Themelore, kur

gjithsej janë 7 gjykata themelore dhe 20 degë po të këtyre gjykatave, pra, sipas territorit kadastral, që e mbulon gjykata – dega, dhe gjykohen vetëm në shkallën e parë.

Ndërsa si shkallë e dytë është vetëm Gjykata e Apelit me seli në Prishtinë.

3.12 Pasojat e zgjidhjes së martesës

Zgjidhja e martesës i jep fund marrëdhënies juridike që ka lindur ndërmjet bashkëshortëve si rezultat i lidhjes së martesës.¹⁰¹ Pasojat kanë si rezultat shuarjen, ndryshimin apo krijimin e disa të drejtave dhe detyrimeve në mes të ish-bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre. Në bazë të kriterit të objektit të pasojave, që rrjedhin pas zgjidhjes së martesës, si në rastin e marrëdhënieve ndërmjet ish-bashkëshortëve ashtu edhe të marrëdhënieve prindërore, dallojmë pasojat personale jopasurore dhe pasojat pasurore.¹⁰²

Pasojat, të cilat kanë të bëjnë me bashkëshortët, janë lidhura me: mbiemrin, trashëgiminë, dhuratat, pasurinë e përbashkët, ushqimin e bashkëshortit dhe kompensimin e dëmit.

Ndërsa pasojat, që kanë të bëjnë me fëmijët, janë lidhura me besimin, mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur, si edhe të fëmijëve të rritur, të cilëve iu vazhdon e drejta prindërore. Në rastet kur bashkëshortët nuk kanë marrëveshje lidhur me besimin apo nëse marrëveshja nuk është në interes të fëmijëve, gjykata vendos me aktgjykim edhe për besimin, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve të mitur.

Gjykata, me rastin e vendosjes lidhur me ndarjen, vendos me vendim edhe të drejtën për të marrë nga bashkëshorti fajtor aq sa është e nevojshme për mbajtjen e tij, nëse ky nuk posedon të ardhura të nevojshme. Sasia e këtij detyrimi përcaktohet duke marrë parasysh mundësitë dhe të ardhurat e bashkëshortit detyrues. Detyrimin e ushqimit mbetet për ta përmbushur bashkëshorti detyrues sipas vendimit të gjykatës. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit, me kërkesën e bashkëshortit tjetër, gjykata mund të vendosë sekuestron mbi një pjesë të sendeve të bashkëshortit të detyruar dhe të urdhërojë personat e tretë, që janë të detyruar të paguajnë edhe në mënyrë periodike shuma parash ndaj të detyruarit, që një pjesë e këtyre shumave t’iu paguhet direkt atyre që kanë të drejta.

Mbiemri i gruas

Gjykata mund të vendosë me vendim që t’i ndalojë gruas përdorimin e mbiemrit të burrit, nëse ky përdorim i shkakton atij dëm. Ajo, po ashtu, mund ta autorizojë edhe gruan të

¹⁰¹ Omari, Sonila, E Drejta Familjare, Tiranë 2012, f. 225

¹⁰² Po aty, f. 225

mos e përdorë atë mbiemër, nëse përdorimi i atij mbiemri i shkakton asaj dëm të rëndë. Kjo është e paraparë sipas dispozitave ligjore të KFSH-së. Ndërsa sa i përket mbiemrit LFK-ja parasheh zgjidhje tjera. Kjo do të thotë se realizimi i kësaj të drejte varet posaqërisht nga vullneti i bashkëshortëve nëse dëshirojnë ta rimarrin apo jo mbiemrin që kishin para lidhjes së martesës.¹⁰³

Pushimi efektiv i ndarjes

Bashkëshortët me marrëveshje të përbashkët, mund të vendosin që të pushojnë efektet e vendimit gjyqësor të ndarjes, pa qenë nevoja e ndërhyrjes së gjykatës, me një deklaram të shprehur apo me një sjellje kuptimplote.

Ndarja me pëlqimin e palëve

Ndarja vetëm me pëlqimin e palëve nuk ka efekt pa vendimin e gjykatës, që bën miratimin e këtij pëlqimi. Në rast se marrëveshja, që ka të bëjë me rritjen, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve, është në kundërshtim me interesat e tyre, atëherë gjyqtari thërret përsëri bashkëshortët dhe iu bën me dije ndryshimet, që duhen bërë në interes të fëmijëve dhe në rast të një zgjidhje të papranueshme, ai mund të refuzojë miratimin e marrëveshjes.

Sipas KFSH-së, me rastin e zgjidhjes së martesës paraqiten pasojat, të cilat kanë të bëjnë me ish-bashkëshortët si dhe pasojat, që kanë të bëjnë me fëmijët. Pasojat, që kanë të bëjnë me bashkëshortët janë ato të karakterit personal dhe pasuror, të cilat lidhen me: të drejtën për lidhjen e martesës së re, përdorimin e mbiemrit, kompensimin, si edhe të drejtën e përdorimit të banesës. Për sa iu përket fëmijëve, pasojat kanë të bëjnë me ushtrimin e të drejtave prindërore, si e drejta e besimit të fëmijëve, e vizitës, si edhe e detyrimit për pagesën e ushqimit.

3.12.1 Regjimi pasuror i bashkëshortëve

Tërësia e normave juridike, me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor, quhet regjim pasuror martesor.¹⁰⁴ Në të drejtën krahasuese ekzistojnë disa regjime pasurore:

- a) regjimi i pasurisë së veçantë

¹⁰³ Neni 96, par.1 i LFK-së

¹⁰⁴ Hamdi Podvorica, vepra e cituar, faqe 239

- b) regjimi i pasurisë së përbashkët
- c) regjimi i përzier.

Me regjimin e pasurisë së veçantë duhet të kuptojmë ato norma juridike, të cilat çështjen e pasurisë e rregullojnë të veçuar nga martesë. Në këtë rast, titullari i të drejtës së pasurisë së veçantë posedon dhe qeveris pronësinë e tij në mënyrë krejtësisht të pavarur nga bashkëshorti. Pasurinë e veçantë titullari i saj nuk e ka fituar me punë gjatë jetës bashkëshortore.

Ndryshe është situata, kur është fjala për pronësinë e përbashkët. Në këtë rast, bashkëshortët janë titullarë të përbashkët të së drejtës së pronësisë së përbashkët. Kjo pasuri fitohet me punë të përbashkët gjatë martesës.

Regjimi i përzier përfshin elemente të regjimit të pasurisë së veçantë, por edhe të pasurisë së përbashkët. Por jo vetëm kaq. Në bazë të legjislacionit të disa vendeve, bashkëshortët me kontratë mund të zgjedhin njërin prej regjimeve pasurore martesore dhe nëse këtë çështje nuk e rregullojnë me kontratë, atëherë aplikohet regjimi ligjor. LFK-ja legjitimon dy regjime pasurore: regjimin ligjor dhe atë kontraktues. Në LFK, marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve rregullohen me nenet 45-57.

a) Pasuria e veçantë

Pasuria, e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës, do të mbetet pasuri e veçantë e tij. E këtij lloji është edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës, përmes trashëgimisë, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pasurisë. Secili bashkëshort e administron dhe e posedon në mënyrë të pavarur pasurinë e vet të veçantë gjatë gjithë kohës së martesës.¹⁰⁵

b) Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe nga të ardhurat, që rrjedhin nga një pasuri e tillë.¹⁰⁶ Ekzistenca e kësaj lloji pasurie lidhet me plotësimin në mënyrë kumulative të dy kushteve:

- 1) ekzistenca e martesës
- 2) puna e bashkëshortëve të martuar.

¹⁰⁵ Neni 46 i LFK-së

¹⁰⁶ Po aty, Neni 47

Bashkëshortët, gjatë martesës, pasurinë e përbashkët bashkëshortore e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht me marrëveshje.


Të drejtat e bashkëshortëve për sendet e paluajtshme, të cilat janë pasuri e tyre e përbashkët, regjistrohen në regjistrin publik të pasurive të patundshme në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara. Kur në regjistrin e të drejtave të pasurive të patundshme, si bartës i të drejtës pronësore të pasurisë së përbashkët regjistrohet vetëm njëri prej bashkëshortëve, atëherë konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve. Në rastet kur të dy bashkëshortët janë të regjistruar në Regjistrin Publik të Pronave të Patundshme si pronarë të përbashkët në pjesë të caktuara, atëherë konsiderohet se ata e kanë bërë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët në atë mënyrë.

Llojet e kontesteve	Lëndë të pazgjidhura në fillim	Lëndë të pranuar	Gjithsej lëndë në punë	NUMRI I LËNDËVE TË ZGJIDHURA SIPAS MËNYRËS TË ZGJIDHJES										Gjithsej (kol. 4 + kol. 5 + kol. 6 + kol. 7 + kol. 8 + kol. 9 + kol. 10 + kol. 11 + kol. 12)	Lëndë të pazgjidhura në fund
				ME AKTGJYKIM GJYKUES				Me marrëveshje Gjyqësore	Me hudhje poshtë të padisë	Me tërheqjen e padisë	Ndërpitjet procedura	Është zgjidhur në mënyrë tjetër			
				Në bazë të pranimit	Në bazë të mungesës	Në bazë të shqyrtimit kryesor									
						Aprovohet kërkesë padia	Refuzohet kërkesë padia								
A	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	
Shkurorëzimet 2012	527	1634	2161	0	0	571	0	904	0	150	0	55	1680	481	
Shkurorëzimet 2013	481	364	845	3	0	444	4	54	9	78	1	52	645	200	
Shkurorëzimet 2014	200	2387	2587	6	1	1450	21	57	45	222	19	33	1854	733	
Shkurorëzimet 2015	733	2064	2797	5	0	1570	28	91	21	273	5	40	2033	764	
Shkurorëzimet 2016	764	1978	2742	3	1	1449	10	63	25	288	10	52	1901	841	

Grafiku 1. Shkurorëzimet sipas viteve, lëndët e pazgjidhura, të pranuar si dhe mënyra e vendosjes për vitet 2012-2016

Nga ky grafik rrjedh se në Kosovë:

1. Numri i lëndëve të shkurorëzimit në fillim të vitit 2012 ka qenë më i lartë, pastaj vjen zbritja e numrit të lëndëve dhe, në vitin 2016, kemi një ngritje të madhe të numrit të lëndëve të shkurorëzimit.
2. Numri më i madh i lëndëve është iniciuar me padi dhe në vitin 2012, gjithsej në punë kanë qenë 2161 lëndë, ndërsa në vitin 2016, ky numër është rritur dhe ka arritur shifrën prej 2742 lëndë.
3. Nga ky numër, në vitin 2012 janë aprovuar kërkesë padit për zgjidhjen e martesës në 571 raste, ndërsa në vitin 2016, në 1949 raste. Me marrëveshje gjyqësore, në vitin 2012 janë zgjidhur 904 raste, ndërsa në vitin 2016, janë zgjidhur 63 raste. Tërheqja e padisë është bërë në 150 lëndë në vitin 2012, ndërsa në vitin 2016 në 288 lëndë. Lëndë të pazgjidhura në vitin 2012 kanë mbetur 471, ndërsa në vitin 2016 të pazgjidhura kanë mbetur 841.



Grafiku 2. Lëndët e bartura – të trashëguara nga periudha paraprake të viteve 2012-2016


Sa i përket lëndëve të bartura shihet se:

Numri i lëndëve të bartura viteve të fundit është rritur nga numri prej 527 sa ka qenë në vitin 2012, në numrin prej 764 në vitin 2016.

Grafiku 3. Lëndët e pranuar sipas viteve 2012-2016



Nga grafiku i sipërm rrjedh se numri i lëndëve të pranuar nëpër Gjykata ka qenë në rritje e sipër nga numri prej 1634 lëndë sa ka qenë në vitin 2012, është rritur në numrin prej 1978 në vitin 2016.



Grafiku 4. Lëndët e zgjidhura sipas viteve 2012-2016

Nga të dhënat shihet se në vitin 2012 janë zgjidhur 1680 raste, nga numri i përgjithshëm në punë që kanë pasur gjykatat prej 2161 lëndëve. Ndërsa në vitin 2016, janë zgjidhur 1901 raste, nga numri i përgjithshëm në punë, që kanë pasur gjykatat prej 2742 lëndëve.



Grafiku 5. Mënyra e lendeve të zgjidhura – në rastet kur nuk është kontestuar padia

Nga të dhënat statistikore rrjedh se në vitin 2012 nuk ka asnjë rast, në të cilin nuk është kontestuar padia. Ndërsa në vitin 2016, në 3 raste nuk është kontestuar padia.




Grafiku 6. Rastet e zgjidhura në mungesën e të paditurit

Nga të dhënat tjera rrjedh se në vitin 2012, nuk është asnjë rast, në të cilin ka munguar pala e paditur. Ndërsa në vitin 2016, kemi vetëm 1 rast në të cilin ka munguar pala e paditur.




Grafiku 7. Rastet e zgjidhura në të cilat është aprovuar kërkesëpadia e paditësit

Nga të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2012 në 571 raste është aprovuar kërkesëpadia e paditësit. Ndërsa në vitin 2016, në 1449 raste është aprovuar kërkesëpadia e paditësit.




Grafiku 8. Rastet e zgjidhura në të cilat është refuzuar kërkesëpadia e paditësit

Nga të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2012 nuk kemi asnjë rast, në të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit. Ndërsa në vitin 2016, në 10 raste është refuzuar kërkesëpadia e paditësit.




Grafiku 9. Rastet e zgjidhura me marrëveshje të bashkëshortëve

Nga të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2012, me marrëveshje janë zgjidhur 904 raste. Ndërsa në vitin 2016 janë zgjidhur 63 raste.




Grafiku 10. Rastet e zgjidhura me hedhjen poshtë të padisë

Nga të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2012, nuk ka pasur asnjë rast të hedhjes poshtë të padisë. Ndërsa në vitin 2016 janë zgjidhur 25 raste.



Grafiku 11. Rastet e zgjidhura me tërheqjen e padisë

Nga të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2012, me tërheqjen e padisë janë zgjidhur 150 raste. Ndërsa në vitin 2016 janë zgjidhur 288 raste.



Grafika 12. Rastet e zgjidhura me ndërprerje të procedurës

Nga të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2012, asnjë rast nuk është zgjidhur me ndërprerjen e procedurës. Ndërsa në vitin 2016 janë zgjidhur 10 raste.



Grafiku 13. Rastet e zgjidhura në mënyrë tjetër

Nga të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2012, në mënyrë tjetër, janë zgjidhur 55 raste. Ndërsa në vitin 2016, janë zgjidhur 52 raste.

KAPITULLI IV:

I. PASOJAT JURIDIKE PASUORE TË SHKURORËZIMIT

Aspekti Krahësimor Kosovë - Shqipëri

4.1 Pasojat juridike pasurore në kontestet martesore

Zgjidhja e martesës i jep fund marrëdhënies juridike, që ka lindur ndërmjet bashkëshortëve si rezultat i lidhjes së martesës.¹⁰⁷ Pasojat kanë si rezultat shuarjen, ndryshimin apo krijimin e disa të drejtave dhe detyrimeve në mes të ish-bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre.

Në bazë të kriterit të objektit të pasojave, që rrjedhin pas zgjidhjes së martesës, si në rastin e marrëdhënies ndërmjet ish-bashkëshortëve, ashtu edhe të marrëdhënies prindërore, ne dallojmë pasojat personale jopasurore dhe pasojat pasurore.¹⁰⁸

Bashkëshortët, me rastin e lidhjes së martesës apo të bashkëjetesës, hyjnë në raporte pasurore, që rregullohen me normat juridike të Ligjit për Familjen si dhe me ligje të tjera, si Ligji për Barazinë Gjinore, ku trajtohen edhe raportet pasurore. Pasuria e bashkëshortëve mund të jetë pasuri e veçantë dhe e përbashkët. Ligji i Kosovës për Familjen, parashikon se bashkëshortët në të gjitha raportet personale dhe pasurore janë të barabartë. Por nga statistikat dhe praktikat gjyqësore është konstatuar se bashkëshortet janë ato, të cilat kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët me procedurë gjyqësore. Ky fakt tregon se mes të bashkëshortëve në praktikë nuk ekziston barazia, edhe pse ajo është e garantuar me ligj.

4.2. Llojet e pasurisë së bashkëshortëve

Ligji i Kosovës për Familjen, pasurinë e bashkëshortëve e përcakton si pasuri të veçantë të bashkëshortëve dhe pasuri të përbashkët të bashkëshortëve.¹⁰⁹ Këto dy lloje pasurish ndryshojnë nga njëra tjetra dhe kanë karakteristika të veçanta.

¹⁰⁷ Omari, Sonila, E Drejta Familjare, Tiranë 2012, f. 225

¹⁰⁸ Po aty, f. 225

¹⁰⁹ Neni 45 i Ligjit të Kosovës për Familjen

4.2.1. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve

Pasuria e veçantë (e veçuar, vetjake) është ajo pasuri, të cilën çifti bashkëshortor e ka pasur në momentin e lidhjes së martesës, si edhe pasuria, të cilën e ka fituar gjatë jetës së përbashkët martesore në çfarëdo mënyre të lejuar me ligj, por jo me punë.¹¹⁰

Si pasuri e veçantë e bashkëshortëve është pasuria e fituar në bazë të trashëgimisë, dhurimit apo të ndonjë forme tjetër të fitimit të pasurisë me punë intelektuale, artistike, kompensimi i dëmit jomaterial në procedurë gjyqësore, që i takon bashkëshortit etj. Si pasuri e veçantë konsiderohet edhe pasuria e fituar në lojërat e fatit, nëse bashkëshorti ka përdorur në këtë lojë pasurinë e vet të veçantë. Në pasurinë e veçantë hyjnë edhe të gjitha të drejtat sendore dhe detyrimore, të fituara nga pasuria e veçantë si: frutat, qiraja, kamata nga kursimet. Edhe sendet, që shërbejnë për përdorim personal, si: veshmbathja, stolitë, paraqesin pasuri të veçantë. Si pasuri e veçantë konsiderohet edhe pasuria, të cilën njëri bashkëshort e ka fituar gjatë martesës, kur gjatë kësaj kohe ata kanë jetuar të ndarë nga njëri tjetri, kur mes tyre nuk ka ekzistuar jeta e përbashkët faktike, por kanë jetuar të pavarur nga njëri tjetri dhe me kusht që në këtë pasuri të mos këtë kontribuar bashkëshorti tjetër. Karakteristikë e pasurisë së veçantë të bashkëshortëve është se kjo pasuri administrohet nga secili bashkëshort veç e veç dhe në mënyrë të pavarur, por është përcaktuar gjithashtu që kjo pasuri nuk është fituar me punën e tyre të përbashkët.¹¹¹

4.2.2 Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Pasuria e përbashkët është ajo pasuri, të cilën bashkëshortët e kanë fituar me punë gjatë martesës, që nga momenti i lidhjes së saj e deri te ndërprerja e saj. Instituti i Pronës së Përbashkët është institut qendror i të drejtës së pronësisë dhe rrjedhimisht edhe i të drejtës reale, që nënkupton të drejtën e pronësisë të disa personave mbi një send të pandarë, pjesët e të cilëve nuk janë të caktuara paraprakisht, por mund të përcaktohen. Kështu përcaktohet ajo në Nenin 18 të ish-Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike (LMTHJP). *Ndërkaq, në literaturën juridike, pronësia e përbashkët përkufizohet si vijon: "Pronësia e përbashkët është e drejtë pronësore e më shumë personave mbi një send, sipas pjesëve që nuk janë të caktuara as realisht, as idealisht, por që janë të caktueshme."* Normat, të cilat e rregullojnë këtë në detaje, parashikohen në ligje tjera të së drejtës materiale. Kjo formë e pronës ekziston vetëm në rastet e përcaktuara

¹¹⁰ Podovorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Shtypshkronja 'Trend', Prishtinë, 2011, f. 244.

¹¹¹ Hamdi Podvorica, Vepra e cituar, faqe 245

shprehimisht me ligj dhe ajo rregullohet me ato ligje, e varur nga materia, të cilën e rregullojnë ato. Në rastin e pronës së përbashkët, raste të përcaktuara me ligj, të drejtën e pronësisë mbi një sende kanë shumë persona, ndaj edhe e drejta e pronësisë iu takon të gjithëve atyre së bashku. Pronarët e përbashkët e administrojnë dhe e disponojnë sendin bashkërisht, me vendim unanim, në qoftë se për rastet konkrete nuk është parashikuar ndryshe me ligj. Po ashtu edhe bashkëshortët gjatë martesës bashkërisht dhe me marrëveshje disponojnë, shfrytëzojnë dhe e administrojnë pasurinë e përbashkët.

Pronari i përbashkët nuk e ka pjesën e vet të veçantë. Ai është pronar i gjithë sendit, por i kufizuar nga e drejta e pronësisë së pronarëve të tjerë të përbashkët dhe për këtë arsye ai nuk mund të disponojë asnjë pjesë të pronës së përbashkët pa pëlqimin e pronarëve të tjerë të përbashkët.

Për detyrimet eventuale ndaj sendit të përbashkët pronarët e përbashkët përgjigjen në mënyrë solidare.

Ashtu si te bashkëpronësia, pronari i përbashkët ka të drejtë ta kërkojë ndarjen e pronës së përbashkët, e cila bëhet në të njëjtën mënyrë.

Sipas të drejtës sonë, prona e përbashkët, në bazë të ligjit, ekziston në këto forma:

a. Prona e përbashkët e anëtarëve të familjes,

b. Prona e përbashkët e bashkëshortëve dhe

c. Prona e përbashkët e bashkëtrashëgimtarëve para ndarjes së trashëgimisë. Titullarët e pronës së përbashkët mund t'i disponojnë titujt bashkërisht derisa të zgjasë gjendja e pronësisë së përbashkët. Pjesët nuk janë të caktuara as në pjesë ideale, as në pjesë reale dhe kjo e dallon atë nga bashkëpronësia në të cilën pjesët ideale të bashkëpronarëve dihen.

Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore në Republikën e Kosovës (LPDTS), e përcakton pronësinë e përbashkët si vijon: *“Nëse disa persona kanë të drejtën e pronësisë mbi një send, në atë mënyrë që pjesët e tyre nuk janë të caktuara, por mund të caktohen, atëherë ata janë pronarë të përbashkët.”*¹¹²

Në këtë ligj përcaktohet po ashtu se: *“Pronësia e përbashkët mund të krijohet me ligji ose përmes kontratës. Marrëveshja me të cilën krijohet pronësia e përbashkët mund të lidhet vetëm nëse është lejuar shprehimisht me ligj.”*¹¹³

¹¹² Neni 77, paragrafi 1 të LPDTS.

¹¹³ Po aty, Neni 77, paragrafi 2

Pronarët mund të kërkojnë shitjen e pjesshme të pronësisë së përbashkët, por jo në kohë të papërshtatshme dhe në dëm të tjerëve.

Pronarët e përbashkët, së bashku me pronësinë, kanë edhe përgjegjësinë e përbashkët lidhur me detyrimet për këtë pronësi. Çdo gjë, që nuk është parashikuar me dispozitë ligjore, i nënshtrohet *mutatis mutandis*, dispozitave ligjore lidhur me bashkëpronësinë apo të drejtën e pronës në përgjithësi.¹¹⁴

Pronësia e përbashkët është çdo herë e lidhur me bashkësinë jetësore apo të punës në mes të shumë personave (bashkëshortët, ekonomitë familjare). Një përjashtim i pronësisë së përbashkët, ku nuk nevojitet elementi i bashkësisë, është pronësia e përbashkët e trashëgimtareve mbi sendet e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësit.

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është ajo pasuri, e cila është krijuar me punë nga bashkëshortët gjatë ekzistencës së martesës, si edhe nga të ardhurat që krijohen nga pasuria e përbashkët. Nga ky përkufizim rezulton se për fitimin e kësaj pasurie duhet të plotësohen dy kushte: ekzistenca e martesës dhe puna e bashkëshortëve gjatë ekzistencës së bashkësisë martesore.

Ekzistenca e martesës

Ky është një kusht qenësor për fitimin e pasurisë së përbashkët dhe kjo do të thotë se, për ta fituar këtë pasuri, në bashkësi martesore, duhet që të ekzistojë martesë. Pa ekzistencën e kësaj bashkësie, nuk mund të bëhet fjalë për ekzistencën e pasurisë së përbashkët, për shkak se në këtë rast do të mungonte baza juridike mbi të cilën krijohet pasuria e përbashkët.

Puna e bashkëshortëve gjatë bashkësisë martesore

Puna e bashkëshortëve gjatë martesës është kusht i domosdoshëm për krijimin e pasurisë së përbashkët, gjë që do të thotë se krijimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të bëhet vetëm me punë gjatë ekzistencës së martesës. Puna mund të jetë individuale dhe e përbashkët. Ajo është individuale atëherë kur bashkëshorti e kryen punën në mënyrë të pavarur dhe realizon kështu të ardhura dhe fitime, që e rrisin vlerën e pasurisë së përbashkët. Kurse puna është e përbashkët atëherë kur bashkëshortët, me veprimin e tyre të përbashkët, realizojnë të ardhura me të cilat e rrisin apo e krijojnë

¹¹⁴ Neni 77, paragrafi 5 të LPDTS.

pasurinë në familje.¹¹⁵ Pasuria e përbashkët bashkëshortore karakterizohet nga mos përcaktimi i pjesës së sendit apo kërkesës përkatëse të çdonjërit nga bashkëshortët, çka e dallon nga pjesët ideale ose reale të titullarit të bashkëpronësisë, si edhe nga pjesa e veçantë e pasurisë, që është e përcaktuar. Si rezultat i veçorisë së papërcaktueshmërisë së pjesëve përkatëse të bashkëshortëve vjen edhe pasoja që bashkëshortët nuk mund ta disponojnë atë pasuri në mënyrë individuale, por vetëm së bashku, deri në momentin kur ajo pasuri të pjesëtohet. Bashkëshortët mund ta disponojnë edhe pasurinë e patundshme, të përbashkët, në mënyrë të përbashkët dhe pasuria e përbashkët e bashkëshorteve nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve.¹¹⁶

Dispozitat juridike, të cilat rregullojnë pasurinë e përbashkët të bashkëshorteve, janë detyruese, prandaj veprimet juridike, të kryera në kundërshtim me këto dispozita, janë të pavlefshme.

4.3 Të drejtat e bashkëshortëve mbi pasurinë e patundshme

Të drejtat e bashkëshortëve mbi pasurinë e patundshme parashikohen në Nenin 50 të LFK-së dhe sipas tij, pasuria e përbashkët e tyre regjistrohet në regjistrin publik të pasurive të patundshme në emër të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara.

Në paragrafin 2 të Nenit 50të LFK-së, përcaktohet se kur si bartës i të drejtës pronësore mbi pasurinë e përbashkët, në regjistrin e të drejtave mbi pasurinë e patundshme, regjistrohet vetëm njëri prej bashkëshorteve, atëherë konsiderohet së regjistrimi është bërë në emër të të dy bashkëshortëve. Në praktikë, regjistrimi i pasurisë së përbashkët bëhet pothuajse tërësisht vetëm në emër të bashkëshortit, pra, të burrit dhe në shumë raste të rralla edhe në emër të gruas apo vetëm në emër të gruas.

Siç është përcaktuar me ligjin në fuqi, pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve.

Në rastet kur, në regjistrin publik të pronave të patundshme, të dy bashkëshortët janë regjistruar si pronarë të përbashkët me pjesë të caktuara, atëherë konsiderohet se ata e kanë bërë pjesëtimin e asaj pasurie në atë mënyrë.

¹¹⁵ Hamdi Podvorica, vepra e cituar, f. 243

¹¹⁶ Neni 16.9, Ligji i Kosovës mbi Barazinë Gjinore

4.3.1 Administrimi i pasurisë së përbashkët

Pasurinë e përbashkët bashkëshortore gjatë martesës bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje.¹¹⁷

Bashkëshortët mund të kontraktojnë me qëllim që administrimi i pasurisë së përbashkët në tërësi ose i pjesëve të veçanta të saj të bëhet nga njëri prej bashkëshorteve. Kontraktimi mund të kufizohet vetëm në administrim ose në disponim. Në pasurinë e përbashkët pjesët nuk dihen, por ato mund të caktohen. Meqenëse pasuria e përbashkët është e pandarë, bashkëshortët nuk mund ta disponojnë më vete dhe as të ngarkojnë kryerjen e veprimeve juridike pa një marrëveshje midis tyre. Kur nuk është kontraktuar ndryshe, administrimi përfshin edhe posedimin në kuadër të aktiviteteve të tilla si: përkujdesja ndaj pasurisë, si edhe mirëmbajtja e pasurisë. Por në qoftë se nuk kemi ndonjë kontraktim, atëherë, pasurinë e përbashkët martesore, bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht.

Në rastet kur për administrimin e pasurisë nuk gjendet një gjuhë e përbashkët, atëherë, për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve kompetente është gjykata, e cila nis procedurën jokontestimore, që në dallim nga procedura e pjesëtimit të pasurisë, e cila nis me padi, fillon me paraqitjen e propozimit në procedurën jokontestimore.¹¹⁸

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mbi sendet e patundshme në regjistrat publik të pronave të patundshme, regjistrohet në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët e tyre, në pjesë të papërcaktuara. Në rastet kur si pronar i pasurisë së përbashkët është regjistruar vetëm njëri bashkëshort, atëherë konsiderohet se pasuria është regjistruar në emër të dy bashkëshortëve.

Neni 7 i Ligjit të Kosovës mbi Barazinë Gjinore përcakton se pasuria e krijuar gjatë martesës regjistrohet në regjistrat publikë si pronë e përbashkët, në emër të të dy partnerëve dhe se puna e të dy partnerëve, përmes së cilës krijohet pasuria e përbashkët, konsiderohet si kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët. Në këtë aspekt, edhe Ligji i Kosovës mbi Familjen e njeh faktin se, në rastin e zgjidhjes së martesës, pasuria e përbashkët ndahet në mënyrë të barabartë. Bashkëshortët, krahas pasurisë së përbashkët, kanë edhe pasurinë e ndarë apo të veçantë, e cila është fituar gjatë periudhës së martesës nga njëri bashkëshort, përmes trashëgimisë apo mënyrave të tjera. Ligji Kundër Diskriminimit e ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi

¹¹⁷ Neni 49 i LFK-së

¹¹⁸ Neni 191 i Ligjit i Kosovës për procedurën jokontestimore

baza gjinore, qoftë në pasuri të patundshme edhe në forma të tjera të pasurisë. Një karakteristikë tjetër e këtij ligji është se ky mund të shërbejë edhe si bazë për një ankesë diskriminimi, si edhe për vendosjen e barrës së dëshmisë mbi autoritetet përkatëse. Përveç kësaj, në qoftë se diskriminimi është vërtetuar nga gjykata, atëherë ajo mund të vendosë për gjoba apo masa pozitive. Por pyetja që shtrohet është kjo: a ekziston kjo barazi në praktikë?

Në bazë të analizës dhe studimit të rasteve praktike ne mund të konstatojmë se gratë në familje ose janë përjashtuar nga pronësia, ose kanë hequr dorë nga pjesa e tyre e pasurisë në favor të burrave. Meqenëse ligjet në përgjithësi janë progresive dhe barazia mes gjinive është e garantuar edhe me Kushtetutë, atëherë shtrohet pyetja: cilat janë sfidat për zbatimin e këtyre ligjeve?

Analizat tregojnë se sfidat janë të ndryshme, por ndër më kryesorët janë këto që vijojnë: Gjykatat dhe organet tjera kompetente për mbrojtjen e të drejtave të parapara me ligj përballen me vështirësi të shumta. Gratë, që nga momenti kur parashtrojnë padi në gjykatë për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre pasurore, përballen me vështirësi, të cilat bëhen të dukshme gjatë zhvillimit të procedurave në gjykatë, si për shembull, me shtyrjet e shpeshta të seancave, me stërzgjatjen e tyre me vite të tëra, si edhe me vështirësitë që ndeshin ato në rastin e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Për këto arsye gratë dekurajohen në ngritjen e padive me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre pasurore.

E drejta zakonore – kjo dallon nga ligjet pozitive në fuqi, sepse normat zakonore i vënë gratë në pozitë të pabarabartë. Si pasojë e kësaj, këto norma, edhe pse në një masë të vogël, vazhdojnë të ndikojnë në realizimin e të drejtave pasurore të grave dhe për këtë çështje nuk është bërë ndonjë studim i plotë, i cili merret me identifikimin dhe analizën e tyre. Sipas të dhënave statistikore në Kosovë, shkalla e papunësisë për gratë arrin deri në 56%, ndërsa për burrat deri 41%. Hulumtimet tregojnë se për shkak të përqindjes së vogël të grave të punësuar, edhe numri i atyre, që janë në gjendje të kontribuojnë në buxhetin familjar, është më i vogël se numri i meshkujve. Në këtë mënyrë, burrat kontribuojnë në buxhetin familjar 42.36% më shumë sesa gratë.¹¹⁹

¹¹⁹ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Trajnim mbi të Drejtat Pronësore të Grave, Prishtinë, 2012

4.3.2 Marrëdhëniet pasurore, jashtëmartesore, të bashkëshortëve

Sipas dispozitave të LFK-së, pasuria e fituar përmes punës së përbashkët të burrit dhe të gruas në marrëdhëniet jashtëmartesore konsiderohet si pasuri e përbashkët martesore.¹²⁰

Pasuria e fituar gjatë bashkësisë faktike (bashkësisë jashtëmartesore), që i nënshtrohet ndarjes ose pjesëtimit, konsiderohet pasuri e përbashkët.

Dispozitat e LFK-së, të cilat vlejnë në rastin e pjesëtimit të pasurisë së bashkëshortëve të kurorëzuar, zbatohen në mënyrë analoge edhe për raportet pronësore të personave në bashkësi jashtëmartesore.

4.4 Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet si gjatë jetës së përbashkët martesore, ashtu edhe pas mbarimit të saj.¹²¹ Të drejtën për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë së përbashkët e kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose atij të shpallur të vdekur, si edhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet nga pasuria e pjesëtuar e atij bashkëshorti. Ky pjesëtim mund të bëhet me marrëveshjen e palëve, kurse në rastin e pamundësisë së marrëveshjes, pjesëtimi mund të bëhet edhe përmes gjykatës dhe në këtë rast do të merret parasysh kontributi i secilit bashkëshort, ndihma e ofruar ndaj bashkëshortit tjetër, kujdesi ndaj fëmijëve, administrimi i punëve të shtëpisë, si dhe çfarëdo formë tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Pjesët e bashkëshortëve caktohen në përpjesëtim të njëjtë mbi të gjitha sendet dhe të drejtat mbi pasurinë e përbashkët, ashtu siç kanë qenë në momentin e para zgjidhjes së martesës.

Këtu duhet vënë në dukje se pasuria e fituar përmes punës së përbashkët të burrit dhe të gruas në marrëdhëniet jashtëmartesore, konsiderohet pasuri e tyre e përbashkët dhe dispozitat e LFK-së, që kanë të bëjnë me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në një martesë të regjistruar ligjërisht, zbatohen në mënyrë analoge edhe për marrëdhëniet pasurore të personave në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore).

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve rregullohet me Nenin 52 të LFK-së, ku thuhet se asnjëri nga bashkëshortët nuk mund të privohet nga pasuria e tij në mënyrë arbitrare. Ligji i Kosovës mbi Familjen ka përcaktuar se bashkëshortët, në bashkësi

¹²⁰ Neni 58 i Ligjit për Familjen të Kosovës

¹²¹ Neni 56 i LFK-së.

martesore, janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore. Me këtë parim, Ligji i Kosovës mbi Familjen, i mbron të dy bashkëshortët, pasi të gjitha marrëdhëniet martesore i ndërton mbi parimin e barazisë. Pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, bashkëshortët mund ta bëjnë si gjatë martesës, ashtu edhe pas zgjidhjes së saj, që do të thotë, se ata mund ta pjesëtojnë pasurinë e përbashkët me marrëveshje në çdo kohë. Neni 54 i LFK-së përcakton saktë se si mund të bëhet vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjeve të bashkëshortëve dhe se në rastin e mosmarrëveshjeve mbi pjesëtimin e pasurisë kompetente është gjykata.

Vendimi mbi pjesëtimin e pasurisë së përbashkët duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, në vlerësimin e të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të ardhurat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën që njëri bashkëshort i ka ofruar tjetrit, siç është: kujdesi ndaj fëmijëve, administrimi i punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si edhe çfarëdo formë tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Për këtë arsye, në përcaktimin e pjesës së pasurisë së përbashkët për secilin bashkëshort, gjykata duhet të ketë parasysh detyrimisht kriteret e lartpërmendura. Gjatë pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, fillimisht duhet të eliminohen të gjitha borxhet e përbashkëta, sepse bashkëshortët duhet të përgjigjen për të gjitha detyrimet e tyre, që rrjedhin nga pasuria e përbashkët dhe pastaj të bëhet pjesëtimi i pasurisë së mbetur. Në rastin e shqyrtimit të pasurisë së përbashkët, sendet personale do të veçohen dhe ato do t'i dorëzohen bashkëshortit, që i takojnë edhe nëse vlera e këtyre sendeve nuk është në raport të drejtë në krahasimin me vlerën e përgjithshme të pasurisë së përbashkët.

4.4.1 Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nga ana e gjykatës

Bashkëshortët, në rastin e lidhjes së martesës apo të bashkëjetesës, hyjnë në raporte pasurore, që rregullohen me norma juridike nga Ligji për Familjen, si edhe nga ligje të tjera, si Ligji mbi Barazinë Gjinore etj, të cilat trajtojnë edhe raportet pasurore.

Ndarja e pasurisë së përbashkët mund të bëhet me marrëveshje edhe gjatë ekzistencës së martesës, por, në praktikë, këto raste janë shumë të rralla. Rastet më të shpeshta të ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve janë ato përmes rrugës gjyqësore, për shkak të mosmarrëveshjeve midis tyre. Kjo pasuri pjesëtohet në mënyrë të barabartë dhe secili prej tyre merr pjesën që i takon në bazë të kontributit gjatë ekzistencës së martesës dhe mbi bazën e punës së përbashkët. Vlerësimi i kontributit të bashkëshortëve bëhet

duke marrë për bazë disa kriterë, ku si më të rëndësishme janë: të ardhurat personale dhe të ardhurat e tjera të bashkëshortit, kujdesi dhe edukimi i fëmijëve, mirëmbajtja e pasurisë, administrimi i punëve të shtëpisë, si edhe forma të tjera të punës që lidhen me mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Kriteri i të ardhurave personale gjen shprehje kryesisht te bashkëshortët e punësuar dhe te ata, që kanë burime të tjera të të ardhurave.

Kriteret tjera, që lidhen me kujdesin e fëmijëve dhe me punët shtëpiake, zbatohen kryesisht në rastet kur bashkëshortët janë të papunë apo janë amvisa.

Në rastet kur bashkëshortët janë pajtuar për ndarjen e pasurisë së përbashkët, atëherë ata këtë gjë e bëjnë me marrëveshje. Por kur nuk arrihet dot marrëveshja për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, atëherë kjo ndarje vendoset nga gjykata.¹²²

Shpesh herë, në situata normale, por kryesisht në situata krizash apo pasigurish, bashkëshortët janë të paqartë dhe të shqetësuar lidhur me kualifikimin e pasurive të caktuara, të krijuara para ose pas martesës, bashkërisht ose individualisht, të dhuruara ose të trashëguara, të tundshme ose të patundshme.¹²³

Për caktimin e vlerës së kontributit të bashkëshortëve në pasurinë e përbashkët, gjykata, me procedurë gjyqësore, bazohet në të shumtën e rasteve në ekspertizën e specialistit të aktuaristikës (ekonomist i specializuar për aktuaristikën), i cili, në mënyrë të detajuar dhe profesionale, merr parasysh të gjitha rrethanat, faktet dhe çdo formë tjetër të kontributit të dhënë nga bashkëshortët në shtimin e pasurisë së përbashkët. Në praktikë, procedura gjyqësore për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët bëhet pas zgjidhjes së martesës në mes të bashkëshortëve.

Në procedurën e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, gjykatat hasin vështirësi të mëdha, sepse bashkëshorti, i cili i mohon bashkëshortit tjetër të drejtën mbi pasurinë e përbashkët, përpiqet me forma dhe mënyra të ndryshme ta mohojë ose ta minimizojë kontributin e bashkëshortit, me qëllim që ta përjashtojë atë nga pjesëmarrja në pasurinë e përbashkët. Në praktikë nuk përjashtohen edhe rastet kur bashkëshorti e regjistron

¹²² Neni 57 i Ligjit për Familjen i Kosovës thotë: nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, perkujdesen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.

¹²³ Mandro, Arta, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009.

paraprakisht pasurinë e patundshme në emër të ndonjë personi tjetër të afërm të tij apo edhe e tjetëron më qëllim që të pamundësojë pjesëtimin e pasurisë.

Në rastin e vlerësimit të kontributit merren parasysh disa kritere, duke u nisur nga fakti nëse bashkëshorti ka qenë në marrëdhënie pune, a ka ushtruar ndonjë biznes, ndonjë zeje apo ka qenë amvisë. Kriter me rendësi është edhe fakti nëse amvisa ka jetuar në fshat apo në qytet. Kritere të tjera të rëndësishme janë edhe kohëzgjatja e martesës, si edhe numri i fëmijëve.

Gjatë pjesëtimin të pasurisë së përbashkët, në fillim shlyhen të gjitha borxhet e përbashkëta, kurse pastaj bëhet pjesëtimi i pasurisë së mbetur.¹²⁴

4.4.2 Kriteret për vlerësimin dhe llogaritjen e kontributit të bashkëshortëve

Bashkëshortët, gjatë ekzistencës së martesës, kontribuojnë në shtimin e pasurisë së përbashkët në forma dhe mënyra të ndryshme. Kontributi i bashkëshortëve në shtimin e pasurisë së përbashkët është i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë. Kontributi i drejtpërdrejtë ekziston atëherë kur bashkëshorti kryen veprimtari që sjell të ardhura, qoftë në të holla apo në natyrë, apo edhe në të dyja këto raste.¹²⁵ Kontributi jo i drejtpërdrejtë ndryshon nga ai i drejtpërdrejtë, sepse bashkëshorti në këtë rast kryen veprimtari tjera, të cilat nuk krijojnë të ardhura, por ato në mënyrë indirekte kontribuojnë në shtimin e pasurisë së përbashkët, si: kujdesi dhe edukimi i fëmijëve, punët shtëpiake, mirëmbajtja e shtëpisë, përgatitja e ushqimit dhe larja e rrobave, si edhe punë të tjera me anën e të cilave ndihmohet bashkëshorti. Në këtë mënyrë, në pasurinë e përbashkët kontribuohet jo drejtpërsëdrejti.

Kontributi me anën e të ardhurave apo përmes pagës, është me ndikim dhe i lehtë për t'u argumentuar. Ndërsa kriteri më i vështirë për t'u vlerësuar është rasti kur bashkëshorti, sipas ndarjes së punëve brenda familjes, kryen punët e përbashkëta të amvisërisë, të cilat janë në numër jo të vogël.

Paga, si një burim kryesor i të ardhurave personale, është një e ardhur, e cila kontribuon në masë të madhe në shtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Bashkëshortët, të cilët janë të punësuar, kanë mundësinë materiale të kontribuojnë në shtimin e pasurisë së përbashkët në dallim nga bashkëshortët, të cilët janë të papunë. Në rastin e llogaritjes së kontributit të bashkëshortes si amvisë merren parasysh faktorët kryesorë, siç janë: të

¹²⁴ Aliu, Abdulla dhe Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007

¹²⁵ Po aty, f. 247.

ardhurat mesatare personale të të punësuarve të kualifikuar, gjysmë të kualifikuar dhe të pakualifikuar.¹²⁶

Qeveria e Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social të Kosovës, me Vendimin e saj Nr. 04/33 të datës 17.08.2011, ka përcaktuar nivelin e pagës minimale në shkallë kombëtare për vitin 2011, që është në shumën 130 Euro për të punësuarit deri në moshën 35 vjeçare dhe 170 Euro për të punësuarit mbi moshën 35 vjeçare e deri në moshën 65 vjeçare.

Kriteri tjetër me rëndësi është edhe fakti nëse bashkëshorti jeton në qytet apo në fshat, por edhe kriteri i moshës. Për sa i përket kriterit të parë, amvisat, të cilat jetojnë në fshat dhe kanë pasuri të patundshme, janë më të privileguara, sepse përveç punëve të shtëpisë dhe kujdesit ndaj fëmijëve, ato mund të kryejnë edhe punë të tjera bujqësore. Në vartësitë masës së pasurisë, që zotërojnë bashkëshortët, si pasuria e patundshme, numri i bagëtive, i shpezëve, i sipërfaqes së pemëtarisë, përcaktohet edhe vlera e kontributit të bashkëshortit. Për sa i përket kriterit të moshës, merret parasysh fakti se në çfarë moshe është bashkëshorti, pra nëse ai është i moshës së re apo i moshës së vjetër.

4.4.2.1 Vlerësimi i kontributit për punët e amvisërisë

Në vlerësimin e kontributit të bashkëshortëve për shtimin e pasurisë, gjykata, në rastin e marrjes së vendimit, merr për bazë kontributin e bashkëshortit, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat dhe jo vetëm të ardhurat personale, por edhe ndihmën që njëri bashkëshorti jep bashkëshortit tjetër, nëpërmjet punëve shtëpiake, ku merren parasysh sidomos edhe:

- përgatitja e ushqimit dhe servirja e tij,
- larja dhe hekurosja e rrobave,
- larja e enëve,
- mirëmbajtja e objektit të banimit (shtëpisë apo banesës),
- mbajtja e higjienës,
- furnizimi me gjëra ushqimore dhe sende tjera,
- kujdesi dhe mbajtja e fëmijëve dhe personave të moshuar,
- edukimi i fëmijëve.

¹²⁶ Punëtorë të pakualifikuar janë punëtorët me arsimim fillor, të cilët kanë aftësi elementare dhe kështu kanë nivelin fillestar të përgatitjes profesionale.

Punëtorë gjysmë të kualifikuar janë punëtorët me arsimim sekondar të cilët janë të specializuar dhe duhet ta kenë të përfunduar shkollimin e detyruar.

Punëtorë të kualifikuar janë ata punëtorë të cilët përgatiten për profesione specifike ne tregun e punës.

Në rast se marrim për bazë faktin se bashkëshorti, amvisa, ka jetuar në fshat apo në qytet, ashtu siç u tha edhe më sipër, mund të themi se amvisat, të cilat jetojnë në fshat janë më të favorizuara në drejtim të pasurisë, sepse përveç punëve të përditshme dhe të kohëpaskohshme të amvisërisë, ato mund të kryejnë edhe punë tjera në fushën e bujqësisë, të blegtorisë, shpezërisë, pemëtarisë dhe të tjera. Kjo varet kryesisht nga pasuria që zotëron amvisa në ekonominë e saj familjare, për shembull, sa sipërfaqe toke ka, çfarë fondi bagëtish ka, sa pajisje agroteknike ka, sa sipërfaqe të pemëtarisë, sasia e shpezëve apo bletarisë etj.

Në rastet kur amvisa ka jetuar në një ekonomi familjare në qytet, përveç punëve të amvisërisë në shtëpi, ajo mund të kontribuojë me punën e saj edhe në suksesin e biznesit të bashkëshortit. Dispozitat të cilat rregullojnë pjestimin e pasurisë së përbashkët në rast të shkurorëzimit zbatohen përshtatshmërisht (*mutatis mutandis*) edhe në rastet e anulimit të martesës.

4.5 Raste nga praktika gjyqësore

Gjatë punimit të këtij studimi janë marrë dhe analizuar dhjetë raste nga gjykatat e ndryshme të Kosovës, duke paraqitur disa nga veçoritë personale të paditësve, siç janë: përkatësia gjinore, kohëzgjatja e martesës, jetesa në fshat apo në qytet, mosha e paditësve, marrëdhëniet e punës dhe aprovimi i kërkesëpadisë.

Paditëse		Kohëzgjatja e martesës	Vendbanimi		Mosha	Mardhënia e punës		Vendimi i Gjykatës	
Femër	Meshkuj		Fshat	Qytet		E punësuar	E papunë	Aprovuar	Refuzuar
10	0	9-41 vjet	4	6	43-64 vjet	6	4	9	1

Tabela 3. Përkatësia gjinore e paditësve, kohëzgjatja e martesës, jetesa në fshat apo në qytet, mosha e paditësve, marrëdhëniet e punës dhe vendimet gjyqësore.

Nga studimi i 10 lëndëve që janë analizuar dhe studiuar, karakteristike është se në këto raste, si palë paditëse paraqitet gjinia femërore. Për sa i përket kohëzgjatjes së martesës, nga tabela shihet se ajo ka qenë minimumi 9 vjet dhe maksimumi 41 vjet. Gjatë studimit të këtyre lëndëve është vërejtur se shumica e bashkëshortëve (paditësve) apo 6 prej tyre jetojnë në qytet, ndërsa 4 në fshat. Mosha është një kriter i rëndësishëm në vlerësimin e kontributit të përbashkët dhe nga të dhënat statistikore shihet se mosha e bashkëshortëve, që ngrenë padi është kryesisht mosha mesatare rreth 50 vjet. Nga tabela shihet se procedurën gjyqësore e nisin kryesisht femrat e punësuar, gjë që është një tregues për pozitën e fortë ekonomike, e cila e bënë gruan më të fuqishme dhe më këmbëngulës në mbrojtjen e të drejtave të saj pasurore. Ndërkaq, në anën tjetër, bashkëshortet e papuna e ndiejnë veten më pak të fuqishme dhe hezitojnë të nisin procedurën gjyqësore për ndarjen e pasurisë së përbashkët. Kjo mund të jetë pasojë edhe e mosnjohjes së të drejtave pasurore nga ana e tyre.

Në rastet e trajtuara, pjesa më e madhe e kërkesëpadive për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët janë aprovuar nga gjykata, ndërsa vetëm një është refuzuar.

4.6 Kthimi i dhuratave

Bashkëshortët, me rastin e lidhjes së martesës, i japin dhurata njëri tjetrit, por pas zgjidhjes së martesës, ato mund të kërkojnë që t'i kthehen bashkëshortit që i ka dhuruar. Dhuratat mund të jenë dhënë me një vlerë të vogël ose të madhe. Dhurata me vlerë të vogël konsiderohen ato që janë për përdorim personal (rrobat, kravatat, këmbështet, këpucët etj.). Dhuratat me vlerë të madhe janë ato që, në raport me gjendjen ekonomike të bashkëshortit, mund ta keqësojnë pozitën e atij që i ka dhuruar, të tilla si: zbulimet prej ari, unazat me gurë të çmuar, orët prej ari etj. Lidhur me dhuratat e fundit në dokritën juridike ekzistojnë dy variante, që dallojnë njëri nga tjetri, në varësi prej fajit lidhur me zgjidhjen apo anulimit të martesës. Elementi i parë është vlera e dhuratës, ndërsa elementi i dytë është fajësia.¹²⁷

Bashkëshorti i pafajshëm për shkurorëzimin i mban të gjitha dhuratat që ka marrë nga bashkëshorti tjetër, për fajin e të cilit është bërë shkurorëzimi. Sipas Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Martesore të ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), dhuratat që kishin pasur vlerë të madhe dhe që nuk kishin qenë në përpjesëtim me gjendjen ekonomike të dhuruesit, ktheheshin po në atë gjendje që ishin në kohën kur lindi

¹²⁷ Hamdi Podvorica, vepra e cituar, faqe 137

shkaku i shkurorëzimit. Ndërsa në rastin e dhuratave të tjetërsuara kthehej vlera ose sendet që merreshin në vend të tyre.

Ligji i Kosovës mbi Familjen tani nuk e rregullon në mënyrë vendimtare çështjen e kthimit të dhuratave, sepse në Nenin 13 të LFK-së, parashikohet vetëm kthimi i dhuratave të personave që janë të fejuar, ku theksohet se nëse fejesa nuk përfundon me martesë, atëherë secili i fejuar mund të kërkojë nga tjetri kthimin e dhuratave, të cilat i ka dhënë me rastin e fejesës. Në këto raste, i fejuari mundet që me paraqitjen e padisë për pasurim të pa bazë, sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, të kërkojë kthimin e këtyre dhuratave. Në rast se njëri nga të fejuarit vdes, e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit nuk ekzekutohet.

4.7 E drejta e banesës

Në rastin e ndarjes së banesës dhe sendeve tjera shtëpiake, LFK i jep përparësi ndarjes me marrëveshje. Kur është fjala për banesat e blera nga çifti bashkëshortor, nga momenti i blerje kjo bëhet pjesë përbërëse e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe në kontestin e rregullimit të ndarje së pronës së përbashkët do të zgjidhet edhe çështja e banesës.¹²⁸ Por në rastet kur bashkëshortët nuk mund të merren vesh, lidhur me faktin se cilit bashkëshort duhet t'i jepet e drejta që të jetojë në banesë ose për ndarjen e pajisjeve të shfrytëzuara bashkërisht, si edhe sendeve të tjera që i takojnë shtëpisë, vendimi duhet të merret nga gjykata me kërkesën e njërit apo me kërkesën e të dy bashkëshortëve. Në rastin e vendimit që lidhet me këtë kërkesë gjykata do të ketë parasysh mirëqenien e fëmijëve, kur bashkëshortët kanë fëmijë, si edhe pozitën sociale dhe materiale të bashkëshortëve.

Nëse fëmijët i besohen për përkujdesje njërit bashkëshort, atëherë kjo është një rrethanë në të cilën mbështetet edhe vendimi i gjykatës për t'ia dhënë të drejtën e banesës bashkëshortit, që i janë besuar fëmijët për ruajtje, për kujdes dhe për edukim.

4.8 E drejta e trashëgimisë

Në rastin e zgjidhjes së martesës, bashkëshorti humb edhe të drejtën për të trashëguar pasuri të bashkëshortit tjetër. Kjo e drejtë pushon edhe në rastet kur bashkëshorti, derisa sa ka qenë gjallë, ka ngritur padi për shkurorëzim, por vdes pa u shqyrtuar padia dhe në

¹²⁸ Hamdi Podvorica, vepra e cituar, faqe 138

këtë rast, me kushtin që pas përfundimit të procedurës së vazhduar nga ana e trashëgimtarëve padia e paditësit për shkurorëzim vlerësohet si e bazuar nga gjykata.

Bashkëshorti nuk mund të trashëgojë pasuri as në bazë të testamentit, në rastin, kur autori i testamentit vdes dhe ky testament është hartuar para shkurorëzimit, dhe konsiderohet se testamenti është revokuar heshtazi. Nëse testamenti është përpiluar pas zgjidhjes apo anulimit të martesës, ai është i plotëfuqishëm dhe krijohen efekte juridike.¹²⁹ Në bazë të Ligjit të Kosovës për Trashëgiminë (LTK), bashkëshorti mund të jetë si trashëgimtar ligjor i bashkëshortit tjetër në dyja rendet trashëgimore.

Me anulimin apo me zgjidhjen e martesës shuhet edhe kjo bazë ligjore e trashëgimisë, që do të thotë se humbet edhe e drejta e trashëgimisë nga bashkëshorti.

Raste nga praktika gjyqësore

Gjatë punimit të këtij studimi janë marrë dhe analizuar disa raste nga gjykatat e ndryshme të Kosovës, duke paraqitur disa nga veçoritë personale të trashëgimlënësit dhe trashëgimtarëve, të tilla si: përkatësia gjinore e trashëgimlënësit, trashëgimtarët e shpallur dhe heqja dorë nga trashëgimia.

Trashëgimlënës		Trashëgimtar		Heqja dorë nga trashëgimia	
Femëra	Meshkuj	Femëra	Meshkuj	Femëra	Meshkuj
0	19	17	25	28	1

Tabela 4. Përkatësia gjinore e trashëgimlënësit, trashëgimtarëve, heqja dorë nga trashëgimia.

Nga studimi i 19 rasteve, që janë analizuar dhe studiuar, është karakteristike se si trashëgimlënës paraqitet gjinia mashkullore, ndërkohë që nuk ka asnjë rast të tillë nga gjinia femërore. Për sa iu përket trashëgimtarëve, nga numri i përgjithshëm prej 42 trashëgimtarësh, 25 prej tyre janë meshkuj, ndërsa vetëm 17 janë femra. Nga tabela shihet se ka pasur vetëm një rast kur trashëgimtari mashkull ka hequr dorë nga trashëgimia, ndërsa 28 trashëgimtare femra, kryesisht motra, kanë hequr dorë nga trashëgimia në favor të vëllezërve. Gruaja ka të drejtën ligjore që të jetë trashëgimtare e trashëgimlënësit, por fatkeqësisht, në praktikë, në të shumtën e rasteve, nëse nga martesa nuk ka lindur asnjë fëmijë apo kanë lindur vetëm vajza, atëherë e drejta e trashëgimisë nga ana e gruas

¹²⁹ Hamdi Podvorica, vepra e cituar, faqe 138

kontestohet nga trashëgimtarët e tjerë. Në këto raste, trashëgimtarët e tjerë paraqiten si trashëgimtarë të vetëm edhe pse sipas dispozitave ligjore pasuria duhet të ndahet në mes të gjithë trashëgimtarëve, përfshi edhe gratë. Praktika ka treguar se femrat si trashëgimtare, në shumicën e rasteve, kanë hequr dorë nga e drejta e trashëgimisë në favor të vëllezërve apo të trashëgimtarëve të tjerë përmes një deklarate të dhënë përpara gjyqtarit. Sipas ligjit, gruaja ka të drejtë të heqë dorë nga pjesa e pasurisë trashëgimore, por praktika tregon se një dukuri e tillë është rezultat i të drejtës zakonore apo i presionit nga rrethi familjar dhe shoqëror, si për të ruajtur raporte të mira me vëllezërit, ashtu edhe për evitimin e konfliktit apo të keqësimit të raporteve me vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes. Në rastin e heqjes dorë nga trashëgimia, pozita trashëgimore e trashëgimtarit ndryshon rrënjësisht për shkak se ai tani humbet autorizimet juridike trashëgimore, të cilat, *iso jure*, i kishte fituar në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit të tij.¹³⁰ Gratë janë të vetëdijshme për pasojat me të cilat mund të ballafaqohen, nëse ato kërkojnë pjesën e pasurisë trashëgimore, që iu takon dhe në këto raste, ato kanë frikë se nëse e kërkojnë të drejtën e trashëgimisë do të izolohen dhe injorohen nga anëtarët e tjerë të familjes së tyre. Për sa i përket pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, gjatë punimit të këtij studimi janë marrë dhe analizuar pesë raste nga gjykatat e ndryshme të Kosovës, duke paraqitur kështu disa nga veçoritë personale të paditësve, siç janë: përkatësia gjinore, kohëzgjatja e martesës, jetesë, mosha e paditësve, statusi i punës dhe aprovimi i kërkesëpadisë.

Paditës		Kohëzgjatja e martesës	Mosha	Statusi i punës		Vendimi i Gjykatës	
Femëra	Meshkuj			E punësuar	E papunë	Aprovuar	Refuzuar
5	0	9-39 vite	42-63 vjeçe	3	2	4	1

Tabela 5. Përkatësia gjinore e paditësve, kohëzgjatja e martesës, jetesë, statusi i punës dhe vendimet gjyqësore.

Nga studimi i 5 rasteve, që janë analizuar dhe studiuar, karakteristik është fakti se si palë paditëse paraqitet gjinia femërore. Për sa i përket kohëzgjatjes së martesës, nga tabela shihet se ajo ka zgjatur minimumi 9 vjet dhe maksimumi 39 vjet. Mosha është një kriter i rëndësishëm në vlerësimin e kontributit të përbashkët dhe nga të dhënat statistikore shihet se mosha e bashkëshortëve, që ngrenë padi, është kryesisht mosha mesatare, rreth 50 vjet.

¹³⁰ Podvorica, Hamdi, E Drejta Trashëgimore, f. 84

Nga statistikat shihet se procedurën gjyqësore e nisin kryesisht femrat, që janë të punësuar. Në rastet e trajtuara, pjesa më e madhe e kërkesëpadive për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, janë aprovuar nga gjykata, ndërkohë që është refuzuar vetëm një. Nga studimi i rasteve praktike shihet se, megjithëse të drejtat e gruas në Kosovë garantohen me dispozita ligjore, në praktikë, në disa raste, ato nuk respektohen dhe janë larg standardeve ndërkombëtare, çka do të thotë se përcaktimi i të drejtave vetëm me dispozita ligjore është i pamjaftueshëm, përderisa ato nuk zbatohen në praktikë. Në një shkrim të gazetës “Zëri, ” të datës 22 qershor 2012, me titull “Motër e vëlla, prona pa u nda”, theksohet se:” Megjithëse legjislacioni ia njeh femrës të drejtën e trashëgimisë, madje ka edhe ligje të avancuara, zbatimi i tyre ngec në praktikë.”¹³¹ Në të njëjtin shkrim të kësaj gazete, nga një hulumtim i bërë është konstatuar se në raportet motër e vëlla lidhur me trashëgiminë, motra heq dorë nga pasuria e trashëguar prej prindërve.

4.9. E drejta dhe detyrimi i ushqyerjes së fëmijëve

Prindërit kanë detyrim moral dhe ligjor që të përkujdesen për fëmijët e tyre të mitur, për shëndetin, edukimin, arsimimin dhe aftësimin e tyre për punë të pavarur derisa të mbushin moshën madhore, e në kushte të caktuara me ligj edhe pas mbushjes së moshës madhore.¹³² Prindërit duhet të përmbushin detyrimet e tyre kundrejt fëmijëve sipas pasurive që disponojnë, si dhe sipas aftësisë së tyre për punë profesionale që kryejnë, ose në punë shtëpiake.¹³³

LFK, me dispozitat e Nenit 330, i ka përcaktuar parimet për përcaktimin e mbajtjes dhe alimentacionit. Kështu, në paragrafin 1 të Nenit 330 parashihet se detyrimi për të mbështetje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit. Sipas kësaj dispozite rrjedh se gjykata, në marrjen e vendimit për raste të tilla duhet të ketë parasysh dy rrethana të rëndësishme, si mundësinë e të paditurit, ashtu edhe nevojat e paditësit, kurse pastaj, në proporcion me to, merr vendim. Në rastin e caktimit të masës së kontributit për mbajtje, gjykata duhet të vlerësojë jo vetëm të ardhurat personale të të paditurit, por edhe honorarët, si edhe të gjitha të ardhurat e realizuara nga i paditurinë forma tjera.

Në mënyrë specifike me dispozitat ligjore në fuqi është përcaktuar se prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre. Nëse fëmija nuk ka përfunduar

¹³¹ Gazeta “Zëri” e datës 22 qershor 2012, Prishtinë, f. 6.

¹³² Hamdi Podvorica, vepra e cituar, f.233

¹³³ Kodi Civil Italian, Neni 316.

shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri në moshën 26 vjeçare.¹³⁴ Mirëpo në praktikë ka raste kur nga ana e palës paditëse kërkohet shuma e caktuar në emër të mbajtjes financiare për fëmijët madhor të cilët nuk janë në vijim të shkollimit. Në të gjitha këto raste gjykata e refuzon kërkesëpadinë e paditësve.¹³⁵

Dhënia e ushqimit zakonisht bëhet në para. Nëse në ndonjë rast konkret është e nevojshme që detyrimi për ushqim në të holla të zëvendësohet me ndonjë formë tjetër, për këtë zëvendësim duhet marrë lejen nga organi i kujdestarisë. Duke u bazuar në dispozitat e Nenit 278 të LFK-së, parimisht ushqimi mund të jepet në dy mënyra: në para ose në natyrë. Dhënia e detyrimit në natyrë paraqitet zakonisht si ushqim nga bashkëshorti ose si ushqimi i prindërve për fëmijët. Kjo formë është pothuajse e pamundur në detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve. Në këtë rast detyrimi i prindit për të dhënë kontributin për ushqimin e fëmijës mund të jetë vetëm në para, ndaj nga kjo shihet se prindi nuk e ka mundësinë e zgjedhjes së ndonjë forme tjetër të ushqimit për fëmijët.

Me dispozitat e LFK-së (290 & 298) është rregulluar detyrimi ushqimor në mes të prindërve dhe fëmijëve, në mes të bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesorë.

Ky ligj nuk përmban dispozita të posaçme lidhur me ushqimin e bashkëshortit jashtëmartesor, por detyrimi i tyre për ushqim buron nga paragrafi 2 i Nenit 39 të LFK-së, sepse, sipas tij, bashkësia jashtëmartesore është e barabartë me statusin martesor, ndaj janë të tilla edhe aspekti i mbështetjes financiare reciproke, si edhe të drejtat pasurore. Sipas Ligjit për Gjykatat, në kontestet për ushqim, pavarësisht nga fakti se për ushqimin e cilëve persona bëhet fjalë, procedurën e zhvillon dhe vendos gjykata themelore, bazuar në faktin se cila është kompetente.

Detyrimi ligjor mbi ushqimin e fëmijëve nga prindërit, si dhe në mes të bashkëshorteve, mund të vendoset në dy procedura të filluara:

Në procedurën e filluar për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim apo me anulimin e martesës, në të njëjtin vendim, me të cilin zgjidhet martesa, vendoset edhe lidhur me ushqimin e fëmijëve të mitur. Për ushqimin e fëmijëve të mitur, gjykata, gjatë procedurës

¹³⁴ LFK, Neni 290, par.2

¹³⁵ Shih: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.199/15, datë 10.09.2015.

së shkurorëzimit, kujdeset sipas detyrës zyrtare, ashtu si edhe në rastet kur nuk ka kërkesë për pagesën e ushqyerjes nga prindi, të cilit i është besuar fëmija i mitur.

Në të njëjtën procedurë bashkëshorti ka të drejtë të kërkojë që gjykata të vendosë lidhur me ushqimin e tij. Nga ky konstatim rrjedhë se në këto raste në procedurën e shkurorëzimit lidhur me ushqimin e bashkëshortit gjykata do të vendosë vetëm sipas kërkesës për ushqim të paraqitur nga bashkëshorti, që nënkupton se gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare për ushqimin e bashkëshortit për dallim nga ajo e fëmijëve.

Në rastet kur bashkëshortët kanë shpëputur bashkësinë faktike të jetës së përbashkët dhe jetojnë të ndarë edhe pse formalisht ende janë në martesë, dhe kanë fëmijë të mitur të cilët jetojnë me njërin prind, ky si përfaqësues ligjor tek i cili jetojnë fëmijët, në emër të fëmijëve ka të drejtë të fillon procedurën në gjykatën kompetente me kërkesë që të detyrohet prindi tjetër tek i cili nuk jetojnë fëmijët, që të kontribuojë për ushqimin e fëmijëve.

Në të njëjtën procedurë bashkëshorti ka të drejtë të kërkojë që gjykata të vendosë edhe lidhur me ushqimin e tij. Nga ky konstatim rrjedhë se, në këto raste, gjatë procedurës së shkurorëzimit, gjykata do të vendosë lidhur me ushqimin e bashkëshortit vetëm sipas kërkesës për ushqim të paraqitur nga bashkëshorti, gjë që nënkupton se në këtë rast, për ushqimin e bashkëshortit, gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, në dallim nga detyra zyrtare që ka ndaj fëmijëve.

Në rastet kur bashkëshortët kanë shpëputur bashkësinë faktike të jetës së përbashkët dhe jetojnë të ndarë edhe pse formalisht ende janë në martesë, por kanë fëmijë të mitur, të cilët jetojnë me njërin prind, ky, si përfaqësues ligjor ku jetojnë fëmijët, në emër të fëmijëve ka të drejtë të fillojë procedurën në gjykatën kompetente me kërkesën që prindi tjetër, ku nuk jetojnë fëmijët, të detyrohet të kontribuojë për ushqimin e fëmijëve.

Në rastet kur bashkëshortët në martesë e kanë ndërprerë jetën e përbashkët dhe asnjëri nuk e ka filluar procedurën e shkurorëzimit, ndaj martesa ekziston ende, bashkëshorti në gjendje të rëndë materiale apo që ka nevojë për ushqim mund të kërkojë nga bashkëshorti tjetër që të kontribuojë për ushqimin e tij. Në rastet kur bashkëshorti, gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës nuk ka paraqitur kërkesë për ushqim, ai mund ta bëjë këtë gjë me një procedurë të veçantë gjyqësore brenda afatit prej dy vjetësh që nga momenti i zgjidhjes së martesës.

Në rastin e vendosjes mbi masën e kontributit për mbajtje, gjykata duhet të ketë parasysh gjithnjë gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë e tij për punë (është apo jo i padituri i aftë për të punuar, fakt ky që duhet argumentuar me dokumentacione mjekësore), mundësinë faktike për përmirësimin e tij (mund të jetë i aftë i padituri për punë, por nuk mund të gjej punë apo refuzon punën e ofruar, pra, bën zgjedhjen e punës), kushtet shëndetësore, nevojën e tij personale, detyrimet ligjore të të paditurit (mund të ketë kredi të ndryshme, mund të ketë obligime ligjore për mbajtjen e personave të tjerë e kështu me radhë) si dhe kushte të tjera relevante, të cilat do të kishin ndikim në vlerësimin e mundësisë së të paditurit për dhënien e kontributit dhe mbi masën e këtij kontributi.¹³⁶ Në rastet kur alimentacioni kërkohet për fëmijët, gjykata merr parasysh moshën e fëmijës dhe të gjitha nevojat për edukimin dhe arsimimin.¹³⁷

Vlerësimi i këtyre nevojave bëhet në vartësi edhe nga rrethanat e tjera, të cilat mund të kenë ndikim mbi këto nevoja.

Nevojë normale nuk mund të quhet edukimi i fëmijës duke e regjistruar në një shkollë private, ku shpenzimet janë shumë të mëdha, ndërsa kontributi për mbajtje që duhet të japë, për shembull, një person, i cili është mësimdhënës në një shkollë, ka aq të ardhura sa mezi mbulon shpenzimet elementare të familjes së vet.¹³⁸

4.10 Mbajtja financiare dhe ushqimi

Mbajtja financiare e fëmijëve është obligim prindëror si në rastet kur prindërit jetojnë bashkërisht me fëmijët edhe në rastet kur fëmija nuk jeton me prindërit për shkaqe të parapara me ligj. Detyrimi i prindërve për mbajtjen e fëmijëve vazhdon edhe pas zgjidhjes së martesës, dhe zgjidhja e martesës nuk reflekton në ndryshimin e këtij detyrimi.¹³⁹

Lidhur me çështjen e mbajtjes financiare dhe të ushqimit, LFK ka përcaktuar që në rast se përgjegjësia prindërore nuk është rregulluar ndryshe, atëherë do të aplikohen parimet e përgjithshme të parashikuara në LFK.

¹³⁶ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, “Komentar i Ligjit të Kosovës për Familjen, f. 676.

¹³⁷ Neni 330, paragrafi 2, i LFK-së.

¹³⁸ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, vepër e cituar, f. 676.

¹³⁹ Abdullah Aliu & Haxhi Gashi, vepër e cituar, faqe 310

LFK, në mënyrë specifike, me dispozitën e Nenit 290, paragrafi 1, ka përcaktuar se prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur. Nëse fëmija nuk ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, atëherë prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri në moshën 26 vjeçare.¹⁴⁰

Nëse fëmija i moshës madhore nuk është në gjendje të punojë për shkak të sëmundjes, të të metave fizike dhe mendore apo nuk ka sasi të mjaftueshme të mjeteve financiare për shpenzimet e tij të nevojshme, atëherë prindërit kanë detyrim t'i sigurojnë atij ndihmën e nevojshme financiare.¹⁴¹

LFK, me dispozitën e Nenit 299, ka përcaktuar edhe rastin e ushqimit kur njëri prind ka kujdesin ndaj fëmijës. Në këtë rast, bashkëshorti, që kujdeset për fëmijën, mund të bëjë kërkesë për ushqim ndaj bashkëshortit tjetër, sepse duke u kujdesur dhe duke mbajtur fëmijën e përbashkët ai e ka të pamundur të punojë. Sipas kësaj dispozite, bashkëshorti mund të kërkojë ushqim si rezultat i kujdesit ndaj fëmijës së përbashkët, kur kujdesin prindëror e ushtron prindi, i cili kërkon edhe ushqimin nga bashkëshorti tjetër.

Praktika gjyqësore njeh çdo ditë e më shumë raste të natyrave të tilla, ndaj është e nevojshme që gjykatat të kenë një qasje më të kujdesshme për shkak të detyrimit që ato kanë lidhur me interesin më të mirë të fëmijës së përfshirë në procedurë.

Në procedurën e zgjidhjes së martesës gjykata vendos parimisht edhe për ushqimin e bashkëshortit dhe të fëmijëve.

Aktgjykimi, me të cilin njëri prind është i detyruar për pagesën e ushqimit të fëmijëve të mitur, të cilët jetojnë me prindin tjetër apo edhe në raport me bashkëshortin tjetër, është me karakter të përkohshëm, sepse bashkëshorti, i cili është i detyruar të paguajë ushqimin apo ai që ka të drejtën e ushqimit, mund të paraqesë padi në gjykatë, me kërkesën që ushqimi, i caktuar me aktgjykimin e mëparshëm gjyqësor, të ndryshohet me qëllim që të ndërpritet, të shtohet ose të zvogëlohet, apo të ndryshohet forma dhe mënyra e dhënies së ushqimit, për shkak të ndryshimit të rrethanave mbi bazën e të cilave ka vendosur gjykata.

Nga kjo rrjedh se vendimi i marrë në lidhje me ushqimin e fëmijëve të mitur apo të bashkëshortit, në rastin e zgjidhjes së martesës, mund të ndryshohet më vonë për shkak të

¹⁴⁰ Neni 290, paragrafi 2, i LFK-së.

¹⁴¹ Po aty, Neni 291

ndryshimit të rrethanave mbi bazën e të cilave është vendosur më parë me vendim të gjykatës.

4.10.1 Kushtet për caktimin e masës së ushqimit

Gjykata në kontestet për zgjidhjen e martesës apo në procedurat e veçanta lidhur me pagesën e ushqimit duhet të caktojë shumën për pagesën e ushqimit.

Në praktikë, lidhur me caktimin e nevojave të përgjithshme për ushqim mund të paraqiten vështirësi, në rastet kur i padituri nuk ka mundësi materiale që t'i përmbushë ato nevoja. Vlera e ushqimit caktohet në përpjesëtim me aftësitë dhe mundësitë e bashkëshortit, i cili është i detyruar të paguajë ushqimin brenda kufijve të nevojave të paditësit. Gjykata, në çdo rast konkret, duhet t'i vlerësojë nevojat e paditësit-kërkuesit të ushqimit, gjithnjë duke pasur parasysh gjendjen e tij financiare dhe pasurore, aftësinë për të punuar, gjendjen shëndetësore, nevojat personale, si edhe rrethana të tjera me ndikim në caktimin e masës së ushqimit. Në këtë rast, si bashkëshort në gjendje jo të mirë materiale apo në pamundësi për të siguruar nevojat elementare për jetesë konsiderohet edhe bashkëshorti i punësuar, të ardhurat e të cilit nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave për jetesë, prandaj ai, për këtë arsye, mund të paraqesë padi dhe të kërkojë nga gjykata që bashkëshorti tjetër të detyrohet të paguajë ushqimin plotësisht. Në situatat kur bashkëshorti, pas zgjidhjes së martesës, heq dorë nga pjesa e tij e trashëgimisë, me të ardhurat e së cilës ka pasur mundësi të jetojë, ai nuk ka të drejtë ta kërkojë pagesën e ushqimit nga bashkëshorti tjetër. Në të njëjtën situatë, nuk ka të drejtë që të kërkojë ushqimin edhe bashkëshorti, i cili pa ndonjë arsye, e ndërpret marrëdhënien e punës dhe e vë veten në gjendje të rëndë materiale, pra, pa mjete për jetesë. Në rastet kur kërkohet pagesa e ushqimit për fëmijët e mitur, ka rëndësi edhe mosha e fëmijës, nevojat për edukim dhe arsimim profesional, gjendja shëndetësore e tij, si edhe rrethana tjera. Në rastin e vlerësimit të mundësive të bashkëshortit, nga i cili kërkohet pagesa e ushqimit, gjykata duhet t'i ketë parasysh të gjitha të ardhurat, që realizon ai, si të ardhurat e rregullta mujore, ashtu edhe ato periodike (të ardhurat nga puna në teren, nga bujqësia, honorari i autorit dhe të tjera). Nga ana tjetër, në mënyrë të njëjtë, për shkak të ndryshimit të rrethanave duhen vlerësuar dhe shqyrtuar edhe rastet që lidhen me zvogëlimin eventuale të të ardhurave për shkak të sëmundjes, pa aftësisë së përkohshme për punë, pushimit mjekësor dhe raste të tjera të ngjashme. Në praktikë ndodhin raste me përpjekje për t'iu shmangur detyrimit apo me qëllim që ai të jetë sa më i ulët, ndaj duhet të kihet parasysh

se bashkëshorti, nga i cili kërkohet ushqimi, mund të bëjë veprime të ndryshme me qëllim të zvogëlimit të të ardhurave të tij gjatë zhvillimit të procedurës së shkurorëzimit, si duke tjetërsuar pasurinë, ashtu edhe duke fshehur të ardhurat e tij. Për këtë arsye gjykata, në rastet kur vendos lidhur me ushqimin duhet t'i vlerësojë dhe t'i shqyrtojë të gjitha faktet, jo vetëm në momentin e vendimit për ushqimin, por për një kohë të mëparshme, më të gjatë.

Në rastet e vlerësimit të mundësive për të kontribuar në ushqimin e fëmijëve, gjykata duhet të vlerësojë edhe mundësitë reale për realizimin e të ardhurave nga bashkëshorti, të cilit i kërkohet ushqimi, nevojat e tij personale dhe detyrimet tjera për ushqim që ka ndaj personave tjerë, me të cilët jeton. Parimi i përgjithshëm është se prindërit janë të detyruar të kontribuojnë për ushqimin e fëmijëve edhe në rastet kur rrezikojnë mjetet e tyre financiare, edhe sikur të keqësohet gjendja e tyre materiale.

Masa e kontributit për ushqimin e fëmijëve varet, nga njëra anë, nga mundësitë financiare të prindit dhe nga ana tjetër, nga nevojat e fëmijës. Prindi nuk mund të detyrohet që, në emër të kontributit të tij për ushqimin e fëmijës, të paguajë më tepër se sa janë nevojat reale të fëmijës, edhe në rastet kur prindi i ka mundësitë financiare për ta dhënë kontributin për ushqimin në atë masë. Gjikata, gjatë procedurës për ushqimin e fëmijës, kur vendos për masën e kontributit merr parasysh edhe angazhimin, edhe përkujdesjen e rregullt të prindit, të cilit i është besuar fëmija.

4.10.2 Pushimi i të drejtës për ushqim

Bashkëshorti ka të drejtë të paraqesë kërkesë për ushqimin në proporcion me mundësitë financiare të bashkëshortit tjetër edhe në rastet kur ai nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për jetesë apo nuk është i aftë të punojë apo të punësohet. Në rastet kur bashkëshorti, i cili kujdeset për fëmijët e përbashkët, nuk ka mundësi t'i përmbushë nevojat e fëmijëve, atëherë ai ka të drejtë të kërkojë ushqim nga bashkëshorti tjetër, derisa kërkuesi kujdeset për fëmijët e mitur.

Në bazë të ligjit, detyrimi për ushqimin e bashkëshortit pushon:

- Në rastet kur bashkëshorti përfitues krijon mjete të mjaftueshme për jetesë, punësohet apo krijon mundësi për punësim.
- Kur skadon afati i caktuar me vendim të gjykatës për ushqimin dhe ushqimi është paguar për një kohë të caktuar.

- Në rast kur bashkëshorti i shkurorëzuar martohet me ndonjë person tjetër apo krijon bashkësi jashtëmartesore dhe
- Kur bashkëshorti, i cili ka mbuluar kontributin e ushqimit vdes.

Detyrimi për ushqim pushon edhe në rastet kur personi, që përfiton ushqimin, krijon kushte që ta mbajë vetë veten, me mjetet e tij financiare, ndaj dhe nuk ka nevojë për kontributin e tjetrit, si edhe në rastet kur personi, që paguan ushqimin, nuk ka mundësi të kontribuojë për ushqimin për shkak të ndryshimit të rrethanave të tij aktuale.

4.11 Vendimi *ex officio* i gjykatës

Në çdo rast, kur është e mundur, vendimet për mbrojtjen dhe mbajtjen e fëmijëve në kontestet martesore duhet të jenë *ex officio*.¹⁴² Pra, pavarësisht nga fakti nëse ka pasur apo jo kërkesë nga prindërit për mbrojtjen dhe mbajtjen e fëmijëve, gjykata, sipas detyrës zyrtare, duhet të caktojë mbrojtjen dhe mbajtjen e fëmijëve.

Gjykata duhet të pranojë një marrëveshje të prindërve për mbajtjen financiare në përputhje me këtë ligj vetëm nëse marrëveshja është në përputhje me dispozitat e këtij ligji mbi çështjet e mbajtjes financiare.¹⁴³ Në këtë rast duhet të shihet parimi i interesit më të mirë të fëmijës. Gjykata nuk mund të pranojë një marrëveshje për mbajtje në qoftë se vlerëson që ajo marrëveshje do të dëmtojë interesat e fëmijës. Gjykata, për mbajtjen financiare të fëmijës, vendos *ex officio* vetëm nëse është vërtetuar së i padituri është babai i fëmijës dhe po ashtu është e vërtetuar së edhe e paditura është nënë e fëmijës.¹⁴⁴ Gjatë gjithë procedurës, gjykata, sipas detyrës zyrtare, mund të caktojë me aktvendim masat e përkohshme lidhur me mbrojtjen, vendosjen dhe ushqimin e fëmijëve të mitur, ndërsa lidhur me dhënien e ushqimit të bashkëshortit në gjendje të rëndë materiale dhe vendosjen e tij, ajo vendos vetëm mbi bazën e propozimit të tyre. Në këto raste ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.

¹⁴² Neni 325, paragrafi 1, i LFK-së.

¹⁴³ Po aty, Neni 325, paragrafi 2.

¹⁴⁴ Po aty, Neni 325, paragrafi 3.

Në kontekstet gjyqësore për ushqim, në shkallë të parë, vendos trupi gjykues i përbërë prej tre gjyqtarëve, një gjyqtar profesional dhe dy porotë. Ndërsa në shkallë të dytë vendos kolegji prej tre gjyqtarëve profesionalë.

Vendimi i gjykatës në kontestet e ushqimit ka karakter deklarativ dhe jo konstitutiv, sepse qëllimi i kontributit për ushqim është plotësimi i nevojave reale të kërkuesit të ushqimit për jetesë, që nga koha e paraqitjes së kërkesës dhe në të ardhmen. Nga kjo rrjedh se ushqimi nuk mund të kërkohet për kohën e kaluar, por vetëm për të ardhmen. Në rastet kur bëhet fjalë për ushqimin e fëmijëve të mitur në të kaluarën dhe në atë rast ka kontribuar vetëm njëri prind, ndërsa prindi tjetër nuk ka kontribuar, edhe pse ka pasur mundësi për të kontribuar, por këtë gjë nuk e ka bërë, prindi, i cili i ka kryer shpenzimet e ushqimit të fëmijëve të përbashkët, ka të drejtë të kërkojë kompensimin e pjesës së paguar prej tij në përpjesëtim me pjesën që ka pasur mundësi për të kontribuar prindi tjetër.

4.11.1 Parimet për caktimin e alimentacionit

Prindërit janë të detyruar për kujdesin ndaj fëmijëve lidhur me ushqimin (alimentacionin). Edhe nëse ndonjërit prind i është hequr kujdesi prindëror ai nuk lirohet nga detyrimi për t'i mbajtur fëmijët e tij.¹⁴⁵

LFK, me dispozitat e Nenit 330, ka përcaktuar edhe parimet për përcaktimin e mbajtjes dhe alimentacionit. Kështu LFK, me dispozitën e Nenit 330, paragrafi 1, përcakton se detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit. Sipas kësaj dispozite rrjedh se gjykata, në kohën e vendosjes, për raste të tilla duhet të vlerësojë dy rrethana të rëndësishme, mundësinë e të paditurit, si edhe nevojat e paditësit dhe pastaj, në proporcion me to, duhet edhe të vendosë.

Në rastin e caktimit të masës së kontributit për mbajtje, gjykata duhet të vlerësojë jo vetëm të ardhurat personale të të paditurit, por edhe honorarët dhe të gjitha të ardhurat e realizuara nga i padituri në forma tjera.

Në rastet kur alimentacioni kërkohet për fëmijë, gjykata merr parasysh moshën e fëmijës dhe të gjitha nevojat për edukimin dhe arsimimin e tij.¹⁴⁶ Vlerësimi i këtyre nevojave

¹⁴⁵ Abdullah Aliu & Haxhi Gashi, vepra e cituar, f. 310

bëhet në varësi edhe nga rrethanat e tjera, të cilat mund të kenë ndikim mbi këto nevoja. Nuk mund të jetë nevojë normale regjistrimi i fëmijës në ndonjë shkollë apo kolegji privat, ku kërkohen shpenzime më të larta, e në anën tjetër i padituri - dhënësi i mbajtjes finaciare realizon të ardhura të vogla me të cilat mezi i mbulon edhe shpenzimet elementare të familjes së tij.¹⁴⁷

4.11.2 Mospagimi i detyrimit ushqimor

Prindërit, në kujdesin ndaj fëmijëve, janë të detyruar edhe për sigurimin e ushqimit (alimentacionit) të tyre. Edhe sikur ndonjërit prind t'i jetë hequr kujdesi prindëror, ai nuk lirohet nga detyra për t'i mbajtur fëmijët e tij.¹⁴⁸ Në rastet kur prindërit shkurorezohen, ata kanë si detyrim ligjor që t'iu sigurojnë fëmijëve të mira materiale për jetesë, në formën e alimentacionit.

Bashkëshorti i ndarë ka të drejtë të kërkojë pagesën e ushqimit nga bashkëshorti tjetër, kur ai apo ajo kujdeset për fëmijën e përbashkët dhe për këtë shkak i vështirësohen kushtet për të punuar dhe krijuar vetë mjete materiale, pra, pengohet për të pasur një punësimin të rregullt.

Nga kjo rrjedh se ushqimi për fëmijën duhet të paguhet nga bashkëshorti i ndarë, sepse prindi tjetër, që kujdeset për fëmijën e mitur, nuk mund të krijojë të ardhura, të cilat mund t'i kishte siguruar sikur të mos kishte marrë nën kujdesin e tij fëmijën e tyre të përbashkët. Në mbajtje përfshihen edhe shpenzimet e nevojshme të ushqimit.

Për plotësimin e kësaj nevoje të fëmijëve, të dy prindërit janë të detyruar të sigurojnë të mirat materiale për fëmijët, pavarësisht se janë apo nuk janë duke jetuar së bashku. Ky detyrim duhet të plotësohet në mënyrë të vazhdueshme, sepse mbetja e fëmijëve pa ushqim rrezikon jo vetëm shëndetin, por edhe ekzistencën biologjike apo jetën e tyre.¹⁴⁹ Në praktikën e zbatimit të vendimeve gjyqësore për pagesën e alimentacionit, ka disa raste kur ato nuk zbatohen, kurse në disa raste tjera ka vështirësi për zbatimin e tyre. Si shkak për moszbatimin prindërit obligues për pagesën e ushqimit paraqesin kushtet dhe gjendjen e tyre të rëndë materiale, papunësinë dhe varfërinë. Mos pagesa e alimentacionit

¹⁴⁶ Neni 330, paragrafi 2, i LFK-së.

¹⁴⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.745/15, datë 10.09.2015,

¹⁴⁸ Neni 293 i LFK-së

¹⁴⁹ Hamdi Podovorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011, f.178-179

nga ana e prindit jo vetëm cenon të drejtat e fëmijës, por ajo është edhe shkelje e dispozitave ligjore dhe e Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Këtë të drejtë fëmijës ia cenon prindi, që nuk e ka në përkujdesje fëmijën, pra, prindi që nuk jeton me të. Ja një shembull nga Gjykata e Shkallës së Parë, me vendimin e saj nr. 175/2011, të datës 20.06.2011, me të cilin ajo miratoi propozimin e të paditurës (nënës) dhe e detyroi të paditurin (babanë), që në emër të detyrimit ushqimor për fëmijët e mitur të paguante shumën prej 200 euro për çdo muaj. Babai kundërshtoi që ta paguante shumën prej 200 euro dhe ishte i gatshëm të paguante vetëm shumën prej 130 euro.

KAPITULLI V: I. PASOJAT JURIDIKE JOPASUORE

Aspekti Krahassimor Kosovë - Shqipëri

5.1. Pasojat juridike jopasurore për bashkëshortët

Me shkurrëzimin e martesës, për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët bashkëshortore, vijnë edhe një varg pasojash juridike, të cilat mund të jenë pasoja të natyrës juridike personale dhe pasoja të natyrës pasurore. Pasojat juridike jopasurore, që rrjedhin nga ky shkak, mund t'i ndajmë në dy grupe themelore:

- a) pasojat juridike për bashkëshortët
- b) pasojat juridike për fëmijët.

Pas zgjidhjes së martesës, detyrimet personale që ekzistonin ndërmjet bashkëshortëve nuk ekzistojnë më në të ardhmen, gjë që do të thotë se bashkëshortët nuk i detyrohen njëri tjetrit, nuk kanë jetesë të përbashkët, as mbështetje, as ruajtje të besnikërisë bashkëshortore etj. Ne do të trajtojmë vetëm ato pasoja, që janë si më të rëndësishme dhe nga më problematikat në praktikë.

5.1.1. Statusi martesor pas zgjidhjes së martesës

Me zgjidhjen e martesës, shuhet edhe statusi martesor i bashkëshortëve për të ardhmen. Pas datës, kur vendimi mbi zgjidhjen e martesës merr formën e prerë, ish-bashkëshortët nuk gëzojnë më statusin si të martuar dhe secili prej ish-bashkëshortëve gëzon statusin e personit të shkurrëzuar.

5.2 Mbiemri

Bashkëshortët, me rastin e lidhjes së martesës, kanë të drejtë të vendosin lidhur me mbiemrin që do të mbajnë pas lidhjes së kurrës. Bashkëshortët, me rastin e lidhjes së martesës, mund të pajtohen që të marrin si mbiemër të përbashkët mbiemrin e njërit prej bashkëshortëve apo që secili të mbajë mbiemrin, që ka pasur para lidhjes së martesës, apo t'i shtojë mbiemrit të vet mbiemrin e bashkëshortit.¹⁵⁰

¹⁵⁰ Nuk lejohet shtimi i mbiemrit të bashkëshortit mbiemrit të vet nëse mbiemri është veçse i përbërë prej dy mbiemrave

Me rastin e zgjidhjes së martesës, bashkëshorti, i cili ka marrë mbiemrin e bashkëshortit tjetër, mund të marrë përsëri mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës.

Deklarata për kthimin e mbiemrit duhet të jepet brenda afatit prej gjashtë muajsh pas zgjidhjes së martesës. Deklarata jepet para nëpunësit të gjendjes civile (ofiqarit), ku mbahet regjistri amë i të martuarve, brenda gjashtë muajve pas zgjidhjes së martesës.

Megjithatë, ka edhe disa vende, ku me zgjidhjen e martesës, bashkëshorti, i cili e ka ndryshuar mbiemrin, merr automatikisht mbiemrin e tij të pare dhe kjo ndodh me dërgimin e vendimit të gjykatës në zyrën e gjendjes civile. Ky rregull ka edhe përjashtime, në rastet kur ndryshimi i mbiemrit cenon interesat e fëmijëve dhe të bashkëshortit.

Për të lejuar përdorimin e mbiemrit të marrë me lidhjen e martesës, gjykatës duhet t'i paraqitet kërkesë nga bashkëshorti, i cili i tregon arsyet përse kërkon të mbajë të njëjtin mbiemër, siç u tha edhe më lart, duke e lidhur kërkesën me interesin e tij apo të fëmijëve.¹⁵¹ Për sa i përket mbiemrit të fëmijëve, prindërit e caktojnë mbiemrin fëmijës me marrëveshje. Fëmija mund të marrë mbiemrin e njërit prind apo të të dy prindërve. Prindërit, fëmijëve të përbashkët, nuk mund t'u caktojnë mbiemra të ndryshëm. Në rastet kur prindërit nuk mund të pajtohen lidhur me caktimin e mbiemrit të fëmijës, mbiemrin e përcakton në pajtim me ligjin Organi i Kujdestarisë, i cili cakton mbiemrin e njërit apo të dy prindërve, pasi t'i dëgjojë të dy prindërit.

Në rastet kur njëri prind nuk jeton më apo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtat prindërore, apo është i panjohur, mbiemrin e fëmijës e cakton prindi tjetër. Nëse prindërit e fëmijës nuk janë gjallë apo nuk janë të aftë të ushtrojnë të drejtat prindërore, apo janë të panjohur, mbiemrin e fëmijës e cakton Organi i Kujdestarisë. Rastet e ndryshimit të mbiemrit të fëmijëve qoftë gjatë ekzistimit të martesës apo pas zgjidhjes së saj rregullohen me ligj të veçantë.¹⁵²

5.2.1 Raste nga praktika gjyqësore

Gjatë hulumtimit të rasteve praktike lidhur me mbiemrin e bashkëshortëve, ne kemi analizuar në këtë studim njëzet raste, nga të cilat 13 raste nga ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe 7 raste nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duke paraqitur disa nga veçori

¹⁵¹ Mandro, Arta, E Drejta Familjare, Tiranë 2009, f. 75

¹⁵² Ligji për emrin Personal i Kosovës, nr. 02/L-118

personale të paditësve, siç janë: rastet e fillimit të procedurës nga burri apo gruaja, fillimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, caktimi i fëmijëve nën kujdesin e babait apo të nënës, si dhe ruajtja apo kthimi i mbiemrit.

Tabela 6. Fillimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, besimi i fëmijëve, si dhe ruajtja apo kthimi i mbiemrit

Me Padi-Paditës		Propozim i përbashkët	Kujdestaria ndaj fëmijëve		Kthimi i mbiemrit të vajzërisë	Ruajtja e mbiemrit të Mëparshëm
Burri	Gruaja		Babait	Nënës		
7	3	10	6	14	7	13

Nga studimi i 20 rasteve, që janë analizuar dhe studiuar, bie në sy se në këto çështje, 10 prej tyre kanë filluar me paraqitjen e padisë dhe po 10 çështje të tjera kanë filluar me propozim të përbashkët. Në 7 rastet e filluara me padi, si palë paditëse është paraqitur burri, ndërsa gruaja është paraqitur në 3 raste. Nga tabela shihet se për sa i përket caktimit të kujdestarisë ndaj fëmijëve, nga 20 rastet e analizuara, në 6 raste fëmijët i janë besuar në ruajtje, për kujdes dhe edukim babait, ndërsa në 14 raste nënës. Për sa i përket mbiemrit, nga 20 rastet e analizuara, në 7 raste gruaja ka kërkuar që t'i kthehet mbiemri i vajzërisë apo mbiemri i mëparshëm, ndërsa në 13 raste gruaja e ka ruajtur mbiemrin që ka pasur gjatë martesës.

5.3. E drejta e lidhjes serish të martesës

Zgjidhja e martesës e shuan marrëdhënien martesore ndërmjet bashkëshortëve për të ardhmen dhe për rrjedhojë, shuan edhe të drejtat dhe detyrimet që buronin nga kjo

marrëdhënie.¹⁵³ Pas zgjidhjes së martesës, bashkëshortët kanë të drejtë të lidhin martesë të re, që do të thotë se mund të vendosin të lidhin martesë edhe me të njëjtin bashkëshort të mëparshëm. Por edhe në këtë rast ata janë të detyruar të respektojnë të gjitha procedurat e nevojshme për lidhjen e një martese të rregullt, që do të thotë zbatim i atyre procedurave si në rastin kur ata persona lidhën martesë për herë të parë.

5.4. Pasojat që rrjedhin nga statusi martesor edhe pas zgjidhjes së martesës

Edhe pse statusi i bashkëshortit të ndarë përfundon për të ardhmen, nga ky status disa pasoja do të jenë të vazhdueshme. Me zgjidhjen e martesës nuk hiqen ato pengesa, që ndalojnë lidhjen e martesës midis vjehrrit dhe nuses, vjehrrës dhe dhëndrit, njerks dhe thjeshtit apo njerkut dhe thjeshtres. Megjithatë, për shkaqe të arsyeshme, gjykata kompetente mund të lejojë lidhjen e martesës midis personave në gjirin e krushqisë, pasi të ketë marrë mendimin e Organit të Kujdestarisë.¹⁵⁴

5.4.1 Zotësia për të vepruar e fituar me martesë

Siç dihet, si kusht për lidhjen e martesës është edhe aftësia e bashkëshortëve për të vepruar. Aftësia për të vepruar fitohet me arritjen e moshës madhore, e cila arrihet në moshën 18 vjeçare. Megjithatë, aftësia për të vepruar fitohet edhe para arritjes së kësaj moshe me anën e lidhjes së martesës.¹⁵⁵ Kjo do të thotë se mundësia e lidhjes së martesës ekziston edhe para moshës 18 vjeçare dhe me këtë rast i mituri fiton zotësi të plotë për të vepruar që nga data e lidhjes së martesës. Nëse martesa e lidhur në këto kushte zgjidhet para se bashkëshorti të ketë arritur moshën madhore, aftësia për të vepruar, edhe pse e fituar me rastin e martesës, nuk humbet.

5.5. Pasojat juridike të zgjidhjes së martesës për fëmijët e përbashkët

Pasoja kryesore dhe më e madhe, që shkaktohet me rastin e zgjidhjes apo anulimit të martesës, është se fëmijët e përbashkët e humbin mundësinë që të jetojnë me të dy prindërit. Gjykata, sipas detyrës zyrtare (*ex officio*), ka për detyrë që, kur të vendosë për

¹⁵³ Omari, Sonila, E Drejta Familjare, Tiranë 2012, f. 225

¹⁵⁴ Neni 23 i LFK-së

¹⁵⁵ Po aty, Neni 15

zgjidhjen apo anulimin e martesës, nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, duhet të vendosë edhe se cilit prind i besohet ruajtja dhe mbajtja e fëmijëve, si edhe për çështjen e kontakteve personale të fëmijëve me prindin, të cilit nuk i është besuar ruajtja dhe mbajtja e fëmijëve. Lidhur me çështjen e ruajtjes dhe mbajtjes së fëmijëve prindërit mund të merren vesh vetë me njëri tjetrin, ndërsa gjykata duhet të vlerësojë nëse kjo marrëveshje është apo nuk është në interes të fëmijëve dhe pas këtij vlerësimi, gjykata mund ta miratojë në tërësi marrëveshjen, mund ta ndryshojë apo ta harmonizojë në interes të fëmijëve, apo mund edhe ta refuzojë në tërësi.

Një nga pasojat më të rënda të shkurorëzimit është çështja e realizimit të të drejtave prindërore pas shkurorëzimit apo pas anulimit të martesës. Kjo vjen për shkak se bashkëshortët tani nuk jetojnë më bashkë dhe për pasojë ata nuk mundën që t'i realizojnë të drejtat prindërore ndaj fëmijëve bashkërisht dhe në tërësi. Nga një situatë e tillë dalin disa pyetje, nga përgjigjet e të cilave varet fati i mëtejshëm i fëmijëve. Adresimi i këtyre pyetjeve ka rëndësi të veçantë, po që se kemi parasysh faktin se numri i rasteve të shkurorëzimeve me fëmijë, është në rritje e sipër nga viti në vit. Pyetjet kryesore, që lidhen me pasojën e zgjidhjes së martesës, janë si vijon: çështja e kujdestarisë ndaj fëmijëve, mbajtja e kontakteve personale të fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar fëmija, si dhe mbajtja e fëmijës nga ana e prindit.¹⁵⁶

5.5.1. Kujdestaria e fëmijëve në rastin e shkurorëzimit

Gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit, në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, shqyrton njëkohësisht edhe çështjen se kujt do t'ia besojë fëmijët dhe kjo gjë duhet të vendoset me aktgjykimin me të cilin vendoset edhe zgjidhja e martesës. Në rast se prindërit nuk merren vesh se kujt i duhen besuar fëmijët, atëherë gjykata ka për detyrë të vendosë zyrtarisht se cilit nga prindërit i duhen besuar fëmijët.

Gjykata, para së të marrë vendimin se cilit nga prindërit i duhen besuar fëmijët, duhet të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë. Organi i Kujdestarisë shqyrton të gjitha rrethanat, që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik, si edhe për edukimin e drejtë të fëmijës, siç janë: nevojat emocionale të fëmijëve, dëshira e fëmijës nëse i ka mbushur dhjetë vjet, mosha e fëmijës, gjendjen shëndetësore të fëmijës dhe të prindit, si edhe vetitë e ndryshme të prindërve.¹⁵⁷

¹⁵⁶ Janjić – Komar, Marina, Porodicni pravo, Beograd, 1999, f. 178.

¹⁵⁷ Oruçi, Gani, vepër e cituar, f. 107.

Prindërit kanë detyrim ligjor të sigurojnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për shëndetin, edukimin, arsimimin dhe për aftësimin e tyre për punë të pavarur derisa të mbushin moshën madhore, ndërsa në kushte të përcaktuara ligjore edhe pas moshës madhore (deri në moshën 26 vjeç nëse vazhdojnë shkollimin).¹⁵⁸

Ligji i Kosovës për Familjen në Nenin 140 përcakton vendimet që merr gjykata në rastet kur është në shqyrtim ushtrimi i të drejtave dhe detyrave prindërore. Në këtë drejtim përcaktohet se, në rastet kur gjykata kompetente e kontestit martesor merr aktgjykimin, me të cilin zgjidhet apo anulohet martesa, ajo, me të njëjtin aktgjykim vendos edhe për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur.

Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për rastin e përmendur më sipër ose nëse marrëveshja e tyre nuk iu përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata, pasi të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetojë të gjitha rrethanat, do të vendosë ose që të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim te njëri prind, ose që disa të mbesin te nëna, kurse disa tek babai, ose të gjithë apo disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi tjetër. Gjithashtu, nëse prindi, që ushtron kujdesin prindëror, pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, atëherë gjykata do të rregullojë me aktgjykim edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin, që nuk ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës. Gjkata, me kërkesën e njërit prind ose të Organit të Kujdestarisë, ndryshon edhe vendimin mbi kujdestarinë, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Gjithsesi, mendimi i fëmijës, që është i aftë të shprehë pikëpamjet e tij, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që lidhet me të, ndërkohë mendimit të tij i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Presumohet se është më mirë për fëmijët që të jetojnë me prindërit e tyre natyror, me përjashtim kur mirëqenia e fëmijëve kërkon ndryshe.¹⁵⁹

Në të gjitha procedurat e përmendura më lart, gjykata duhet të ketë në konsideratë parësore interesin më të mirë të të miturit, i cili gjen zbatim edhe përmes zgjidhjes së shpejtë e pa vonesa të këtyre problemeve, pa zvarritje nga ana e gjykatës.

¹⁵⁸ Neni 290, paragrafi 1 dhe 2, i LFK-së.

¹⁵⁹ Arta Mandro, vep. e cituar, fq.334.

Kjo do të thotë që gjykata duhet të vendosë brenda një afati optimal në rastet e një vendimi mbi arsimimin, përgjegjësinë prindërore, përkujdesjen, kontaktet me prindin, kujdestarinë, masat urgjente, që duhen marrë etj. Kjo mund të arrihet përmes shqyrtimit të rastit jo vetëm profesionalisht, por edhe brenda një kohe sa më të shkurtër.

Në rastet e konflikteve ose mosmarrëveshjeve familjare, kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore konsiderohet edhe si një shkelje e Nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse respektimi efektiv i jetës familjare kërkon që marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet prindërve dhe fëmijës të përcaktohen jo duke kapërcyer afatet kohore, pasi kjo do të çonte në një zgjidhje të çështjes *de facto* përpara asaj *de jure*.

5.5.2 Dhënia e fëmijës te njëri prind

Edhe pas zgjidhjes së martesës me shkurorëzim fëmijët e ruajnë statusin e fëmijëve martesor.¹⁶⁰ Konsiderohet se fëmija ka lindur në martesë, nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës. Po ashtu konsiderohet fëmijë martesor edhe fëmija që ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes apo anulimit të martesës.¹⁶¹

Fëmijët e ruajnë statusin e fëmijëve martesorë edhe pas zgjidhjes së martesës së prindërve të tyre, qoftë me shkurorëzim apo me anulim. Fëmija konsiderohet i lindur nga martesa, nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës (Neni 100 i LFK-së). Fëmijë nga martesa konsiderohet edhe fëmija që ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës. Me dispozitën e Nenit 140 të LFK-së, paragrafi 1, përcaktohet se: kur gjykata kompetente në kontestet martesore merr aktgjykimin, me të cilin zgjidhet ose anulohet martesa, ajo, po me atë aktgjykim gjykata do të vendosë edhe për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. Ky përcaktim ligjor paraqet një detyrim për gjykatën, e cila në rastin vendosjes në procedurën e shkurorëzimit të bashkëshortëve *ex officio* me vendimin e njëjtë vendos edhe për kujdestarinë ndaj fëmijëve. Ky detyrim i gjykatës duhet të përmbushet nga ana e saj pavarësisht nëse ka apo nuk ka kërkesë për këtë gjë nga ana e bashkëshortëve.

Kjo procedurë e vendosjes për kujdestarinë e fëmijëve vlen edhe në rastet e shkurorëzimit të martesës, edhe në rastet e anulimit të martesës, sepse pavarësisht se martesa zgjidhet apo anulohet, fëmijët konsiderohen fëmijë martesorë.

¹⁶⁰ Abdullah Aliu & Haxhi Gashi, vepër e cituar, fq.183.

¹⁶¹ Neni 100 dhe 101 i LFK-së

Nga Neni 140 i LFK-së, paragrafi 2, rrjedh së bashkëshortët, në procedurën e shkurorezimit, mund të merren vesh për kujdestarinë ndaj fëmijëve, por gjykata duhet të ketë vëmendjen e duhur për të parë nëse marrëveshja e prindërve është në interes të fëmijëve, pasi, në të kundërtën, ajo nuk duhet ta pranojë marrëveshjen e prindërve për kujdestarinë ndaj fëmijëve. Në raste të tilla, gjykata duhet të marrë mendimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetojë të gjitha rrethanat dhe pastaj të vendosë se kujt duhet t'i besohen fëmijët. Ekziston edhe mundësia që të gjithë fëmijët të mos i besohen vetëm njërit nga prindërit, por disa prej tyre t'i besohen njërit e disa tjetrit, por në praktikën gjyqësore janë të rralla rastet, kur gjykatat vendosin t'i ndajnë fëmijët, me përjashtim të rasteve kur gjykata vlerëson së është në interesin e fëmijëve që disa t'i besohen njërit prind dhe disa prindit tjetër, pasi të hetojë të gjitha rrethanat e rastit konkret. Mirëpo në praktikën gjyqësore janë raste të rralla kur gjykatat vendosin ti ndajnë fëmijët, përveç kur gjykata vlerëson së është në interesin e fëmijëve që disa ti besohen njëri prind e disa prindit tjetër, pasi ti hetojë të gjitha rrethanat për rastin konkret.¹⁶²

Mundësia e ndryshimit të vendimit mbi kujdestarinë ndaj fëmijëve ekziston me kërkesën e njërit prind apo të Organit të Kujdestarisë, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Në praktikë, ka raste, kur kërkohet të ndryshohet vendimi për kujdestarinë ndaj fëmijëve për shkak të ndryshimit të rrethanave dhe në raste të tilla, në qoftë se si rezultat i ndryshimit të rrethanave ka ndryshuar edhe interesi i fëmijëve, gjykata do ta ndryshojë edhe vendimin për kujdestarinë ndaj fëmijëve. Mirëpo në këto raste në praktikë vetëm nëse rrethanat janë të atilla që e bëjnë të domosdoshme dhe janë në interes të rritjes dhe edukimit të fëmijës, atëherë gjykata e aprovon një ndryshim të tillë. Në të kundërtën gjykata nëse nuk ka ndryshim të rrethanave dhe të cilat nuk janë në interes të fëmijës e refuzon një kërkesë të tillë.¹⁶³

Në të gjitha këto raste, si për marrjen e vendimit lidhur me kujdestarinë ndaj fëmijëve edhe për ndryshimin e vendimit për shkak të rrethanave, është specifikuar me ligj se duhet të merret parasysh mendimi i fëmijës, i cili është i aftë të shprehë pikëpamjet e tij. Pra, fëmija duhet të pyetet në çdo rrethanë, në çdo procedurë që i përket atij dhe pavarësisht nga mosha që ka apo nga pjekuria e tij psikofizike, deklaratës së tij duhet t'i jepet pesha e duhur.¹⁶⁴ Marrja e mendimit të fëmijës, se me cilin prind dëshiron të jetojë,

¹⁶² Shih: Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.254/16, i datës 29.06.2016, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr.3053/16.

¹⁶³ Shih: Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1181/13, i datës 10.09.2015,

¹⁶⁴ LFK, Neni 140, paragrafi 5.

ka shumë rëndësi për shkak se lidhja e tij emocionale me njërin prind ndikon edhe në mirërritjen dhe rehatinë e tij shpirtërore, kurse me prindin tjetër duhet t'i lejohet mënyra e kontaktit.

5.5.3. Kujdestaria ndaj fëmijës te një personi tretë

LFK-ja parashikon dy mundësi se kur mund t'i besohet fëmija një personi të tretë. Ajo parashikon:

- kujdestarinë e përkohshme të fëmijës te personi i tretë dhe
- kujdestarinë e fëmijës te njëri prind apo te një person i tretë

LFK-ja, me dispozitat e Nenit 142, ka rregulluar mundësinë e kujdestarisë së përkohshme të fëmijës nga prindërit te pala e tretë, ndërsa me dispozitat e Nenit 143 ka rregulluar mundësinë e kujdestarisë ndaj fëmijës te prindërit apo te personi i tretë.

Kështu, me dispozitën e Nenit 142, paragrafi 1, parashihet se: kur e kërkojnë interesat e fëmijës, prindi ose prindërit mundën përkohësisht t'ia besojnë fëmijën palës së tretë për përkujdesje dhe edukim, nëse ky person i plotëson kushtet e kujdestarit, ndërsa në paragrafin 2, parashihet se: nëse prindërit ose prindi, i cili e ushtron kujdesin prindëror, shkojnë përkohësisht në një vend tjetër banimi, brenda apo jashtë Kosovës, ata ose ai mund t'ia besojnë fëmijën për kujdes dhe edukim vetëm personit, i cili i plotëson kushtet e kujdestarit. Presumohet se është më mirë për fëmijët që të jetojnë me prindërit e tyre natyror, me përjashtim kur mirëqenia e fëmijëve kërkon ndryshe.¹⁶⁵

Sipas dispozitës së cituar (paragrafi 1), rrjedh se prindërit gëzojnë të drejtën e që ata vetë t'ia besojnë përkohësisht fëmijën një personi të tretë, por më kusht që këtë besim të përkohshëm të fëmijës ta kërkojnë interesat e fëmijës dhe personi, të cilit i besohet përkohësisht fëmija, të plotësojë kushtet e kujdestarit dhe ky besim i jepet atij përkohësisht.

Qëllimi i kësaj dispozite është që fëmija të përfitojë një kujdes më të mirë gjatë periudhës së kujdesit të përkohshëm nga personi i tretë. Vetëm në këtë mënyrë mund të justifikohet qëllimi i dispozitës sipas interesit të fëmijës. Pra, ky besim jepet nga vetë prindërit apo nga njëri prind dhe për këtë nuk kërkohet marrja e ndonjë vendimi nga gjykata apo Organi i Kujdestarisë.

Në raste të tilla ka shumë rëndësi që besimi i dhënë të jetë në interes të fëmijës së mitur dhe kjo ndodh në rastet kur fëmija duhet të fitojë njohuri apo shprehë të reja, apo kur

¹⁶⁵ Arta Mandro, vepra e cituar, faqe 334

duhet evituar ndonjë sjellje e papëlqyeshme. Megjithatë, edhe në rastet kur të dy prindërit janë në marrëdhënie pune, caktimi i një kujdestari të përkohshëm, me qëllim që fëmija të mos qëndrojë vetëm në shtëpi, është në interes të fëmijës. Personi, të cilit i besohet përkohësisht fëmija, duhet të plotësojë kushtet e kujdestarit, të cilat LFK i ka përcaktuar me dispozitat e Nenit 236. Sipas dispozitës së Nenit 236 të LFK-së, paragrafi 1, parashikohet se: “si kujdestar mund të jetë çdo person që ka cilësitë dhe aftësitë personale të nevojshme për përmbushjen e detyrave të kujdestarit dhe jep pëlqimin që më parë për t’u bërë kujdestar.” Ligji parashikon edhe mundësinë e dhënies së kujdestarisë ndaj fëmijëve te personi i tretë edhe në rastet kur prindërit shkojnë me banim jashtë vendit për arsye të ndryshme, si edhe kur kanë ndonjë angazhim jashtë vendit për punë të përkohshme, për pushime etj. Kjo gjë i detyron prindërit, që fëmijën t’ia besojnë një personi të tretë për përkujdesje. Kjo do të thotë se pas kthimit të prindërve në vendbanimin e përhershëm edhe fëmija duhet të kthehet te prindërit. Megjithatë, edhe në këto raste, personi i tretë, të cilit i besohet fëmija për përkujdesje, duhet të plotësojë kushtet e kujdestarit.

Lidhur me dhënin e kujdestarisë për fëmijën te prindërit apo te personi i tretë, LFK, me dispozitën e Nenit 143, paragrafi 1, parashikon se: në rast të vdekjes së prindit, që ka ushtruar vetë kujdesin prindëror sipas vendimit të gjykatës ose vendimit të Organit të Kujdestarisë, ose sipas marrëveshjes me prindin tjetër, si edhe në rastin kur ai prind e humb aftësinë për të vepruar ose e braktis fëmijën, prindi tjetër ka të drejtë të kërkojë që personi, ku ndodhet fëmijë, t’ia dorëzojë fëmijën për ruajtje dhe edukim. Me paragrafin 2 të Nenit 143 parashikohet se: në rast të kontestit ndërmjet prindërve dhe personit të tretë, gjykata kompetente mund të vendosë që fëmija t’i besohet për ruajtje dhe edukim personit te i cili ndodhet fëmija, ndonjë personi ose institucioni tjetër, nëse në bazë të mendimit dhe propozimit të marrë nga Organi i Kujdestarisë, pasi të hetohen të gjitha rrethanat, konstatohet se një gjë të tillë e kërkojnë interesat e fëmijës. Vdekja e njërit prind, ku ndodhet fëmija nën kujdes, i jep të drejtë prindit tjetër të kërkojë kujdesin ndaj fëmijës dhe kjo gjë parashikohet me ligj, ndaj fëmija mund t’i besohet prindit tjetër.

Në rastin kur prindi, të cilit i është besuar fëmija, e humb aftësinë e veprimit të prindit kujdestar, prindi tjetër ka të drejtën që të kërkojë që fëmija t’i besohet atij. Humbja e aftësisë së veprimit të një personi e bën të pamundur atë person të ushtrojë në mënyrë të pavarur të drejtat dhe detyrat në emër dhe për llogari të vet. Si rrjedhojë, kjo mungesë

reflektohet edhe të përkujdesja ndaj fëmijës, sepse personi që ka humbur aftësinë e veprimit nuk mund ta ushtrojë dot kujdesin ndaj fëmijës.¹⁶⁶

Një situatë tjetër është braktisja e fëmijës nga prindi kujdestar, e cila krijon një rrethanë, kur prindi tjetër të kërkojë t'i besohet fëmija që ka mbetur pa përkujdesje.

Në raste të caktuara ekziston edhe mundësia e kontestit në mes të prindërve dhe personit të tretë. Një kontest i tillë supozohet se ekziston gjithmonë lidhur me përkujdesjen, mbajtjen, edukimin dhe shkollimin e fëmijës. Në raste të tilla, për të vendosur se ku do të mbetet fëmija për përkujdesje, te personi, ku ai gjendet, te ndonjë person tjetër apo në ndonjë institucion për përkujdesjen e fëmijëve, nevojitet vendimi i gjykatës.¹⁶⁷ Në të gjitha kontestet familjare e sidomos në ato ku përfshihen fëmijët dhe interesi i tyre ftohet për të dhënë mendimin edhe Organi i Kujdestarisë.

Në këto raste, sipas dispozitave cituara më lart, përveç mendimit të Organit të Kujdestarisë, gjykata, gjatë procedurës së vendosjes, duhet të shqyrtojë të gjitha provat e nevojshme për të mbrojtur interesat e fëmijëve dhe për të vendosur se ku do të mbetet fëmija. Rrethana që duhet të merren në shqyrtim nga ana e gjykatës duhet të jenë rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik të fëmijëve, si edhe për edukimin e tyre.¹⁶⁸ Në rast se fëmija është mbi moshën 10 vjeç, gjykata duhet të marrë parasysh posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës. Nëse e mendon të rëndësishme, gjykata mund të marrë parasysh edhe mendimin e ekspertëve.¹⁶⁹

5.5.4 Roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën e dhënies së kujdestarisë për fëmijën

LFK, me dispozitat e Nenit 6 ka përcaktuar mbrojtjen institucionale të të drejtave të fëmijëve nga Organi i Kujdestarisë. Neni 6 i LFK-së, paragrafi 1, përcakton se kompetencat e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t'i ushtrojë organi kompetent i administratës komunale, i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale. Në paragrafin 4 të Nenit 6 të LFK-së, parashikohet se Organi i Kujdestarisë, pjesëmarrës në procedurë, është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë edhe administrimin e provave të

¹⁶⁶ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, vepër e cituar, f. 334.

¹⁶⁷ Po aty, f. 335.

¹⁶⁸ Neni 144 paragrafi 1 i LFK-së.

¹⁶⁹ Neni 144 paragrafi 2 i LFK-së.

domosdoshme, të përdorë mjetet juridike dhe të ndërmarrë veprime të tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar ta ftojë në gjykatë Organin e Kujdestarisë si pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet. Sipas këtyre dispozitave rezulton se pjesëmarrja e Organit të Kujdestarisë në procedurat gjyqësore, ku përfshihen fëmijët, është e domosdoshme.

Organi i Kujdestarisë luan një rol të rëndësishëm si për ndihmën ashtu edhe për këshillimin e gjykatës, gjatë procedurës gjyqësore dhe në veçanti, në kontestet lidhur me zgjidhjen e martesës dhe dhënien e kujdestarisë ndaj fëmijëve. Organi i Kujdestarisë, si organ i specializuar, ka përgjegjësi dhe të drejtë të ndërmarrë veprime procedurale, që kanë të bëjnë me paraqitjen e fakteve dhe provave, të cilat nuk janë paraqitur në seancë gjyqësore dhe të përdorë mjetet juridike (padi, ankesë ose mjetet e jashtëzakonshme) për të mbrojtur interesat e fëmijëve në të gjitha procedurat gjyqësore.¹⁷⁰

Roli i Organit të Kujdestarisë, në procedurën e dhënies së kujdestarisë për fëmijët, përcaktohet edhe në mënyrë specifike, pasi me dispozitën e Nenit 144, paragrafi 1, parashikohet se Gjykata ose Organi i Kujdestarisë, i cili merr vendim mbi dhënien e kujdestarisë së fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që t'i hetojë në mënyrë të përshtatshme të gjitha rrethanat, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik, si edhe për edukimin e fëmijës. Pra, në këtë rast, këtij organi i është dhënë me ligj një përgjegjësi e rëndësishme për dhënien e kujdestarisë për fëmijët, ndaj edhe roli i tij është me rëndësi vendimtare, sepse gjykata do t'i hetojë përmes këtij organi një varg rrethanash dhe për rrjedhojë, edhe vendimi i gjykatës mbi dhënien e kujdestarisë për fëmijët do të varet në një masë të madhe nga rrethanat e hetuara prej këtij organi.

Në procedurën e dhënies së kujdestarisë së fëmijës te njëri prind ose te personi i tretë, roli i Organit të Kujdestarisë është tejet i rëndësishëm, sepse me dispozitën e Nenit 143 të LFK-së, paragrafi 2, parashikohet që, në rast kontesti ndërmjet prindërve dhe personit të tretë, gjykata kompetente mund të vendos që fëmija t'i besohet për ruajtje dhe edukim personit të cili ndodhet fëmija, ndonjë personi ose institucioni tjetër, në bazë të mendimit dhe propozimit të marrë nga Organi i Kujdestarisë, që pasi t'i hetojë të gjitha

¹⁷⁰ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, vepër e cituar, f. 37.

rrethanat, konstaton se interesat e fëmijës e kërkojnë një gjë të tillë. Nga kjo rezulton se, në një procedurë të tillë, mendimi profesional i Organit të Kujdestarisë është i domosdoshëm dhe me rëndësi esenciale për marrjen e vendimit nga gjykata.

Me rastin e vendosjes për zgjidhjen e martesës vendoset edhe për kujdestarinë ndaj fëmijëve. Në rastet kur prindërit jetojnë të ndarë, kujdesin prindëror e ushtron prindi me të cilin jeton fëmija, nëse me këtë pajtohet edhe prindi tjetër, kurse në rastet kur prindërit nuk merren vesh se me cilin prind do të jetojë fëmija, për këtë të drejtë vendos gjykata. Kur vendos për zgjidhjen e martesës, gjykata, siç u tha më sipër, vendos edhe për kujdestarinë ndaj fëmijëve, edukimin dhe ruajtjen e tyre dhe në këtë rast, të drejtën prindërore e ushtron prindi të cilit i është besuar fëmija. Prindërit mund të vendosin për kujdestarinë ndaj fëmijëve edhe me marrëveshje, por nëse marrëveshja e tyre është në kundërshtim me interesat e fëmijëve, atëherë gjykata merr mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë, heton të gjitha rrethanat dhe pastaj vendos që të gjithë fëmijët t'i besohen për ruajtje dhe edukim vetëm njërit prind apo disa prej tyre të mbesin te nëna dhe disa te babai, apo që të gjithë fëmijët ose vetëm disa t'i besohen personit të tretë.

Gjykata, me kërkesën e njërit prind apo të Organit të Kujdestarisë, e ndryshon vendimin mbi kujdestarinë ndaj fëmijëve, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Fëmija, që është i aftë të japë mendimin e tij, dëgjohej me kujdes nga gjykata në çdo procedurë që lidhet me interesat e tij. Mendimit të fëmijës do t'i jepet rëndësia e duhur në pajtim me moshën dhe aftësitë e tij për të kuptuar. Të dy prindërit vendosin me marrëveshje për çështjet thelbësore të zhvillimit të fëmijës, edhe në rastet kur të drejtën prindërore e ushtron vetëm njëri nga prindërit. Nëse prindi, i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore, nuk pajtohet me ndonjë masë apo veprim të prindit tjetër në ushtrimin e kujdesit prindëror në çështjet e rëndësishme, ai mund të informojë gjykatën kompetente dhe ajo është e obliguar të vendosë nëse masa apo veprimi është në favor të interesave të fëmijës. Kujdestaria e përkohshme ndaj fëmijës jepet në rastet kur e kërkojnë interesat e tij dhe kjo kujdestari i jepet edhe personit të tretë, nëse ky i plotëson kushtet e kujdestarit. Edhe në rastet kur prindi, që ushtron kujdesin prindëror, shkon për të banuar përkohësisht në ndonjë vend tjetër, brenda apo jashtë Kosovës, ai mund t'ia besojë kujdesin dhe edukimin vetëm personit, që i plotëson kushtet e kujdestarit.

Gjykata, në rastin e vendosjes për kujdestarinë ndaj fëmijëve, heton të gjitha rrethanat e përshtatshme, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik, si edhe për

edukimin e fëmijës. Në rastet kur fëmija ka moshën mbi dhjetë vjet, gjykata do të marrë parasysh nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës. Në rastet e nevojshme gjykata merr parasysh edhe mendimin e ekspertëve.

Gjykata mundet që *ex officio* të marrë vendim për kthimin e kujdesit prindëror, nëse vërteton se janë plotësuar kushtet për kthim. Kujdesi prindëror mundet të zgjatet edhe pas moshës madhore të fëmijës, nëse fëmija, për shkak të sëmundjes psikike, zhvillimit psikik të vonuar ose të të metave fizike, nuk është i aftë që të kujdeset për personalitetin e tij, për të drejtat dhe interesat e veta. Lidhur me zgjatjen e kujdesit prindëror gjykata vendos me procedurë jokontestimore, me kërkesën e prindit apo të Organit të Kujdestarisë. Propozimi bëhet përpara se fëmija të mbushë moshën madhore. Kur pushojnë shkaqet për zgjatjen e kujdesit prindëror, atëherë gjykata, me kërkesën e prindit apo të Organit të Kujdestarisë merr vendim për pushimin e kujdesit prindëror.

5.6. Kontaktet personale

Prindi të cilit nuk i besohen fëmijët për ruajtje dhe edukim e ruan të drejtën e kontakteve personale me fëmijët.¹⁷¹

Fëmijët kanë të drejtë të jetojnë dhe të rriten në familje me prindërit. Mbajtja e raporteve personale apo kontakti me fëmijët është detyrim ligjor i prindërve. Nga kjo rezulton se prindërit duhet të kenë kontakte me fëmijët, t'iu kushtojnë atyre kohën e duhur, qoftë për komunikim, qoftë për plotësimin e ndonjë kërkesë apo nevojë të fëmijës. Kjo mund të kuptohet me aspektin e krijimit të afërsisë prind-fëmijë dhe shijimin e ndjenjës emocionale që ka fëmija ndaj prindit, gjë që ndikon pozitivisht në mirërritjen e tij, ndërsa detyrimi për mirërritjen e fëmijës mund të kuptohet si përkujdesje e prindërve, me qëllim që fëmija të ketë një rritje dhe zhvillim të shëndoshë, pa brenga. Në rastet kur prindërit nuk merren vesh lidhur me mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijët, atëherë kjo çështje vendoset me vendim nga ana e gjykatës. Kjo nënkupton edhe faktin se në rastet kur fëmijët jetojnë të ndarë nga të dy prindërit apo jetojnë vetëm me njërin prind, ata kanë të drejtë t'i kontaktojnë apo vizitojnë prindërit e tyre.

¹⁷¹ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, vepër e cituar, f. 303.

Gjykata, pas nxjerrjes së vendimit për zgjidhjen e martesës dhe së bashku me të, edhe të vendimit lidhur me dhënien e fëmijëve në ruajtje, kujdes dhe edukim, vendos edhe lidhur me kontaktin e fëmijëve me prindin tjetër, të cilit nuk i janë besuar fëmijët. Prindërit mund ta rregullojnë kontaktin me fëmijët edhe me marrëveshje dhe kjo gjë është e mundur edhe kur fëmija jeton te personi i tretë ose në një institucion. Në praktikë, në shumë raste, gjykata e ka pranuar marrëveshjen e prindërve edhe në lidhje me përkujdesjen ndaj fëmijëve, edhe në rastin e mbajtjes së kontakteve personale me ta.

Kur nuk arrihet kjo marrëveshje, gjykata vendos me aktgjykim dhe kështu e rregullon mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin, i cili nuk ushtron kujdesin prindëror. Vendimi i gjykatës gjen shprehje edhe në rastet kur ekziston marrëveshja e prindërve lidhur me kujdestarinë ndaj fëmijëve, si edhe për mbajtjen e kontakteve personale me ta, kur kjo marrëveshje nuk është në interes të fëmijëve. Në këto raste, gjykata e specifikon me vendim mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindit me fëmijën me të cilin nuk jeton.

Në paragrafin 3 të Nenit 140 të LFK-së, është rregulluar mënyra e caktimit të kontaktit si vijon: nëse prindi, i cili ushtron kujdesin prindëror, pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata do të rregullojë me aktgjykim edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës.

Pra, në rastet kur pengohen kontaktet e fëmijës me prindin, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, atëherë gjykata do të vendosë me aktgjykim edhe për kontaktin e fëmijës me atë prind. Në praktikë, vendosja e kontaktit të fëmijës me prindin, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, është pothuajse pjesë e çdo aktgjykimi me të cilin vendoset shkurtorëzimi i bashkëshortëve, si edhe kujdestaria ndaj fëmijëve, kur rastet në gjykatë kanë filluar me padi, ndërsa në rastet me propozim të përbashkët, gjykatat, në shumë raste, nuk vendosin për kontaktet e fëmijës me prindin që nuk e ushtron kujdesin prindëror, sepse këto kontakte nuk pengohen nga prindi që ushtron kujdesin prindëror.

Në praktikë ekzistojnë edhe raste, kur fëmijët, të cilët janë të aftë për të gjykuar, dëgjojnë nga gjykata përpara se ajo të marrë vendim, ku pasqyrohet edhe mendimi i tyre lidhur me zgjedhjen e kujdestarisë, por fëmijët mund të deklarojnë edhe nëse nuk dëshirojnë të kenë fare kontakte me prindin tjetër, me të cilin nuk jetojnë. Kjo zakonisht ndodh në rastet kur jeta faktike në mes bashkëshortëve është ndërprerë dhe fëmijët janë të ndikuar nga prindi tjetër apo edhe familjarët e tjerë të tij. Edhe në këto raste, është gjykata ajo që vendos për kontaktet e fëmijëve me prindin tjetër, me të cilin nuk jetojnë, edhe nëse prindi, të cilit i janë besuar fëmijët apo vetë fëmijët e kundërshtojnë një gjë të tillë. Ajo vendos kështu, kur sheh se kontaktet me prindin tjetër, pavarësisht se nuk jetojnë bashkërisht, janë në interes të fëmijëve, por kjo gjë është e nevojshme edhe për vetë prindin, të cilit nuk i janë besuar fëmijët, gjë që zvogëlon sado pak zbrazëtinë e jetës së ndarë në mes tyre.

Në disa legjislacione, përveç kontakteve dhe raporteve me prindin, të cilit nuk i është besuar fëmija, parashikohet edhe ruajtja e raporteve dhe marrëdhënieve me gjyshërit dhe personat tjerë me lidhje familjare. Këtu kanë një vend të veçantë gjyshërit, me të cilët fëmijët duhet të kenë një marrëdhënie vetjake.¹⁷² Nëse prindërit kanë mosmarrëveshje lidhur me mbajtjen e këtyre marrëdhënieve, atëherë organi kompetent që vendos është gjykata.¹⁷³ Kur fëmijët, para zgjidhjes së martesës, kanë qenë të lidhur ngushtë me gjyshin dhe gjyshen, mungesa e kontaktit me ta është një humbje, që përjetohet me dhimbje. Shpesh herë mbajtja e raporteve vetjake të fëmijëve me gjyshërit është e krahasueshme me atë të prindërve me fëmijët.¹⁷⁴

5.6.1 Mosrealizimi i të drejtës së kontaktit

Zgjidhja e martesës ndikon në humbjen e kontaktit apo takimeve të fëmijëve me prindërit dhe në këto raste kontaktet janë më të rralla. Rastet kanë treguar pas ndarjes së prindërve, fëmijët jetojnë vetëm me njërin prind dhe si rrjedhojë, edhe kontaktet e fëmijës me prindin tjetër janë më të rralla. Mungesa e kontaktit sjell konfuzion në gjendjen psikologjike të fëmijës.

¹⁷² Mandro, Arta, vepër e cituar, f. 443.

¹⁷³ KFSH, Neni 219.

¹⁷⁴ Mandro, Arta, vepër e cituar, f. 443.

Megjithëse e drejta e kontaktit ekziston me ligj, fëmijëve, në disa raste, kjo e drejtë iu cenohet qoftë nga ndikimi i prindit me të cilin jeton fëmija apo edhe për shkak të distancës së largët së vendit ku jeton prindi tjetër. Prindi, i cili ka në përkujdesje fëmijën, për shkak të mosmarrëveshjeve, që ekzistojnë edhe pas divorcit me ish-bashkëshortin, nuk e mundëson kontaktin me fëmijën duke u arsyetuar se gjoja vetë fëmija nuk dëshiron ta takojë prindin apo duke e kushtëzuar ish-bashkëshortin me përmbushjen e ndonjë kërkesë. Rasti kur prindi, me të cilin jeton fëmija, e pengon kontaktin e fëmijës, që ka në përkujdesje, me prindin tjetër, gjen shprehjen e vet në ligj, sepse edhe për këto raste ligji parashikon mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale.

Në praktikën gjyqësore ka raste edhe kur kontaktin e fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar gjykata e ka interpretuar në kuptimin më të gjerë, ashtu që si mënyrë të kontaktit të prindit me fëmijën e tij e ka konsideruar edhe bisedën përmes telefonit.¹⁷⁵

Në Nenin 145 të LFK-së, paragrafi 2, parashikohet se: Gjykata kompetente mund të rregullojë përsëri mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijët, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Kjo ndodh, pra, siç u tha edhe më lart, në rastet kur njëri prind pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër dhe pastaj, me kërkesën e prindit tjetër apo të Organit të Kujdestarisë, mund të ndryshohet edhe vendimi i mëparshëm lidhur me mbajtjen e kontakteve personale. Ndryshimi i vendimit lidhur me kontaktet personale gjen shprehje edhe në rastet e ndryshimit të rrethanave të prindit, të cilit i janë besuar fëmijët në përkujdesje, siç janë: vdekja, humbja e aftësisë për të vepruar, heqja e të drejtës prindërore, rrethana që ndikojnë në ndryshimin e vendimit të gjykatës lidhur me kujdestarinë ndaj fëmijëve, duke ia besuar fëmijën prindit tjetër apo personit të tretë, gjë që ndikon vetvetiu edhe në ndryshimin e vendimit lidhur me kontaktet personale, sepse përkujdesjen e fëmijëve tani e merr prindi që nuk e ka pasur atë më parë.

Shembull: Gjykata Themelore, me vendimin e saj nr. 57/13 të datës 30.01.2013, duke vendosur sipas kërkesës së prindit për përmbardimin e Aktgjykimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, kishte caktuar përmbardimin dhe detyroi ish-bashkëshorten që t'i mundësonte kontaktin me fëmijët, sipas datës së caktuar, në fund të javës së dytë dhe të katërt të muajit, duke filluar nga dita e shtunë në ora 10:00 e deri në ditën e diel në ora

¹⁷⁵ Svetislav Vuković, Komentar prodcinok zakona, Beograd, 2005. fq.59

18:00, ditën e dytë të festave të Bajramit dhe festës së Vitit të Ri, si dhe nga 7 ditë për kohën e pushimeve verore dhe dimërore. Ish-gruaja, për shkak të raporteve të acaruar me ish-burrin, ia pamundësonte këtij kontaktin me fëmijët. Babai u detyrua të ushtronte propozimin për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë me qëllim të realizimit të kontaktit me fëmijët e tij, kur, me vendimin e gjykatës, fëmijët i ishin besuar për ruajtje, kujdes dhe edukim, nënës, e cila e pengonte kontaktin e fëmijëve me babanë e tyre.

5.6.2 Mosdhënia e prokurës apo pëlqimit

Prindërit, edhe pas divorcit, kanë të drejta dhe detyrime ndaj fëmijëve. Fëmijët e mitur nuk mund t'i kryejnë disa veprime në mënyrë të pavarur, por ato duhet t'i kryejnë nëpërmjet prindërve të tyre, siç është rasti në nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit dhe udhëtimit, si edhe për udhëtimet jashtë vendit. Në këto raste kërkohet pëlqimi i të dy prindërve për nxjerrjen e pasaportës apo për udhëtime të fëmijës së mitur jashtë vendit. Prindi, që nuk e ka në përkujdesje fëmijën, ka refuzuar në disa raste të japë pëlqimin për nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit apo për dhënien e prokurës që fëmija i mitur të udhëtojë jashtë vendit me prindin, të cilit i është besuar në ruajtje. Në këto raste roli i QPS është i pashmangshëm, sepse prindërit paraqiten në këto Qendra dhe ato ndërmjetësojnë dhe mundësojnë që fëmija të pajiset me dokument të udhëtimit apo edhe të udhëtojë jashtë vendit për qëllime të ndryshme.

5.7 Rastet nga praktika gjyqësore

Gjatë punimit të këtij studimi janë marrë dhe analizuar tridhjetë raste nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke paraqitur disa nga veçoritë personale të paditësve, siç janë: rastet e fillimit të procedurës nga burri apo gruaja, fillimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, caktimi i kujdestarisë ndaj fëmijëve babait apo nënës, caktimi i detyrimit ushqimor për fëmijët e mitur, kontakti i fëmijëve me prindin, i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore, si edhe mosha e fëmijëve.

Tabela 7. Fillimi i procedurës me padi apo propozim të përbashkët, padia është paraqitur nga burri apo gruaja, kujdestaria ndaj fëmijëve, caktimi i detyrimit ushqimor, kontakti i fëmijës me prindin dhe mosha e fëmijëve.

Padiës		Propozim i	Kujdestaria		Caktimi i	Kontakti i fëmijës		Mosha e	
		përbashkët	ndaj fëmijëve		detyrimit ushqimor	me prindin		fëmijëve	
Burri	Gruaja	15 raste	Babait	Nënës	8 raste	Babanë	Nënën	Min.	Maks.
7 raste	8 raste		6 raste	24 raste		24 raste	6 raste	1.6 vjet	17 vjet

Nga studimi i 30 rasteve, që janë analizuar dhe studiuar, është karakteristike se 15 raste kanë filluar me paraqitjen e padisë dhe po kaq raste, pra 15, kanë filluar me propozim të përbashkët. Nga 15 rastet e filluara me padi, si palë paditëse në 8 raste është paraqitur gruaja, ndërsa në 7 raste është paraqitur burri. Në rastet e ushtrimit të padisë për divorc, gruaja (nëna) nuk paraqitet deri në momentin e fundit, pikërisht për faktin kur janë në pyetje fëmijët, pasi ato janë të lidhura më tepër emocionalisht me fëmijët. Nga tabela shihet se për sa i përket kujdestarisë ndaj fëmijëve në 30 rastet e analizuara, në 24 raste fëmijët i janë besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim nënës, ndërsa në 6 raste babait. Në këto 30 raste, prindërit janë obliguar që të paguajnë ushqimin vetëm në 8 raste, gjë që është për t'u shqetësuar, sepse pavarësisht nga obligimi ligjor i prindërve që të paguajnë ushqimin e fëmijës, në praktikë kjo gjë ndodh shumë pak. Ndërsa kontakti i fëmijëve me prindin, i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore, është caktuar të bëhet me ndërmjetësimin e qendrës për punë sociale vetëm në 3 raste. Në 16 raste të tjera, kontakti i fëmijëve me prindërit është mundësuar të bëhet në çdo kohë, sipas dëshirës dhe marrëveshjes së tyre, kurse në 11 raste, kontakti i fëmijëve me prindërit, koha dhe ditët e kontaktit, janë caktuar me vendim nga ana e Gjykatës. Moshë e fëmijëve të cilët i janë besuar në përkujdesje dhe edukim prindërve, ka qenë minimumi 1 vit e 6 muaj, ndërsa ajo maksimale ka qenë 17 vjet.

5.8 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Bota sot është duke u ballafaquar me një problem social shumë serioz, siç është shkurorëzimi, që duket sikur është bërë normë në jetën tonë. Shkurorëzimi është mënyra e vetme e zgjidhjes së një martese të vlefshme. Shkurorëzimi mund të ndodhë për shkak të arsyeve të ndryshme, si konflikti gjatë martesës, problemet financiare, stresi dhe arsye tjera, por pasojat, që ai lë te fëmijët, janë të shumëfishta.¹⁷⁶

Ai që e bënë shkurorëzimin edhe më të vështirë, është fakti se shumica e çifteve të shkurorëzuara kanë fëmijë, të cilët në shumicën e rasteve janë shumë të vegjël dhe nuk dinë se si të sillen në raste të tilla. Kjo gjendje pasigurie ndikon drejtpërdrejtë mbi personalitetin e fëmijës, i cili në rrethana normale nuk është i përgatitur për të përballuar raportet e acaruar të prindërve e rrjedhimisht edhe procedurën e shkurorëzimit.¹⁷⁷

¹⁷⁶ Ramadani, Vana Jerliu: Divorcet rrezikojnë të ardhmen e familjes. Shih në: <http://www.zemrashqiptare.net>

¹⁷⁷ Po aty.

Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë e përcakton martesën si një institucion të rëndësishëm për shoqërinë, pasi ajo është bazë e krijimit të familjes. Në këtë kuptim janë bërë përpjekje që martesës t'i jepet rëndësia e duhur edhe nga pikëpamje ligjore, meqenëse martesa përfaqëson një institucion shoqëror dhe juridik. Ajo është institucion shoqëror sepse është formë e organizuar shoqërore, ndërsa është institucion juridik, sepse më krijimin e martesës për bashkëshortet krijohen të drejta dhe detyra.¹⁷⁸

Në martesë realizohen edhe interesat e shoqërisë, prandaj shoqëria ka për detyrë që, me instrumente juridike dhe me instrumente të tjera, të krijojë kushtet e nevojshme për një martesë të harmonishme.¹⁷⁹

Institucioni i martesës ka shumë qëllime, por qëllimi më kryesor i martesës duket se ishte dhe mbetet edhe në të ardhmen lindja dhe mirërritja e fëmijëve, gjë që nënkupton kryerjen e marrëdhënieve seksuale midis burrit dhe gruas.

Martesa është institucion juridik i rregulluar kryesisht me dispozita ligjore urdhëruese, ndërsa zgjidhja e saj mund të bëhet vetëm me mënyrën e parashikuar nga dispozitat ligjore.¹⁸⁰ Shkurorëzimi është përfundim ligjor i një martese të vlefshme.¹⁸¹

Kushti themelor për fillimin e procedurës së shkurorëzimit është që padia apo propozimi i përbashkët t'i dorëzohet gjykatës kompetente.

Këtu duhet theksuar se në procedurën e shkurorëzimit, kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, gjykata ka rol aktiv në hetimin dhe shqyrtimin e çështjes lidhur me mbrojtjen e interesit më të mirë të të miturve, të cilët përfshihen në procedurën e shkurorëzimit që zhvillohet mes të prindërve të tyre. Në këtë rast, LFK ka përcaktuar rolin aktiv të gjykatës për mbrojtjen e interesave të të miturve. Për shkak të rëndësisë që i jepet mbrojtjes së interesave të të miturve në kontestet martesore, LFK ka paraparë që gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore, në kontestet martesore, gjykata dhe subjektet e tjera, të përfshira në këto procedura, detyrohen të zbatojnë disa parime për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. LFK-ja me dispozita të veçanta përmban parimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe parimet për mbrojtjen e fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit. Në fillim është me rëndësi të përmendim parimet e përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërsa më tej edhe te parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së

¹⁷⁸ Aliu, Abdullah dhe Gashi, Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007.

¹⁷⁹ Oruçi, Gani, Ligjërata të autorizuar, E Drejta Familjare, Prishtinë, 1994, f. 40.

¹⁸⁰ Podvorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011, f.40.

¹⁸¹ Leonard, Robin dhe Elias, Stephen, Child Custody. Shih në: <http://www.lectal.com>

shkurorëzimit. Ligji i Kosovës për Familjen në dispozitat e Nenit 125 i ka përcaktuar parimet për mbrojtjen e fëmijëve si vijon:

- a) **Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar** - e drejta e fëmijës për të jetuar është ndër parimet themelore. E drejta në jetë nënkupton të drejtën e fëmijës që të jetojë, pra, që jeta e tij të jetë e garantuar në atë mënyrë që askush të mos këtë të drejtë ta privojë atë nga jeta. Ky parim i LFK-së është në pajtim edhe me Nenin 6.1 të KDF-së, ku përcaktohet së shtetet palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar. Në këtë rast, Republika e Kosovës, si zbatuese e drejtpërdrejtë e konventës, detyrohet për garantimin dhe mbrojtjen e jetës së fëmijëve.
- b) **Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët, që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit, kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë** – Fëmija ka një të drejtë të garantuar që të rritet më prindër. Kjo e drejtë i referohet rasteve kur fëmija jeton në familje me të dy prindërit, ndërsa në rastet kur prindërit jetojnë të ndarë, fëmija ka një të drejtë të garantuar që të takojë rregullisht prindin me të cilin nuk jeton.
- c) **Fëmijët me të meta mendore ose fizike të diagnostikuara kanë të drejtë për kujdes të posaçëm, për një jetë të përshtatshme, me kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën shoqërore** - fëmijë me të meta mendore të diagnostikuara konsiderohen ata fëmijë, që kanë intelekt dhe aftësi mendore të kufizuara.

Sipas këtij parimi, fëmijëve me të meta duhet t'iu sigurohet kujdes i posaçëm, për një jetë të përshtatshme sipas gjendjes së tyre shëndetësore, me kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe mundësinë që këta fëmijë të marrin pjesë aktive në jetën shoqërore. Ky detyrim ligjor përcaktohet në radhë të parë për prindërit e fëmijëve me të meta, por natyrisht, niveli i plotësimit të këtyre kushteve për fëmijët me të meta do të varet edhe nga mundësia financiare e prindërve.

Duhet theksuar se ky detyrim nuk kufizohet vetëm në nivelin e përgjegjësisë së prindërve, por ai i referohet edhe detyrimit të shtetit, që të krijojë kushte të nevojshme për

këtë kategori personash, me qëllim që t'u garantohet kujdes i posaçëm, jetë e përshtatshme dhe me dinjitet, si edhe mundësi për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore. Këtyre fëmijëve dhe familjeve të këtyre fëmijëve duhet t'iu sigurohet përkrahje e veçantë dhe e vazhdueshme nga shteti.

- d) **Fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillor falas, të marrjes së informimit për profesione të ndryshme, si edhe për shkollat që ekzistojnë** – e drejta për shkollim është një ndër të drejtat themelore të njeriut, që garantohet me akte ndërkombëtare dhe në këtë kuptim duhet të trajtohet edhe e drejta e fëmijëve për shkollim. Kjo e drejtë është e garantuar edhe me kushtet e caktuara kur thuhet: “Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë.”¹⁸²

Përgjegjësia kryesore për shkollimin e fëmijëve e fëmijëve bie mbi prindërit dhe kujdestarët si përfaqësues ligjorë, të cilët duhet të kujdesen që kjo e drejtë e fëmijëve të realizohet në praktikë. Por institucionet – shteti duhet t'i mbështesë prindërit në atë mënyrë që ky detyrim i rëndësishëm të jetësohet në praktikë.

- e) **Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, nga trafikimi dhe shfrytëzimi seksual dhe nga kryerja e çdo pune, që paraqet rrezik ose që cenon edukimin, ose dëmton shëndetin e tyre** - në kuadër të këtij parimi parashikohet mbrojtja e fëmijëve nga disa forma të ndryshme shfrytëzimi. Sipas këtij parimi, LFK synon të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në radhë të parë nga shfrytëzimi ekonomik- që nënkupton të drejtën e çdo personi për të zgjedhur punën e tij. Në veçanti, kur bëhet fjalë për fëmijët, punësimi mund të jetë vetëm brenda aftësive të tij psikike dhe fizike dhe vetëm me orare të caktuara, që parashikohen me ligje të veçanta, sepse për punësimin e fëmijëve kërkohet mosha e caktuar dhe vetëm një orar të caktuar dhe i përshtatshëm.

Sipas ligjit të punës, fëmijët e moshës 15 deri 18 vjeç mund të krijojnë marrëdhënie pune vetëm në punë të lehta dhe që nuk janë të dëmshme për shëndetin e fëmijës, si edhe nuk

¹⁸² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 47

paraqesin rrezik për mirërritjen dhe edukimin e tyre. Sipas ligjit të punës, krijimi i marrëdhënieve të punës për fëmijët e moshës nën 15 vjeç është i ndaluar.

f) Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual – ndalimi i keqtrajtimit dhe i dhunës seksuale ndaj fëmijëve është standard ndërkombëtar, që duhet respektuar, sepse është garantuar me aktet ndërkombëtare, të cilat parashikojnë ndalimin e çfarëdo “forme të dhunës fizike ose mendore, fyerje ose keqtrajtimit, braktisjes apo mospërfilljes, nëpërkëmbjes ose shfrytëzimit, përfshirë edhe abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër, të cilit i është besuar.”

Në kuadër të këtij parimi parashikohet ndalimi i keqtrajtimit dhe ndalimi i dhunës seksuale. Ndalimi i keqtrajtimit do të thotë se keqtrajtimi dhe dhuna ndaj fëmijëve janë të ndaluara me akte ndërkombëtare dhe me ligje vendore, ndaj mosrespektimi i tyre nënkupton edhe mundësinë e heqjes së të drejtës prindërore për prindërit, që keqtrajtojnë fëmijët e tyre.

LFK, privimin nga kujdesi prindëror, e parashikon me dispozitat e Nenit 149, ndërsa konventa për të drejtat e fëmijëve me dispozitat e Nenit 9. Keqtrajtimi i fëmijëve është edhe vepër penale.

Ndalimi i dhunës seksuale është një ndalesë ligjore, sepse marrëdhëniet seksuale me fëmijë janë të ndaluara me ligj. Çfarëdo forme e marrëdhënieve seksuale me fëmijët konsiderohet edhe si dhunë seksuale, për shkak se fëmijët nuk ka zotësinë për të vepruar. Në kuptimin e ngushtë, dhuna seksuale ndaj fëmijëve nënkupton kryerjen e marrëdhënieve seksuale pa vullnetin e fëmijëve.

Në raste të tilla, mungesa e vullnetit i referohet mungesës së zotësisë së fëmijëve për të vepruar, zotësi që fitohet në moshën madhore dhe me arritjen e moshës madhore, fëmija edhe të mund të shprehë vullnetin e vet. Në këtë drejtim duhet të merren masa parandaluese, të cilat parashikohen me KDF, Neni 19, paragrafi 2, si: procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si edhe forma të tjera parandalimi dhe identifikimi,

raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, edhe procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

g) Fëmijët duhen mbrojtur nga përdorimi i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope dhe nuk duhet lejuar që ata të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve – përdorimi i drogave dhe i mjeteve tjera narkotike janë të ndaluara për secilin person e në këtë kuptim ato janë të ndaluara të përdoren edhe nga fëmijët.

Detyra e prindërve ose e kujdestarëve të fëmijëve është të marrin masa mbrojtëse ndaj fëmijëve, që t'i shmangin ata nga përdorimi i paligjshëm i drogave ose substancave të tjera psikotrope. Një detyrim të tillë e kanë edhe institucionet arsimore, shëndetësore ose institucionet e tjera mbikëqyrëse për përkujdesjen ndaj fëmijëve.

h) Parimi i mbrojtjes së veçantë të disa personave në procedurë - nënkupton faktin se gjatë të gjitha fazave të procedurës së shkurorëzimit, gjykata duhet të ketë parasysh mbrojtjen e interesave të fëmijëve të mitur, të personave të sëmurë, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesën për të drejtat dhe interesat e tyre.

Përveç parimeve bazë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, LFK ka përcaktuar edhe disa kufizime për zhvillimin e procedurës së shkurorëzimit, të cilat i referohen mbrojtjes së interesave të të miturve dhe në dispozitën e Nenit 71, pika 1, parashikohet që: “bashkëshortët nuk duhet të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të mbushë një vit.” Më këtë kufizim ligjor parashikohet një masë mbrojtëse për nënën e fëmijës, si edhe për fëmijën, duke e ndaluar paraqitjen e padisë derisa të zgjatë shtatzënia dhe derisa fëmija të mbushë moshën një vjeç.

Qëllimi i kësaj dispozite ligjore nuk është të ndalojë shkurorëzimin, por të pengojë zhvillimin e procedurës gjatë kësaj kohe, duke pasur parasysh rrethanat rënduese shëndetësore në të cilat gjendet bashkëshortja, respektivisht nëna e fëmijës, si rrjedhojë e shtatzënisë.¹⁸³

¹⁸³ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, vepër e cituar, f. 199.

Kjo ndalesë e zhvillimit të procedurës duhet kuptuar në kuadrin e parimeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilat në mënyrë specifike do të trajtohen në pjesën e parimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Roli aktiv i gjykatës në hetimin, shqyrtimin dhe ofrimin e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit i referohet edhe detyrës së gjykatës që *ex officio* të caktojë masa të përkohshme në kuptimin e dispozitave të Neneve 225, 327 dhe 328 të LFK-së, (të cilat do të trajtohen në pjesën e caktimit të alimentacionit për fëmijët). Gjatë procedurës së shkurorëzimit, një rol esencial për të ofruar mbrojtjen e drejtave të fëmijëve jo vetëm në kuptimin formal, por edhe përmbajtësor, përveç gjykatës, ka edhe Organi i Kujdestarisë.

Kujdesi i gjykatës dhe i Organit të Kujdestarisë gjatë procedurës së shkurorëzimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre duhet të jetë i veçantë jo vetëm për faktin se këto dy institucione janë të ngarkuara më këtë përgjegjësi ligjore, por edhe për shkak të disa faktorëve të cilët ndikojnë që mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre të bëhet më komplekse e rrjedhimisht edhe më e vështirë.

Studimet dhe hulumtimet e praktikës gjyqësore për konteste martesore, ku janë të përfshirë edhe fëmijët, tregojnë se ekzistojnë një numër faktorësh-rrethanash, të cilat e vështirësojnë dukshëm mundësinë e gjykatës dhe të mekanizmave të tjera, që fëmijëve t'iu sigurohet mbrojtja adekuate e të drejtave të tyre.

Në konteste martesore, ku janë të përfshirë edhe fëmijët, gjykata dhe institucionet tjera, që janë të detyruar të ofrojnë mbrojtje për fëmijët, përballen shpesh dhe do të përballen me:

- a) Manipulimin e fëmijëve nga njëri ose prindi tjetër
- b) Ndryshimin e ambientit familjar pa njërin prind gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit
- c) Ndryshimin e vendbanimit, ambienteve sociale apo edhe shkollës, d) Martesën e prindërve të shkurorëzuar pas ndarjes
- e) Detyrimin e fëmijëve më prindër të shkurorëzuar, që të punojnë para moshës madhore
- f) Mundësinë e përfshirjes së këtyre fëmijëve në veprimtari kriminale.

Ndikimi dhe manipulimi i fëmijës/ve nga njëri prind gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit Nga hulumtimi dhe studimi i ndikimit të shkurorëzimit mbi fëmijët rezulton se gjatë procedurës së shkurorëzimit fëmijët ndikohen dhe manipulohen shpesh

herë nga prindërit. Rrethanën e ndikimit dhe manipulimit të fëmijëve nga prindërit e konfirmojnë punonjësit e Qendrave të Punës Sociale, siç janë sociologët, pedagogët, psikologët, mësuesit, por edhe gjyqtarët të cilët trajtojnë rastet e kontesteve martesore-familjare.

Sipas gjetjeve nga praktika gjyqësore rezulton se dukuria e ndikimit dhe manipulimit të fëmijëve gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit të bashkëshortëve është në rritje e sipër. Faktorët që ndikojnë në këtë aspekt janë dëshira e bashkëshortëve që fëmijët t'i besohen nga ana e gjykatës njërit bashkëshort apo tjetrit, si edhe tentativa e bashkëshortëve që në procesin e shkurorëzimit t'i përdorin fëmijët më qëllim që para gjykatës ta identifikojnë prindin tjetër si shkaktar të prishjes së martesës. Në këtë kuptim gjykata duhet të ketë vëmendjen e duhur, që edhe përmes ndihmës profesionale nga ana e Organit të Kujdestarisë (psikologut, sociologut, pedagogut etj.), të pamundësojnë, në radhë të parë, manipulimin e fëmijëve dhe rrjedhimisht të evitojë mundësinë e vlerësimit të deklarimeve të fëmijëve të manipuluar (në rast se ata dëgjohen nga gjykata) si rrethana dhe duke i shmangur ato, gjykata do të vendosë sipas meritave.

Ndryshimi i ambientit familjar pa njërin prind gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit
Njëri ndër faktorët, që ndikon drejtpërdrejt mbi fëmijën është edhe ndryshimi i ambientit. Në shumicën e rasteve gjatë dhe pas procesit të shkurorëzimit të bashkëshortëve fëmijët detyrohen të adaptohen me një ambient tjetër ku mungon njëri prind. Nga intervistat me punonjësit socialë rezulton se në shumë raste fëmijët, përveç se detyrohen të adaptohen me mungesën e njërit prind, janë të kufizuar edhe për të zhvilluar biseda të lirshme lidhur me nevojën që kanë për prindin tjetër, i cili nuk jeton me fëmijët. Në shumë raste, për shkak të nevojës që kanë fëmijët për përkujdesjen nga ana e prindit me të cilin jetojnë, ata detyrohen t'i pranojnë kushtet, që dikton prindi me të cilin jetojnë, gjë që ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e fëmijëve me prindin tjetër, me të cilin fëmijët mund të kenë vetëm kontakt. Fëmijët me prindër të shkurorëzuar, zakonisht nuk kanë udhëzimet e mjaftueshme, ashtu siç ndodh me fëmijët që jetojnë me të dy prindërit dhe kjo mund të paraqesë probleme në jetën e tyre të ardhshme. Mungesa e prindërve për shkak të shkurorëzimit, te disa ndikon edhe në humbjen e fëmijërisë, meqenëse familja ka obligim për të siguruar një lloj kujdesi edhe për anëtarët e tjerë.¹⁸⁴

¹⁸⁴ Ramadani, Vana Jerliu, shkrim i cituar, f. 1.

Ky është njëkohësisht një ndër faktorët që ndikon drejtpërdrejt në jetën e fëmijëve e rrjedhimisht edhe mbi personalitetin e tyre. Fëmijët nuk janë të gatshëm për ndërrim të vendbanimit, të ambienteve sociale apo edhe të shkollës, sepse fëmijët më shumë se të tjerët janë të lidhur me rrethin ku jetojnë.

Nga intervistat me mësuesit rezulton se fëmijët, kur ndryshojnë vendbanimin apo edhe shkollën, ndryshojnë shpesh herë edhe sjelljen e tyre në raport me përgjegjësinë ndaj shkollës. Në shumë raste, pas ndryshimit të shkollës, fëmijët shfaqin rënie në rezultatet mësimore dhe humbje të interesit për mësim, por kjo nuk përfundon vetëm me humbjen e interesit të fëmijëve, por shoqërohet edhe me rënien e interesit të prindërve për fëmijët e tyre.

Pas shkurorëzimit, kur nuk janë më të dy prindërit, që kujdesen për edukimin e fëmijëve, kur nuk janë të dy prindërit, që kujdesin për nivelin e ndjekjes së shkollës dhe mësimin, ndodh herë pas here që fëmijët të braktisin edhe shkollën.

Fëmijët, pas shkurorëzimit të prindërve, ndjehen të tradhtuar, sepse ata mendojnë se prindërit e tyre duhet të rregullojnë problemet midis tyre, për të jetuar së bashku, sepse ata kalojnë në një periudhë të vështirë ndryshimesh në jetën e tyre.¹⁸⁵ Ata humbin miqësinë dhe nganjëherë humbin një mjedis shoqëror të rëndësishëm, sikurse mund të humbin edhe vëllezërit dhe motrat nga kjo ndarje ose t'i lëndojnë këto raporte. Ndaj është përgjegjësi e prindërve për të gjetur mënyrën se si mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre që të kenë një jetë sa më të mirë.¹⁸⁶

Fëmijët kanë nevojë të kenë një pikë referimi të qëndrueshme gjatë formimit të tyre, që do të thotë që nëse të dy prindërit, të cilët zgjidhin martesën, “duan” t'i mbajnë fëmijët në mënyrë të barabartë, ata duhet ta kenë të qartë se ndryshimet e përditshme ose të shpeshta të banimit të fëmijës, herë pranë njërit prind dhe herë pranë tjetrit, bëjnë që fëmijët të humbasin qëndrueshmërinë dhe kjo situatë provokon rrezikun e krijimit të personalitetit të dyfishtë të tyre.¹⁸⁷

¹⁸⁵ Po aty, f. 1.

¹⁸⁶ Po aty, f. 1.

¹⁸⁷ Mandro, Arta, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009, f. 45

Gjykata duhet të ketë vëmendjen e duhur edhe ndaj këtij faktori të mundshëm në mënyrë që të realizojë hetimin e duhur mbi të gjitha rrethanat, që mund të kenë efekt në jetën e fëmijëve, prindërit e të cilëve shkurorëzohen dhe të vendosë mbi bazën e një vlerësimi profesional, objektiv, gjithëpërfshirës e me referencë në parimin e mbrojtjes së interesit më të mirë të të miturit.

Ne tërheqim vëmendjen në këtë pikë, sepse në disa raste gjykatat do të përballen edhe me informacione të mangëta, për shkak se Organi i Kujdestarisë nuk posedon kapacitetet e nevojshme profesionale për ta ndihmuar punën e gjykatës, por megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykatat lirohen nga përgjegjësia për të ofruar dhe garantuar më të mirën e mundshme për fëmijët. Në raste të tilla, është në dorën e gjykatave që të përdorin të gjitha mundësitë ligjore për të marrë edhe ndihmën e institucioneve tjera profesionale me shpenzimet e gjykatës, me qëllim që vendimi i gjykatës të jetë zgjidhja më e mirë për një situatë të tillë.

Martesa e prindërve të shkurorëzuar pas ndarjes dhe pasojat për fëmijët

Pas martesës së prindërve të shkurorëzuar, fëmijët janë nganjëherë shumë konfuzë në marrëdhëniet me familjen e re. Në çështje të tilla luajnë rol shumë faktorë, si njerka ose njerku, që mund të mos jenë të mirë dhe të mos kenë konsideratë për ta, ose në këto marrëdhënie mund të ndikojnë edhe vëllezërit dhe motrat nga martesa e re.¹⁸⁸ Në raste të tilla, fëmijët do të përballen më vështirësinë e vendosjes së një marrëdhënie normale me njerken apo njerkun e në disa raste, kjo ndodh edhe për shkak se këta të fundit nuk tregojnë interesin për të vendosur një marrëdhënie normale dhe njerëzore me fëmijët e bashkëshortit apo bashkëshortes.

Po ashtu duhet theksuar edhe fakti se në shumë familje, ku fëmijët (vëllezër dhe motra) jetojnë me prindër të ndryshëm, trajtimi i tyre nuk është i barabartë dhe kjo sigurisht që lë gjurmë mbi personalitetin e fëmijëve. Në këtë kontekst ne theksojmë nevojën që gjykata duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kësaj rrethane si në rastin e vendosjes për kujdestarinë ndaj fëmijëve, ashtu edhe për ndryshimin e vendimit lidhur me kujdestarinë ndaj fëmijëve.

¹⁸⁸ Ramadani, Vana Jerliu, shkrim i cituar, f. 1.

Detyrimi i fëmijëve me prindër të shkurorëzuar që të punojnë para moshës madhore
Fëmijët me prindër të shkurorëzuar, zakonisht nuk kanë udhëzime të mjaftueshme, ashtu siç kanë fëmijët që jetojnë me të dy prindërit dhe kjo mund të paraqitet si problem në jetën e tyre të ardhshme.

Mungesa e prindërve për shkak të shkurorëzimit ndikon te disa edhe në humbjen e fëmijërisë, sepse familja ka obligim për të siguruar një lloj kujdesi edhe për anëtarët e tjerë. Në këto rrethana, fëmijët detyrohen të punojnë në moshë shumë të re, madje disa prej tyre ndërpresin edhe shkollimin dhe kjo ka pasoja negative sociale.¹⁸⁹

Detyrimi që fëmijët të punojnë në moshë të re është në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve, të cilat duhet t'i garantojë çdo shoqëri demokratike. Në Kosovë ky është një problem i theksuar, i cili kërkon vëmendjen dhe përkushtimin e tërë shoqërisë dhe të të gjitha institucioneve, për ta ndryshuar këtë dukuri. Në këtë kuptim, edhe gjykatat duhet të realizojnë funksionin e tyre për aq sa përfshin juridiksioni i tyre.

Mundësia e përfshirjes së fëmijëve me prindër të shkurorëzuar në veprimtari kriminale
Disa nga fëmijët, prindërit e të cilëve janë shkurorëzuar, për shkak të mungesës së mbështetjes emocionale nga prindërit bëhen pre e veseve, gjë që shoqërohet me krijimin e varësive të ndryshme, siç janë: drogat, duhani, alkooli etj. Ky vlerësim konfirmohet edhe nga studimet dhe hulumtimet e realizuara në Kosovë.

Hulumtimet tregojnë se një ndër problemet, i cili mbizotëron mes të rinjve, sidomos atyre të shkollave të mesme, është përdorimi i pirjes së duhanit. Krahas saj, edhe përdorimi i alkoolit dhe i drogës, ndonëse gjendet në një nivel më të ulët se duhani, dukuria e përdorimit të tyre është në rritje.

Fëmijët me prindër të shkurorëzuar kanë shfaqur probleme edhe me rezultatet e tyre në shkollë, si edhe në aktivitetet e tjera në shoqëri. Efektet duken edhe në emocionet negative që shfaqen te fëmijët, si rezultat i shkurorëzimit të prindërve. Ata shfaqin edhe një ndjenjë të ulët vetëbesimi, ndjenja pasigurie, si edhe e braktisje të jetës shoqërore.

¹⁸⁹ Po aty, f. 1.

Fëmijët me prindër të shkurorëzuar, për shkak të braktisjes së jetës shoqërore bëhen shpeshherë pjesë e grupeve të ndryshme kriminale dhe pjesë e jetës kriminale, pasojat e të cilës janë shpeshherë fatale për ta dhe për shoqërinë. Për këtë arsye është me rëndësi që edhe shkollat, edhe institucionet tjera edukative, të rrisin kapacitet e tyre profesionale duke punësuar psikologë dhe ekspertë të fushave të tjera, të cilët do t’iu jepnin një ndihmë profesionale të gjithë fëmijëve, të cilët kanë nevojë për një ndihma të tillë dhe në veçanti fëmijëve, të cilët jetojnë me prindër të ndarë për arsye të ndryshme. Edhe analizat e ndryshme, që i referohen parandalimit të delikuencës së të miturve, rekomandojnë që përveç tjerave, të bëhet edhe emërimi i psikologëve (por edhe i sociologëve) nëpër shkolla, në funksion të parandalimit të delikuencës së të miturve dhe të nevojave tjera që kanë nxënësit.¹⁹⁰

5.9 Parimet për mbrojtjen e fëmijëve gjatë shkurorëzimit

LFK-ja, përveç parimeve të përgjithshme për mbrojtjen e fëmijëve, me dispozitat e Nenit 70 parashikon parimet e mbrojtjes së fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit.

Parime kryesore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë shkurorëzimit janë këto:

- *Bashkëshortët nuk lejohen të paraqesin padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të këtë mbushur një vit*¹⁹¹ – ky është një parim shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e nënës së fëmijës dhe për fëmijën, duke e ndaluar paraqitjen e padisë derisa zgjat shtatzënia dhe derisa fëmija të këtë mbushur një vit. Qëllimi i këtij parimi nuk është ndalimi i shkurorëzimit, por pengimi i zhvillimit të procedurës për një kohë të caktuar, duke marrë parasysh gjendjen rënduese shëndetësore të nënës së fëmijës si dhe të fëmijës derisa ai të mbushë një vit. Ky parim nuk do të thotë se nuk lejohet paraqitja e padisë, por ai lidhet me faktin se nëse paraqitet padia, atëherë gjykata nuk e zhvillon procedurën e shkurorëzimit gjatë periudhës derisa fëmija të mbushë një vit dhe për këtë arsye gjykata e hedh poshtë padinë si të palejueshme për atë periudhë kohe. Kjo dispozitë është e parashikuar edhe në legjislacionet e vendeve tjera, por në forma të ndryshme. Në Kodin e Familjes në Shqipëri parashikohet se “*Kur gruaja është shtatzënë, me kërkesën e saj,*

¹⁹⁰ Murati, Valon dhe Berisha, Qerkin, Roli i Edukimit në Parandalimin e Delikuencës së të Miturve, Prishtinë, 2009, f. 39.

¹⁹¹ Neni 70, paragrafi 1 i LFK-së

*gjykata mund të pezullojë gjykimin e padisë së zgjidhjes së martesës, por jo më tepër se 1 vit nga çasti i lindjes së fëmijës”.*¹⁹²

Në njëfarë forme, kjo është e parashikuar edhe në të Drejtën e Sheriatit, ku parashikohet se nëse çështja arrin deri te shkurorëzimi i gruas shtatzënë, ajo duhet të qëndrojë në shtëpinë e burrit të saj derisa të lindë, ndërsa burri është i obliguar që për atë periudhë ta mbajë në shtëpi.¹⁹³ Aty parashikohet gjithashtu se nëse gruaja i jep gjë fëmijës, atëherë burri, nëse çështja arrin deri te shkurorëzimi, është i obliguar që t'i japë asaj një shpërblim të caktuar për këtë akt.¹⁹⁴

Megjithatë, ka edhe autorë, të cilët mendojnë se është më mirë që shkurorëzimi të lejohet edhe në këtë rast, por gjatë gjyimit, gjykata duhet të vlerësojë dhe të ftojë ekspertët përkatës, të cilët do të vlerësojnë se shkurorëzimi në këtë fazë shkon në favor të bashkëshortëve.¹⁹⁵ Këtë e arsyetojnë me faktin se nëse një nënë gjatë shtatzënisë ka dhunë psikike dhe fizike nga bashkëshorti i saj dhe nuk mund të parashtrijë padi për zgjidhjen e martesës, ajo mund të detyrohet të ndërpresë shtatzëninë dhe me këtë rast kryen një vepër penale.¹⁹⁶ Ndërprerja e shtatzënisë pas javës së dhjetë është vepër penale.¹⁹⁷ Po kështu edhe me përcaktimin derisa fëmija të mbushë një vit, sepse kjo mund të jetë një periudhë e frikshme, sepse nëse ndaj një nëne ushtrohet dhunë psikike dhe fizike, periudha prej një viti është një periudhë e gjatë për të përballuar një jetë të padurueshme dhe ka raste, kur nga presioni që kanë pasur, ato kanë mbytur fëmijët e tyre më të dashur.¹⁹⁸

*Bashkëshortët janë të detyruar që së bashku me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, ta parashtrijë me shkrim edhe marrëveshjen për kujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët, si edhe propozimin me shkrim mbi mënyrën se si do të garantohen kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve në të ardhmen*¹⁹⁹ - ky është një parim i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurën e shkurorëzimit. Sipas këtij parimi bashkëshortët të cilët paraqesin marrëveshje për shkurorëzim (propozim të përbashkët) janë të obliguar që së bashku me marrëveshje të paraqesin edhe marrëveshjen se cilit i besohen fëmijët, kujdesin dhe

¹⁹² Neni 137 i KFSH-së

¹⁹³ Kurdiq, Shefik, Martesa dhe marrëdhëniet intime në Islam, Prishtinë, 2004, f. 74.

¹⁹⁴ Po aty.

¹⁹⁵ Mulaj, Valbon, Zgjidhja e martesës, Prishtinë, 2011, f. 57.

¹⁹⁶ Po aty, f.56.

¹⁹⁷ Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë, Nr. 03/L-110, Neni 6.

¹⁹⁸ Mulaj, Valbon, vepër e cituar, f. 57.

¹⁹⁹ Neni 70, paragrafi. 2 i LFK-së

edukimin e tyre si dhe kontaktet personale të prindërve pas shkurorëzimit. Edhe ky parim është i parashikuar edhe në legjislacionin e vendeve tjera, si edhe në akte ndërkombëtare. Kodi i Familjes në Shqipëri parashikon se:

“Marrëveshja përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore.”²⁰⁰

Mirëpo kjo marrëveshje e bashkëshortëve nuk është detyruese për gjykatën, që do të thotë se gjykata mund ta aprovojë apo ta refuzojë atë, në vartësi të interesit më të mirë të fëmijëve.

- *Leja për shkurorëzim mund të mos jepet ose mund të shtyhet, edhe pse martesa ka dështuar, vetëm në raste të veçanta, kur ruajtja e martesës bëhet për arsye specifike, të domosdoshme, për interesin e fëmijës*²⁰¹— si parim i tretë i parashikuar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, edhe ky parim përcakton se gjykata, gjatë procedurës nuk do ta lejojë shkurorëzimin apo mund të shtyjë atë nëse kjo gjë është në interes të fëmijëve. Sipas këtij parimi, rastet për të cilat bëhet fjalë nuk janë të parashikuara, mirëpo qëllimi i këtij parimi është interesi më i lartë i fëmijës. Ne e kemi theksuar edhe më lart se interesi parësor i të gjitha institucioneve, që marrin pjesë në procedurën e zgjidhjes së martesës, është edhe çmuarja e interesit të fëmijës. Ky parim është i parashikuar në dispozitat e shumë legjislacioneve dhe akteve ndërkombëtare. Ky parim është i parashikuar edhe në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.²⁰² Në raste të tilla, si interesa të fëmijëve mund të konsiderohen edhe sëmundja e rëndë e fëmijës, përkujdesja e të dy prindërve gjatë ditëve të para të lindjes së tij etj.²⁰³

²⁰⁰ Neni 127, paragrafi 2 i KFSH-së

²⁰¹ Neni 70, paragrafi 3 i LFK-së

²⁰² Neni 50 i KKK-së

²⁰³ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, vepër e cituar, f. 201.

KAPITULLI VI: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM KRAHASUES KOSOVË-SHQIPËRI

6.1 Aspektet krahasuese të rregullimit ligjor në Kosovë dhe Shqipëri

Ky kapitull përmban një analizë krahasuese të aspekteve të ndryshme të kuadrit ligjor i cili rregullon çështjen e martesës, shkurorëzimit dhe pasojat e tij.

6.1.1 Mbiemri

KFSH, në Nenin 52, parashikon se “Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve. Nëse prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë një mbiemër, atë që vendosin prindërit me marrëveshje. Ndërsa nëse prindërit nuk mund të arrijnë marrëveshje, fëmija merr mbiemrin e të atit.” Kjo dispozitë e KFSH, shtron çështjen e mospërputhshmërisë apo kundërshtimit të këtij përcaktimi ligjor me dispozitat e Nenit 1 të Kodit, “barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve”, me parashikimin e Nenit 2 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (KEGJFDKG)-“Parimin e barazisë së burrit dhe të gruas”.²⁰⁴ Ky nen, në këto raste, favorizon babanë. Ndërsa sipas Nenit 130 të LFK, mbiemri i fëmijës caktohet në marrëveshje në mes të dy prindërve. Fëmija mund të marrë mbiemrin nga njëri prind ose nga të dy prindërit. Megjithatë nuk lejohet që fëmijëve të përbashkët, prindërit t’u caktojnë mbiemra të ndryshëm. Në rastet kur prindërit nuk arrijnë marrëveshje për caktimin e mbiemrit të fëmijës, atëherë mbiemri caktohet nga Organi i Kujdestarisë, pasi t’i dëgjojë të dy prindërit, duke parë interesin e fëmijës, por edhe se cili mbiemër kishte me qenë më i pranueshëm edhe për prindërit. Në Kosovë, në rastin e mosmarrëveshjeve rreth caktimit të mbiemrit të fëmijës, vendos Organi i Kujdestarisë. Të dy legjislacionet parashikojnë detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve. Dallime në mes LFK-së dhe KFSH-së, ekzistojnë edhe në rastin e pasojave që ka për bashkëshortët zgjidhja e martesës, veçanërisht në lidhje me mbiemrin e tyre. Në Nenin 96 të Ligjit mbi Familjen në Kosovë parashikohet se bashkëshorti, i cili e ka ndryshuar mbiemrin me rastin e martesës, pas

²⁰⁴ Neni 2 pika a) e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, parasheh: Shtetet palë dënojnë diskriminimin kundër grave në të gjitha format dhe me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë pajtohen ta ndjekin një politikë të eliminimit të diskriminimit kundër grave dhe se për këtë arsye zotohen që: a) në kushtetutat e tyre kombëtare ose ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, ta përfshijnë parimin e barazisë së burrit dhe të gruas, po që se ende nuk është bërë dhe nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera të përshtatshme ta siguroj zbatimin praktik të këtij parimi.

zgjidhjes së martesës mund të marrë mbiemrin e mëparshëm dhe deklarata duhet të jepet brenda një afati prej gjashtë muajve pas zgjidhjes së martesës. Ndërsa në Nenin 146 të Kodit të Familjes në Shqipëri, parashikohet se bashkëshorti, që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës. Por gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës. Pra, siç shihet, mes të dyja legjislacioneve ka një dallim edhe në këtë pikë.

6.1.2 Fejesa

Kodi i Familjes në Shqipëri, në dallim nga LFK, nuk e parashikon fejesën, kurse LFK e përkufizon fejesën si institut të së drejtës familjare, që i paraprin lidhjes së martesës, por ai nuk e obligon lidhjen e martesës. Sipas këtij Ligji, “fejesa është premtim reciprok i të dy personave me gjini të kundërt për t’u martuar në të ardhmen.”²⁰⁵

6.1.3 Pasojat e zgjidhjes së martesës

KFSH dhe LFK kanë edhe dispozita identike, sipas të cilave bashkëshortët që rregullojnë me marrëveshje pasojat e zgjidhjes së martesës, mund të bien dakord edhe për dhënien e kujdestarisë, për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, për të ardhurat apo ushqimin e nevojshëm për rritjen dhe edukimin e tyre.

6.1.4 Interesat e fëmijëve

Legjislacioni i të dy vendeve parashikon mundësinë e refuzimit të marrëveshjes së arritur në mes të prindërve në rast se me atë marrëveshje janë cenuar interesat e fëmijëve. Në rast se marrëveshjet nuk sigurojnë interesin primar të fëmijëve, gjykata, sipas KFSH-së, pezullon gjykimin për tre muaj, ndërsa, sipas LFK-së, gjykata ka të drejtë të vlerësojë nëse marrëveshja e nënshkruar nga prindërit është në interes të fëmijëve dhe në varësi të rrethanave dhe gjendjes së vërtetuar, gjykata mund ta aprovojë apo ta refuzojë atë marrëveshje. Nëse vlerëson se marrëveshja nuk është në interes të fëmijëve, atëherë, pavarësisht nga marrëveshja mes prindërve, gjykata vendos për kujdestarinë, për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve, si edhe për kontaktin me prindin, që nuk e ushtron të drejtën prindërore me fëmijën.²⁰⁶

²⁰⁵ Neni 9, LFK

²⁰⁶ Neni 128, KCSH, Neni 140, paragrafi 1, LFK

6.1.5 Masa mbrojtëse për bashkëshorten dhe fëmijët

Në procedurën e zgjidhjes së martesës, të dy legjislacionet parashikojnë masa mbrojtëse për fëmijët dhe për bashkëshorten-gruan, me qëllim që të mbrohen interesat e tyre. Neni 70 i LFK-së parashikon masat mbrojtëse, që i dedikohen fëmijës dhe gruas shtatzënë. Sipas këtij neni, bashkëshortët nuk mund të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë kohës së shtatzënisë së gruas dhe deri sa fëmija i përbashkët i tyre të mbushë një vit.

Sipas KFSH, në dallim nga LFK, kur gruaja është shtatzënë, gjykata mund ta pezullojë zgjidhjen e martesës me kërkesën e saj, por jo më tepër se një vit nga momenti i lindjes së fëmijës. Nga krahasimi vihen re dallimet në mes të dy legjislacioneve, sepse sipas LFK-së, deri sa gruaja është shtatzënë dhe derisa fëmija nuk ka mbushur një vit, asnjëri prej bashkëshortëve nuk mund të paraqesë padi në gjykatë për zgjidhjen e martesës. Ndërsa sipas KFSH-së, bashkëshortët mund të paraqesin padi, por me kërkesën e gruas shtatzënë, gjykimi i padisë për zgjidhjen e martesës mund të pezullohet nga gjykata, gjë që do të thotë se nëse gruaja shtatzënë nuk paraqet kërkesë, atëherë gjykimi mund të vazhdojë dhe martesë të zgjidhet, pavarësisht se gruaja gjendet në rrethana të atilla

6.1.6 Kujdestaria ndaj fëmijëve

Dallimi në mes të KFSH-së dhe LFK-së vërehet edhe në rastet kur gjykata, para marrjes së vendimit lidhur me kujdestarinë ndaj fëmijëve apo të vizitave të tyre – kontaktit, duhet të marrë mendimin e ekspertit përkatës. Sipas LFK-së, mendimi profesional lidhur me kujdestarinë dhe kontaktin e fëmijëve me prindin, që nuk e ushtron të drejtën prindërore jepet nga ekipi i ekspertëve (në grup) i Qendrës së Punëve Sociale. Ndërsa sipas KFSH-së, gjykata, para marrjes së vendimit për kujdestarinë dhe vizitën e fëmijës nga njëri prind, duhet të ftojë një psikolog ose një punonjës social për të dhënë mendimin se cilat janë kushtet më të përshtatshme, ku duhet të jetojë fëmija.²⁰⁷

6.1.7 Detyrimi Ushqimor dhe e drejta e kontaktit

Për sa i përket detyrimit ushqimor, të dy legjislacionet e parashikojnë detyrimin e prindërve për ushqim ndaj fëmijëve të tyre të mitur, si edhe ndaj fëmijëve madhorë, deri sa ata vijnë ende mësimin në shkollën e mesme ose në fakultet deri në moshën 25 vjeç,

²⁰⁷ Neni 155, KCSH

sipas KFSH-së, ndërsa sipas LFK-së, deri në moshën 26 vjeç. Ngjashmëri në mes të KFSH-së dhe LFK-së, vërehen edhe të çështja e ndryshimit të detyrimit ushqimor pas marrjes së vendimit përfundimtar. Në rastet, kur kanë ndryshuar rrethanat mbi bazën e të cilave është caktuar detyrimi ushqimor, gjykata, me kërkesën e palës së interesuar mundet ta zvogëlojë, ta heqë ose ta shtojë detyrimin për ushqim. Ngjashmëria midis LFK-së dhe KFSH-së, ekziston edhe për sa i përket të drejtës së kontaktit, sipas LFK-së dhe vizitës, sipas KFSH-së, sepse ndryshojnë vetëm shprehjet, kurse qëllimi është i njëjtë. Fëmijët kanë të drejtën e kontaktit me prindërit apo me prindin, me të cilin nuk jetojnë. Kjo e drejte në LFK parashikohet në Nenin 145, ndërsa në KFSH, në Nenin 155.

6.1.8 Mbajtja financiare

Mbajtja financiare dhe ushqimi(alimentacioni)- në LFK, në dallim nga KFSH-ja, bën një ndarje, midis shprehjeve mbajtje financiare dhe ushqimit (alimentacionit). Si rezultat, mbajtja financiare lidhet vetëm me mbajtjen financiare të fëmijëve, ndërsa kur bëhet fjalë për mbajtjen e bashkëshortëve, atëherë përdoret shprehja mbajtje martesore, kurse për ushqimin alimentacioni.²⁰⁸ Në kuptimin e tyre nuk vërehet ndonjë dallim i madh terminologjik, pasi në dispozitat e Nenit 278, paragrafi 1 theksohet se “mbajtja financiare, në kuptimin e këtij Ligji, nënkupton detyrimin financiar dhe material,” ndërsa Neni 280, paragrafi 2 parashikon se “[..] prindërit janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare në mënyrë të arsyeshme për fëmijën e tyre të mitur dhe të pa martuar. Kjo vlen gjithashtu edhe për fëmijët e moshës 18 deri 26 vjeç, kur ata jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre apo të njërit prind dhe janë ende në shkollim të përgjithshëm.” Neni 297 jep përcaktimin e detyrimit ushqimor dhe aty thuhet se “ushqyerja është mbajtja financiare e bashkëshortit apo e ish-bashkëshortëve.” Ligjvënësi ka bërë një dallim midis kërkesave të fëmijëve dhe kërkesave të personave madhorë, sepse fëmijët, përveç nevojës për mjete financiare, që shërbejnë për ushqim, veshmbathje, kanë nevojë për ndihmë financiare edhe për shkollim, edhe për edukim, ndërsa personat madhorë kanë nevojë jo vetëm për ushqim dhe veshmbathje, por ata kanë edhe nevoja shëndetësore.

²⁰⁸ Gashi, Haxhi, Aliu, Abdullah dhe Vokshi, Adem, vepër e cituar, f. 594

KAPITULLI VII: VËSHTRIM KRAHASUES MIDIS SHTETEVE ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN

Qëllimi i këtij kapitulli është të prezantojë një vështrim krahasues midis regjimeve të së drejtës martesore në shtete të ndryshme anëtare të Bashkimit European. Konkretisht, në këtë kapitull do të analizohet regjimi i të drejtës martesore në Francë, Gjermani, Itali dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Fillimisht, analiza e përmbajtur në këtë kapitull do të përqendrohet në regjimin juridik, i cili është i aplikueshëm në të gjithë shtetet anëtare të Bashkimit European, në mënyrë që të arrihet në një konkluzion në lidhje me nivelin e harmonizimit të kuadrit ligjor në Bashkimin European, sa i përket të drejtës martesore dhe pasojave të shkurorëzimit. Më tej, do të analizohet kuadri ligjor në shtetet anëtare të përmendura me lart me qëllim që të evidentohen ndryshime në kuadrin ligjor të këtyre shteteve, duke i kushtuar rëndësi të veçantë çështjeve si: kuptimi dhe objekti i martesës, shkurorëzimi dhe pasojat e zgjidhjes së martesës, regjimi pasuror i aplikueshëm gjatë procedurës së shkurorëzimit dhe të drejtat dhe detyrimet e prindërve në lidhje me fëmijët. Një analizë e tillë do të shërbejë për të arritur në një konkluzion më të plotë dhe gjithëpërfshirës për përmirësimin e kuadrit ligjor të së drejtës martesore në Kosovë e Shqipëri.

7.1 E drejta martesore në Bashkimin European

E drejta martesore në regjimin juridik të Bashkimit European përfshin çështje si martesa, shkurorëzimi, adoptimi i fëmijëve dhe çështje të ndryshme, të cilat lidhen me përgjegjësinë e prindërve mbas shkurorëzimit.²⁰⁹ Qëllimi i institucioneve të Bashkimit European është të përcaktojë dispozita ligjore të përbashkëta në lidhje me të drejtën martesore, në mënyrë që qytetarët european të gëzojnë një mbrojtje ligjore të përshtatshme në rastet, kur jetojnë në vende të ndryshme të Bashkimit European.²¹⁰ Megjithatë, këto rregulla ndryshojnë në shtete të ndryshme anëtare të Bashkimit European, duke qenë se zhvillimi i të drejtës martesore lidhet ngushtë me historinë, kulturën dhe zhvillimin social të shteteve anëtare.²¹¹

²⁰⁹ Choudry & Herring, "European Human Rights and Family Law", Bloomsbury UK, 2010, F.321

²¹⁰ European Parliament "Citizen's Rights and Constitutional Affairs –Which basis for Family Law? The Way Forward" Note from the European Parliament, 2012

²¹¹ Schalk & Kopf k. Austrisë (N.301141/04)

Kështu, përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve, të cilat i përkasin gjerësisht të drejtës martesore, është kompetencë e shteteve të ndryshme anëtare të Bashkimit European.²¹²

Praktika ligjore në shtete të ndryshme, sa i përket të drejtës familjare, ndryshon në disa aspekte themelore, duke përfshirë këtu çështje si të drejtat dhe detyrimet e çiftit të martuar, si për shembull, në lidhje me regjimin e pronësisë së aplikueshme në rastet kur bashkëshortët aplikojnë për divorc, rolit të tyre si prindër ose për mbiemrin martesor. Një ndryshim tjetër, i theksuar, në praktikën ligjore midis shteteve të ndryshme të Bashkimit European i përket çështjes së marrëdhënieve midis martesave fetare dhe civile. Në disa shtete, martesat fetare konsiderohen të barabarta me martesat civile, kurse në shtete të tjerë qëndron e kundërta.²¹³ Më tej, një ndryshim tjetër lidhet me çështjen e mundësisë së martesës për çiftet me seks të njëjtë. Belgjika, Franca, Gjermania, Irlanda, Norvegjia, Portugalia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar u ofrojnë këtyre çifteve mundësinë për t'u martuar. Pavarësisht faktit se përcaktimi i rregullave të aplikueshme për të drejtën martesore është kompetencë e shteteve anëtare, në rastet kur një çështje e caktuar, si për shembull, një procedurë shkurorëzimi, ka implikime të cilat përfshijnë bashkëshortë me nacionalitete të ndryshme, si për shembull, në rastin kur një shtetase belge, e martuar me një shtetas francez, kërkon të ndahet. Në këtë rast, organet kompetente të Bashkimit European kanë përcaktuar procedura legjislative të posaçme, të cilat përmbahen gjerësisht në Rregulloren Brussels II,²¹⁴ të cilat janë të aplikueshme dhe përcaktojnë të drejtat e detyrimet e secilës palë.

7.2 E drejta martesore në Francë

Ligji më i rëndësishëm i së drejtës civile për nga rëndësia e vet historike, si dhe për nga vlera e tij e brendshme, është Kodi Civil Francez.²¹⁵ Bazën e këtij kodi e përbën E Drejta Romake, E Drejta Zakonore Franceze, por edhe E Drejta Kanonike Mesjetare, sidomos lidhur me raportet familjare. Ky kod, ndryshe është i njohur edhe si Kodi i Napolonit, i cili ka pasur një ndikim të madh në miratimin e Kodit Civil Francez.

²¹² Po Aty, F.13 e gjykimit

²¹³ Në Mbretërinë e Bashkuar dhe Gjermani, këto lloje martesash janë ekuivalente në ligj, kurse në Itali qëndron e kundërta.

²¹⁴ Council Regulation (EC) No 1347/2000 of 29 May 2000 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and in matters of parental responsibility for children of both spouses.

²¹⁵ Kodi Civil Francez, 2016

Kodi Civil apo “Code Civil” ka pasur ndikim të madh në nxjerrjen e kodeve të mëvonshme në shtetet e Evropës dhe në shtetet e tjera jashtë saj. Dispozitat ligjore për regjimin e pronësisë midis bashkëshortëve rregullohen me rreth 200 nene, përkatësisht nga nenet 1387-1587. Sipas këtij kodi, në të drejtën civile hyjnë edhe e drejta familjare dhe ajo e jetës bashkëshortore.

Derisa Kodi Civil ishte më përparimtar, në krahasim me të drejtën e mëparshme borgjeze, në të drejtën e jetës së bashkëshortëve dhe atë familjare, në një farë mënyre, ka qenë një lloj kthimi prapa në krahasim me legjislacionin e revolucionit francez. Në revolucionin francez ka qenë parashikuar barazia e burrit dhe gruas, barazimi i fëmijëve martesorë dhe jashtëmartesorë; ndërkaq Kodi Civil parashikon nënshtrimin e gruas në raport me burrin (si, për shembull, Neni 213). Ky nënshtrim paraqitet sidomos te raportet e ndryshme familjare dhe bashkëshortore-pronësore. Kodi Civil flet për pushtetin e burrit e jo të prindërve. Fëmijët jashtëmartesorë ishin në gjini vetëm me nënën, nëse babai nuk i pranonte vullnetarisht, sepse vërtetimi i atësisë ishte i ndaluar (Neni 340). Këto dispozita kishin për qëllim forcimin e familjes së pasur borgjeze. Megjithëse Kodi Civil formalisht është ende në fuqi, ai, me kalimin e kohës, ka pësuar një mori ndryshimesh. Këto ndryshime janë shprehur sidomos në pjesën apo librin, i cili ka të bëjë me të drejtën familjare.

Në Francë, burimet kryesore të së drejtës familjare janë të kodifikuara. Sa i përket çështjeve të martesës, shkurorëzimit, përgjegjësisë prindërore dhe mbështetjes për fëmijët, dispozitat ligjore përmbahen në Kodin Civil Francez. Gjykata e çështjeve familjare është gjykata kryesore, e cila gëzon juridiksionin mbi çështjet familjare. Juridiksioni i kësaj gjykate shtrihet në çështje si përgjegjësia e prindërve, shkurorëzimi, gjykime mbi mbiemrin, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, partneritetet civile dhe të drejtat e detyrimet në lidhje me fëmijët.

Duke filluar nga data 1 janar 2016, gjykata për çështjet familjare gëzon juridiksion edhe mbi pasojat e shkurorëzimit, veçanërisht sa i përket çështjeve si ndarja e pasurisë martesore dhe e pronësisë.²¹⁶ Regjimi juridik i aplikueshëm në rastet e shkurorëzimit është modifikuar disa herë në të kaluarën. Në Francë, procedura e shkurorëzimit është njohur me ligje edhe përpara kalimit të Aktit të Reformës së vitit 1975; fillimisht ajo

²¹⁶ Po aty, F.121

është njohur në Kodin e Napoleonit të vitit 1804. Në vitin 1975, legjislatura franceze, në sajë të ndryshimeve në mentalitetin e shoqërisë franceze, vendosi t'i jepte fuqi një akti ligjor, i cili zgjeronte mundësinë e çifteve për të aplikuar për divorc, duke ligjëruar arsye të tilla si pranim nga të dyja palët, faji i njëres palës, ndarje fizike për më shumë se 6 vjet ose paqëndrueshmëria mendore e njërit prej bashkëshortëve për të paktën 6 vjet.²¹⁷ Këto shkaqe gjenden të listuara në Artikullin 230 të Kodit Civil Francez.

Duke filluar që nga data 1 janar 2015, shkurorëzimi me pranim dypalësh mund të ekzekutohet me anë të një kontrate të lidhur përpara një noteri. Kështu, mund të arrihet në përfundimin se në Francë, ligjvënësit kanë miratuar disa procedura përsheptuese në rastet e shkurorëzimit.

Sa i përket regjimit pasuror mbas shkurorëzimit, kuadri ligjor francez ka pësuar disa ndryshime themelore gjatë 100 viteve të fundit. Hyrja në fuqi e ligjit të datës 18 shkurt 1938 i dha fund praktikës ligjore të konsiderimit së gruas si palë e dëmtuar si pasojë shkurorëzimit, e cila rezultonte faktikisht në një situatë ku bashkëshorti detyrohej të dorëzonte një pjesë të konsiderueshme të pasurisë të tij në mënyrë që të sigurohej aftësia e bashkëshortes për të jetuar. Me hyrjen në fuqi të ligjit reformues të vitit 2006,²¹⁸ bashkëshortët mund të zgjedhin midis dy regjimesh pasurore. Regjimi i parë dhe më i preferuari, bazohet mbi parimin se bashkëshortët kanë pronësi të përbashkët të pasurive dhe pronave. Në raste të tjera, bashkëshortët mund të zgjedhin që, mbas shkurorëzimit, secilit t'i rikthehet pronësia e pasurive, të cilat kishin në pronësi respektivisht përpara lidhjes së martesës. Në këtë rast, pasuritë e fituara mbas martesës në përgjithësi konsiderohen të jenë pronësi e përbashkët dhe ndahen në mënyrë të barabartë. Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, sipas ligjit francez, funksioni kryesor i autoriteti prindëror është mbrojtja e fëmijëve.

Kështu, kuadri ligjor francez detyron bashkëshortët që mbas shkurorëzimit të kujdesen për sigurinë, shëndetin dhe edukimin e fëmijëve. Deri në vitin 1970, detyrimet për përkujdesjen e fëmijëve binin vetëm mbi bashkëshortin, deri në hyrjen në fuqi të aktit reformues të vitit 1985.

²¹⁷ Kodi Civil Francez, Art.230

²¹⁸ Ligji Reformues vitit 2016, Seksioni 2

7.3 E drejta martesore në Gjermani

Në Gjermani, burimet kryesore të dispozitave, të cilat i përkasin gjerësisht çështjeve familjare përmbahen në statute. Dispozitat kryesore, të cilat shtjellojnë kuptimin, objektin e martesës si dhe të drejtat e bashkëshorteve përmbahen në seksionet 1291-1921 të Kodit Civil Gjerman. Çështjet familjare janë të përkufizuara në seksionin 111 të ligjit mbi marrëdhëniet familjare. Gjykata kompetente është Gjykata e Qarkut e Shkallës së Parë, sipas seksionit 23a të Ligjit mbi Sistemin Gjyqësor. Këto çështje gjykohen vetëm nga një gjykatës dhe publiku është i ndaluar të marrë pjesë në gjykim.

Për sa i përket procedurës së shkurorëzimit, në vitet e fundit ligjvënësit gjermanë kanë krijuar disa procedura të përsheptuara.

Kështu, kërkesat kryesore, të cilat lidhen me procesin e shkurorëzimit janë si më poshtë vijon: Kërkuesi duhet të përfaqësohet nga një avokat sipas seksionit 114 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Familjare.²¹⁹ Aplikimi për shkurorëzim, duhet të përfshijë të dhëna si emrat dhe adresat e palëve, emri dhe adresa e gjykatës kompetente, si edhe shkaku që i ka çuar bashkëshortët në marrjen e vendimit për t'u ndarë, si edhe emrin dhe datën e lindjes së fëmijëve të mitur dhe adresën e tyre. Procedurat ligjore në lidhje me përkujdesjen e fëmijëve dhe të drejtat e vizitës zakonisht fillojnë me një aplikim pranë gjykatës kompetente. Në këtë lloj gjykimi duhet të dëgjohen zakonisht prindërit e fëmijëve dhe autoritetet, të cilat përkujdesen për mirëqenien e fëmijëve. Ligji gjerman mbi shkurorëzimin njih vetëm një arsye, e cila mund të merret parasysh në aplikime, për prishjen e martesës sipas seksionit 1565 të Kodit Civil Gjerman. Sipas shpjegimit të paraqitur në këtë seksion, bashkëshortët mund të aplikojnë për shkurorëzim vetëm nëse nuk ekziston më mundësia e pajtimit të tyre.²²⁰ Edhe pse në pamje të parë pozicioni gjerman mbi këtë çështje mund të shihet si më i ngushtë krahasuar me atë francez, duhet të merret parasysh se, sipas seksionit 1566 të Kodit Civil, ka disa prezumime në lidhje me dështimin e një martese, për shembull, në rast se çifti është ndarë fizikisht për një kohë të gjatë, në rast se njëri nga bashkëshortët ka problem mendore ose nëse evidentohen raste

²¹⁹ Marina Rupp (ed) Die Situation von Kindern in gleichgeschlechtlichen Lebenspartnerschaften (Bundesanzeiger Verlag, Berlin, 2009) F.28 e më tej

²²⁰ Po aty, F.30

të shumta tradhtie. Në fakt, këto prezumime ligjore e bëjnë pozicionin gjerman shumë të ngjashëm me atë francez.²²¹

Edhe regjimi i pronësisë është identik me atë francez, i cili i lejon bashkëshortëve zgjedhje të konsiderueshme në mënyrën se si do të ndahen pasuritë.²²² Ligji gjerman bazohet edhe mbi principin se çdo pronë e fituar përpara martesës i kthehet pronarit të mëparshëm, kurse pasuritë e fituara bashkërisht gjatë martesës ndahen në mënyrë të barabartë. Deri në vitet e fundit, koncepti i përgjegjësive prindërore përdorej vetëm në disa nene specifike në ligjin gjerman, por ai nuk ishte një koncept i njohur në Kushtetutën Gjermane. Në sajë të Rregullores Brussels II, ky koncept ka ndryshuar dhe në vitet e fundit, sipas praktikës gjyqësore mbas shkurorëzimit, prindërit janë bashkërisht përgjegjës për mbrojtjen, edukimin, sigurinë dhe zhvillimin e fëmijëve, si edhe për sigurimin e mjeteve financiare për jetesën e tyre.²²³

7.4 E drejta martesore në Itali

Sipas Kodit Civil Italian, martesa zgjidhet me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve dhe në rastet e parashikuara me ligj (neni 149 KCI). Efektet civile të martesës, të lidhur sipas rritit fetar, pushojnë me vdekjen e njërit bashkëshort dhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj. Ndarja personale e bashkëshortëve mund të bëhet me marrëveshje apo me procedurë gjyqësore (neni 150 KCI). Ndarja gjyqësore mund të bëhet në rastet kur vërtetohen faktet, pavarësisht nga vullneti i njërit apo të dy bashkëshortëve, fakte të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e bashkëjetesës apo që u shkaktojnë dëme të mëdha edukimit të fëmijëve. Me rastin e publikimit të vendimit, gjyqtari, në rast se ekzistojnë rrethanat dhe kur kërkohet, tregon se cili prej bashkëshortëve është fajtor për ndarjen.

Pajtimi i mundshëm ndërmjet bashkëshortëve çon deri te tërheqja (shuarja) e padisë së ndarjes personale të kërkuar. Në rastin e ndarjes personale, fëmija i mitur ka të drejtën e mbajtjes së një raporti të ekuilibruar dhe të vazhdueshëm me të dy prindërit, për t'u trajtuar me kujdes, edukuar dhe këshilluar nga të dy prindërit. Me vendimin e gjykatës mund të vendoset për besimin e fëmijës për rritje dhe edukim, vetëm njërit prej prindërve

²²¹ I. Sammut, "Family Law in the EU's Acquis Communautaire: Where is it Going?", University of Malta

²²² German Constitutional Court, judgment of 19 February 2013, 1 BvR 3247/09. See for an English translation Bundesverfassungsgericht "Judgment of 19 February 2013" (19 February 2013). Shih Gjithashtu Luise Hauschild "Abolition of Legal Discrimination and Implication of Highest-Court Case-law" in Bill Atkin (ed) International Survey of Family Law: 2013 Edition (Jordan Publishing, Bristol, 2013) 133

²²³ Po aty

dhe kundërshtimin e kujdesit të përbashkët (neni 155). Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë rishikimin e vendimit që u është besuar për rritje dhe edukim. Në bazë të këtij Kodi, përcaktimi i shtëpisë familjare dhe urdhëresat në lidhje me vendbanimin, bëhet duke i dhënë përparësi interesave të fëmijëve. Dispozitat në favor të fëmijëve madhorë i japin tagër gjyqtarit që pas vlerësimit të rrethanave, të marrë vendim në favor të fëmijëve madhorë, atyre që nuk janë ta pavarur ekonomikisht; pastaj të vendosë në lidhje me pagimin e një shume periodike për fëmijët me të meta fizike apo mendore, - raste për të cilat zbatohen dispozitat në favor të fëmijëve të mitur. Para marrjes së vendimit, gjyqtari mund të vendosë për dëgjimin e fëmijës së mitur që ka mbushur moshën dymbëdhjetë vjeç apo edhe në moshë më të vogël, nëse është i aftë për të gjykuar dhe mbi këtë bazë do të merret edhe vendim në lidhje me çështjen kontestuese.

Regjimi i së drejtës martesore në shtetin italian përmbahet në nenet 1-455 të librit të parë të Kodit Civil. Në këto nene përmbahen dispozita, të cilat mbulojnë çështje si familja, martesa, të drejtat e detyrimit e bashkëshortëve dhe regjimi i pronësisë. Procedurat e shkurorëzimit përmbahen në nenet 150-158 të Kodit Civil, ndërsa rregullat mbi mirëqenien e fëmijëve përmbahen në nenet 315-337 dhe në rastin e shkurorëzimeve në nenin 338 të Kodit Civil. Procedurat e ndarjes, shkurorëzimit dhe mirëmbajtjes së fëmijëve zhvillohen përpara divizioneve të posaçme në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të shkallës së parë.²²⁴ Sipas neneve 1 dhe 2 të ligjit italian mbi shkurorëzimin, i cili është i aplikueshëm në rastin e martesave civile si dhe martesave fetare, arsyeja e vetme për divorc është përfundimi i unitetit martesor dhe shpirtëror midis bashkëshortëve, i cili determinohet nga ekzistenca e një prej kriterëve, të cilat mund të gjenden të listuara në nenin 3. Një analizë e thjeshtë e këtyre kriterëve tregon qartësisht se pozicioni italian mbi këtë çështje, pothuajse i njëjtë me pozicionin e marrë nga ligjvënësit francezë dhe gjermanë. Brenda kuadrit ligjor italian nuk ekziston një përkufizim i qartë i konceptit të përgjegjësisë prindërore. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ky koncept, sipas jurisprudencës së gjykatave italiane, përmban të drejta dhe detyrime që mund të kenë prindërit dhe për të cilat janë përgjegjës ndaj fëmijëve.²²⁵ Thelbi i këtij autoriteti prindëror kërkon që në rastin e shkurorëzimeve prindërit të jenë bashkërisht përgjegjës për mirëqenien morale dhe materiale të fëmijës. Praktikisht, në

²²⁴ M. Panforti & C. Valente, Comparative study on enforcement procedures of family rights” Department of Linguistic and cultural Studies, University of Modena

²²⁵ Kodi Civil Italian, Artikulli 5

raste shkurorëzimi, prindërit duhet të sigurohen bashkërisht, por duke marrë parasysh dhe mundësitë ekonomike, që fëmijëve t'u garantohen të drejtat e parashikuara në ligjin e posaçëm italian për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në rastet, kur në procedurat e shkurorëzimit është i aplikueshëm ligji italian, gjykatat nuk gëzojnë kompetencën që të vendosin mbi ndarjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Në këtë rast gjykata mund të vendosë vetëm mbi kujdestarinë mbi fëmijët dhe i kalon në pronësi shtëpinë familjare bashkëshortit, të cilit i jepet kujdestaria. Nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë, gjykatës i ndalohej t'i japë pronësinë e shtëpisë familjare bashkëshortes, nëse ky vendim arrihet mbi arsyetimin se bashkëshortja është më e pafavorizuar. Këtu mund të vihet re evolucioni i perceptimit të marrëdhënieve midis bashkëshortëve. Siç ishte rasti edhe në Francë, në Itali, gjatë viteve të fundit, nuk aplikohet më ideja se bashkëshortja ndodhet në një pozicion më pak të favorshëm mbas procedurës së shkurorëzimit dhe se për këtë fakt ajo meriton një mbrojtje më të madhe ligjore krahasuar me bashkëshortin. Nëse pasuritë dhe pronat janë në pronësinë e përbashkët të dy bashkëshortëve, atëherë ato ndahen sipas rregullave të zakonshme mbi ndarjen e pronave të përbashkëta.

7.5 E drejta martesore në Angli dhe Uells

Ndryshe nga shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Europian, kuadri ligjor i të cilave u analizua në seksionet më sipër, në Angli dhe Uells nuk ekziston një sistem i kodifikuar ligjor. Baza e sistemit ligjor në Angli dhe Uells përbëhet nga e drejta zakonore, i cili është zhvilluar nga praktika gjyqësore ndër vite dhe më pas është përfshirë në legjislacion. Akti i Çështjeve Matrimoniale i vitit 1973 është legjislacioni kryesor, i cili rregullon procedurën e shkurorëzimit dhe regjimit pasuror. Akti i Fëmijëve i vitit 1989 është legjislacioni kryesor i së drejtës familjare, për sa i përket trajtimit të fëmijëve. Seksioni 31A IPFA 1984 përcakton se çdo çështje gjyqësore, e cila lidhet me martesën ose shkurorëzimin është kompetencë e gjykatave të familjes. Kuadri ligjor i aplikueshëm në lidhje me procedurat e shkurorëzimit përmbahet gjerësisht në Aktin Reformues të Divorcit i vitit 1969. Përmbajtjet e këtij Akti janë mjaft domethënëse duke qenë se të gjitha shkaqet e mëparshme për shkurorëzim u zëvendësuan me një të vetëm, posaçërisht me prishjen e martesës. Sidoqoftë, kjo prishje duhet të provohet nga ekzistenca i një nga

pesë shkaqeve të parashikuara në këtë akt.²²⁶ Në lidhje me regjimin pasuror të aplikueshëm, në raste kur bashkëshortët aplikojnë për procedurën e shkurorëzimit, vlen të përmendet se akti i martesës nuk ka asnjë efekt ligjor mbi pronësinë e pasurive të bashkëshorteve, kështu që çdo pasuri e blerë përpara martesës ose gjatë martesës qëndron në pronësi të bashkëshortit, i cili ose e cila e ka blerë atë send, përveç në rastet kur bashkëshortët kanë vendosur të blejnë një send ose pasuri në mënyrë të përbashkët. Gjatë procedurave të divorcit, gjykatat gëzojnë kompetenca të gjera për të vendosur mbi rishpërndarjen e pasurisë duke marrë parasysh disa kritere, të cilat garantojnë një proces të drejtë. Kriteret e lartpërmendura përmbahen në seksionin 25 të Aktit për Divorcin dhe përfshije çështje si situata financiare e secilit prej bashkëshorteve, nevojat e tyre financiare, standardi i jetesës, mosha e secilit prej bashkëshortëve, kapacitetet e tyre fizike e mendore, sjellja e bashkëshortëve gjatë martesës dhe kontributet monetare të secilës palë gjatë martesës.

7.6 Martesa midis çifteve homoseksuale: perspektiva europiane

Më 6 qershor 2016, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendosi mbi çështjen e Chapin Charpentier k. Francës (N. 40183/07).²²⁷ Objekti i këtij gjykimi lidhej me vendimin e gjykatës franceze të apelit për të anuluar një martesë të nënshkruar në vitin 2004 midis dy meshkujve, me arsyetimin se kjo martesë nuk ishte e lejuar sipas ligjit francez. Me anë të këtij vendimi, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut konsolidoi pozicionin e saj mbi ligjshmërinë e martesave midis dy personave të të njëjtit seks duke parashtruar se nenet 8 dhe 12 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk përfshijnë të drejtën e martesës për çiftet e seksit të njëjtë. Konkretisht, ky vendimin i ri konfirmon një listë të gjatë vendimesh të mëparshme duke rithekshuar se çështja e ligjshmërisë së martesës midis dy personave të seksit të njëjtë është subjekt i ligjeve kombëtare të shteteve anëtare, duke iu referuar çështjes Schalk & Kopf k. Austrisë (N. 301141/04).²²⁸

Neni 12 konfirmon se koncepti tradicional i martesës, i cili nënkupton bashkimin midis një mashkulli dhe një femre, nuk krijon ndonjë detyrim i cili duhet të zbatohet nga qeveritë e shteteve anëtare për t'iu dhënë mundësi çifteve homoseksuale në institutin e

²²⁶ Shkaqet e listuara janë pothuajse të njëjta me ato të përmbajtura kë kodin Civil Francez

²²⁷ Chapin & Charpentier k. Francës (N.40183/07)

²²⁸ Schalk & Kopf k. Austrisë (N.301141/04)

martesës (duke iu referuar çështjes Gas & Dubois k. Francës (N 25951/01). Gjykata më tej sqaroi se Neni 12, i cili garanton të drejtën e respektit për jetën familjare dhe private, nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që t'u japë çifteve homoseksuale të njëjtat të drejta me çiftet e martuara. Në këtë pikë, Gjykata u bazua mbi vendimin e çështjes Oliari e të tjerë k. Italisë,²²⁹ çështje që imponon limite në interpretimin e të drejtave të garantuara në Nenin 8 dhe 12 të Konventës. Ky vendim është mjaft domethënës dhe rritetson principin se regjimet e të drejtës familjare dhe të drejtat, që burojnë nga ky regjim, janë kompetencë kryesore e shteteve anëtare.²³⁰ Belgjika, Franca, Gjermania, Irlanda, Norvegjia, Portugalia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar, iu ofrojnë këtyre çifteve mundësinë për t'u martuar.

²²⁹ Oliari e të tjerë k. Italisë (N.142394/3)

²³⁰ Po aty

KAPITULLI VIII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIMET

7.1 Përfundime

1. Duket se KFSH është diskriminues në aspektin gjinor, në lidhje me mbiemrin e fëmijëve gjatë dhe pas zgjidhjes së martesës.
2. LFK nuk përcakton regjimin martesor me kontratë.
3. LFK mbron më tepër interesin e fëmijëve dhe të gruas, sepse nuk lejon paraqitjen e padisë kur gruaja është shtatzënë dhe fëmija nuk ka mbushur një vit.
4. KFSH siguron mbrojtje më të mirë në lidhje me ushqimin e bashkëshortëve pas shkurorëzimit.
5. Në Kosovë dhe pjesërisht në Shqipëri nuk ka gjyqtar apo departamente të specializuara që merren ekskluzivisht me shqyrtimin e çështjeve familjare.
6. LFK përcakton mundësinë që trashëgimtarët të vazhdojnë procedurën e filluar të shkurorëzimit, ndërsa KFSH nuk e parashikon një mundësi të tillë.
7. KFSH, përmes Nenit 127 përcakton në mënyrë taksative se çka duhet të përmbajë marrëveshja, e cila rregullon pasojat juridike të shkurorëzimit, duke përcaktuar se ajo duhet të përmbajë edhe: a)- lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve ; b)- të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre ; c)- kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe d)- rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve. Ndërsa, në dallim nga KFSH, LFK, përmes Nenit 70 përcakton se bashkëshortët janë të detyruar që, së bashku me kërkesën për shkurorëzim, me pëlqim të dyanshëm, të paraqesin me shkrim edhe marrëveshjen për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre, si edhe propozimin për kontaktet personale midis fëmijës dhe të dy prindërve. Rrjedhimisht, KFSH paraqitet më i plotë në lidhje me pasojat juridike të shkurorëzimit me marrëveshjen e të dy bashkëshortëve.
8. Sipas KFSH-së, bashkëshortët kanë mundësi që, në propozimin e tyre për shkurorëzim me marrëveshje, të parashikojnë edhe mënyrën e ndarjes së pasurisë, gjë që dallon nga LFK, i cili nuk e parashikon një mundësi të tillë.
9. KFSH mban ende qëndrimin se fajësia për shkurorëzim duhet të prodhojë pasoja të caktuara juridike, ndërsa LFK ka hequr dorë nga ky koncept.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i institutit të shkurorëzimit dhe në veçanti, i pasojave juridike, që lindin, rezulton se:

Pasuria e përbashkët paraqet një sfidë me të cilën ballafaqohen bashkëshortët në rastin e realizimit të kësaj të drejte ligjore. Institucionet, shoqëria civile dhe gjykatat, në të ardhmen, duhet të kontribuojnë në drejtim të realizimit të të drejtave pasurore të bashkëshortes. Çështja që duhet shtruar lidhur me pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, është mohimi, si edhe paraqitja e pengesave në pjesëtimin e kësaj pasurie, kryesisht, nga ana e bashkëshortëve burra kundër grave.

Nga hulumtimi praktik i rasteve të divorcit, raste që kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave të fëmijëve në detyrimin ushqimor, kontaktet (vizitat) dhe mosdhënia e pëlqimit për nxjerrjen e dokumenteve, vihet re mungesa e kujdesit të prindërve ndaj fëmijëve të tyre. E drejta në ushqimi dhe ajo për kontaktimin e fëmijëve, të cilët jetojnë të ndarë nga prindërit e tyre apo vetëm me njërin prind, ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre. Përkundër detyrimit ligjor të prindërve, për t'iu siguruar fëmijëve të tyre kushte normale për jetesë, duke iu paguar ushqimin, në disa raste vihet re se ata i shmangen këtij detyrimi. Në rastin e divorcit, në më të shumtën e rasteve, fëmijët e mitur iu besohen për ruajtje, kujdes dhe edukim nënave dhe më pak baballarëve. Nga rastet praktike gjyqësore, të analizuara në këtë studim, shihet se numri i prindërve, që detyrohen të paguajnë ushqimin për fëmijët e tyre është i vogël dhe kur kësaj i shtojmë edhe faktin se nga ky numër i vogël, disa prindër i shmangen përsëri pagesës së ushqimit, duket qartë se kështu rrezikohet shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve. Ashtu sikurse iu cenohet e drejta e ushqyerjes, fëmijëve u cenohet edhe e drejta e kontaktit (e vizitës), por në këto raste kjo ndodh nga ana e prindit, të cilit i është besuar fëmija për përkujdesje. Nga rastet e paraqitura, të drejtat e fëmijëve cenohen nga prindërit, që nuk i kanë në përkujdesje, kur flitet për detyrimin e tyre ushqimor, ndërsa në lidhje me të drejtën e kontaktit, ajo cenohet nga prindi, i cili jeton me fëmijën. Edhe pse rastet e mosdhënies së pëlqimit nga ana e prindit për nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit apo të daljes së fëmijës jashtë vendit janë në numër më të vogël, ato flasin për cenimin e të drejtës së fëmijës për lëvizjen e lirë. Nga rastet e analizuara rrjedh se këto veprime të prindërve ndaj fëmijëve ndodhin kryesisht për shkak të keqësimit të raporteve bashkëshortore.

Çështja e barazisë gjinore paraqet një sfidë si për shoqërinë kosovare, ashtu edhe për gratë, të cilat me përballen me rastet e realizimit të të drejtave të tyre ligjore lidhur me trashëgiminë dhe pasurinë. Rastet e trajtimit të lëndëve trashëgimore dhe të pjesëtimin të

pasurisë së përbashkët, tregojnë se gratë, janë ato që nuk i realizojnë dot të drejtat e tyre trashëgimore dhe pasurore.

Kosova ka ndërtuar një infrastrukturë të avancuar ligjore që siguron mbrojtjen e të drejtave të grave, por në praktikë dhe në veçanti, në të drejtat trashëgimore dhe pasurore, gratë janë në një gjendje të pafavorshme. Hulumtimet tregojnë se rregullimi i marrëdhënieve trashëgimore dhe pronësore në këtë periudhë ka pësuar ndryshime të rëndësishme në aspektin e nxjerrjes së legjislacionit vendor në harmoni me konventat dhe të drejtën ndërkombëtare. Ndryshimet e ndodhura kanë ndikuar në paraqitjen e marrëdhënieve të reja edhe në familjet tona, andaj rregullimi i këtyre raporteve me norma ligjore është paraqitur si një nevojë e këtyre raporteve dhe rrethanave të ndryshuara në Kosovë. Ligji i Trashëgimisë, i Familjes, i Barazisë Gjimore, paraqesin risi në rregullimin e marrëdhënieve trashëgimore dhe pronësore midis trashëgimtarëve dhe bashkëshortëve, si edhe anëtarëve tjerë të bashkësisë familjare.

Në disa raste praktike, gjykatat nuk kanë arritur dot që ta zhvillojnë procedurën gjyqësore në mënyrën e duhur, si në rastet e shkurorëzimit, edhe të detyrimit ushqimor. Ky dështim vjen nga mosrespektimi i dispozitave ligjore, por edhe i standardeve ndërkombëtare e në veçanti, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KEDNJ), si edhe të Konventës Për të Drejtat e Fëmijëve (KDF). Dështimet janë evidente në menaxhimin e lëndëve dhe posaçërisht në lidhje me dorëzimin e ftesave te palët në procedurë. Neni 6 i KEDNJ parashikon që lëndët të zgjidhen brenda një afati të arsyeshëm. Në një rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar se ky kusht lidhet me rëndësinë e dhënies së drejtësisë pa vonesa, se ndryshe mund të rrezikohet besueshmëria dhe efikasiteti i saj.²³¹ Neni 6 i Konventës parashikon se të gjitha procedurat, si ato civile edhe ato penale, duhet të përfundojnë brenda një kohe të arsyeshme. GjEDNJ ka përcaktuar se periudha e arsyeshme e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të veçanta të rastit, duke pasur parasysh karakterin e ndërlikuar të çështjes, si edhe sjelljen e parashtruesit të kërkesës dhe autoriteteve kompetente.²³² Organet shtetërore, institucionet, shoqëria civile dhe gjykatat, në të ardhmen, duhet të kontribuojnë në drejtim të realizimit të të drejtave trashëgimore dhe pasurore të trashëgimtareve femra dhe për respektimin e parimit të barazisë gjimore.

²³¹ Konig kundër Gjermanisë, GjEDNJ, aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 96.

²³² H kundër Francës, GjEDNJ, aktgjykimi i datës 24.10.1989, paragrafi 50.

7.2 Rekomandime

Në mbyllje të këtij studimi ne rekomandojmë që:

Në Kosovë të fillojë ndryshimi i Ligjit për Familjen, i Ligjit për Gjykatat, si edhe Kodi i Familjes në Shqipëri - me qëllim që, në kuadër të gjykatave themelore, të formohen divizione apo nëndivizione të veçanta për të drejtën familjare, të cilat do të trajtonin lëndët që kanë të bëjnë me shkurorëzimet, por edhe lëndët e tjera statusore.

Me Nenin 70, paragrafi 1, të Ligjit për Familjen në Kosovë parashikohet se “bashkëshortët nuk do të parashtrojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët të këtë mbushur një vit”. Mendojmë se ky nen duhet të ndryshohet dhe fjala “nuk do të”, duhet të zëvendësohet me fjalën “nuk mund”, në mënyrë që të jetë e qartë se, gjatë kësaj periudhe, bashkëshortët nuk mund të parashtrojnë padi për shkurorëzim. Gjithashtu kjo dispozitë duhet të aplikohet edhe te rastet e shkurorëzimit me marrëveshje, sepse pasojat, pavarësisht se është fjala për shkurorëzim me marrëveshje apo shkurorëzim me padi, janë të njëjta.

Neni 80, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen në Kosovë parashikon se “nëse bashkëshortët kanë një apo më shumë fëmijë të mitur, të përbashkët, procedura e pajtimit zhvillohet para Organit të Kujdestarisë, duke zbatuar metodat e punës sociale, metodat e tjera profesionale dhe duke shfrytëzuar shërbimet e këshillimores për martesë dhe familje, si edhe të institucioneve tjera profesionale. Mendojmë se neni në fjalë duhet të ndryshohet me qëllim që të përcaktohet në mënyrë specifike se kur e zhvillon procedurën e pajtimit Gjykata dhe kur e zhvillon Organi i Kujdestarisë, pasi në praktikë ka dilema dhe mospërputhje në aplikimin e kësaj dispozite.

Të ndryshohet Neni 83, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen në Kosovë, i cili parashikon periudhën 3 mujore të zgjatjes së procedurës së pajtimit pranë Organit të Kujdestarisë, me mundësi të zgjatjes së këtij afati, nëse bashkëshortët pajtohen, që një procedurë e tillë të vazhdojë edhe më tej. Kjo për shkakun se në praktikë, ky afat ka rezultuar të jetë tejet i gjatë dhe jo i efektshëm, sidomos në kuptimin e mbrojtjes së interesave sa më të mira të

fëmijëve, të cilët eventualisht mund të jenë të përfshirë në procedurë. Mendojmë se i njëjti afat duhet të jetë i caktuar në mënyrë të saktë dhe jo të thuhet se nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, pasi në praktikë ky afat nuk zbatohet pothuajse asnjëherë nga Organi i Kujdestarisë; Të ndryshohet Neni 89 i Ligjit për Familjen në Kosovë, sipas të cilit “pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkohet si gjatë martesës edhe pas mbarimit të saj me shkurorëzim.” Ndryshimi i këtij neni propozojmë të bëhet në atë mënyrë me qëllim që të parashikohet mundësia që bashkëshortët, me propozimin e përbashkët për zgjidhjen e martesës, të rregullojnë edhe çështjen e ndarjes së pasurisë së përbashkët bashkëshortore. Në Ligjin për Familjen në Kosovë të përfshihen dispozitat e Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë për regjimin martesor me kontratë.

Të ndryshohet titulli i Nenit 144 të Ligjit për Familjen në Kosovë, pasi që ky nen aktualisht është i titulluar “Shqyrtimet e Gjykatës”, ndërsa në përmbajtjen e tij bëhet fjalë edhe për Organin e Kujdestarisë.

Të saktësohet akoma më shumë Neni 145, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen në Kosovë, i cili parashikon se “gjykata kompetente përsëri mund të rregullojë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijët, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara.” Mendojmë se neni në fjalë, me mënyrën se si është formuluar, del të jetë një formulim jo i rregullt, pasi nuk thuhet se kur mund ta bëjë këtë gjë gjykata, domethënë, pasi të vendosë njëherë për kontaktet personale apo kur?

Të plotësohet Neni 70 i LFK-së, në analogji me Nenin 127 të KFSH-së, për sa i përket përmbajtjes së Marrëveshjes për Shkurorëzim, në atë mënyrë që pjesë e marrëveshjes të jetë edhe rregullimi i raporteve pasurore të bashkëshortëve.

Të ndryshohet Neni 52 i KFSH-së, në atë mënyrë që, në rast të mosmarrëveshjeve midis prindërve, mbiemri i fëmijës të caktohet nga Organi i Kujdestarisë.

Të ndryshohet Neni 171 i KFSH-së, në atë mënyrë që për fëmijët e lindur jashtë martese, në rast të mosmarrëveshjeve midis prindërve, mbiemri të caktohet nga Organi i Kujdestarisë. Në KFSH të përfshihen dispozitat e Nenit 70të LFK-së, paragrafi 1, sipas të

cilit palët nuk mund të paraqesin padi përderisa gruaja është shtatzënë dhe fëmija nuk ka mbushur një vit. Në KFSH të përfshihen edhe dispozitat që lejojnë trashëgimtarët të vazhdojnë procedurën e shkurorëzimit.

Në përfundim, duke u bazuar në konkluzionet e dala nga ky studim, do të jepnim rekomandimet e mëposhtme, rekomandime, të cilat iu drejtohen të gjithë aktorëve kryesorë që merren me rastet familjare-statusore (gjyqtarë, Organi i Kujdestarisë, punonjës socialë, psikologë, sociologë etj.).

Në radhë të parë një rekomandim për të gjithë gjyqtarët, të cilët punojnë me çështjet civile në çështjet statusore – familjare, të cilët ballafaqohen çdo ditë me raste të tilla në punën e tyre të përditshme.

Në praktikën e tyre të zgjidhjes së çështjeve statusore familjare rekomandohet të marrin në konsideratë mundësinë e ruajtjes së martesës si institucion shumë i rëndësishëm në shoqëri, duke marrë për bazë komentet e këtij studimi. Meqenëse zgjidhja e martesës është e lejuar me ligjet në fuqi, nuk duhet kuptuar se duke iu dhënë gjyqtarëve këtë rekomandim synohet të ndalohet shkurorëzimi, por thjesht synohet që të ketë një numër sa më të vogël martesash të shkurorëzuara.

Për gjyqtarët dhe në përgjithësi, për organet e drejtësisë, rekomandojmë që gjatë shqyrtimit të këtyre rasteve të kenë parasysh dispozitat ligjore, ku thuhet se “në këto konteste nuk mund të jepet aktgjykimi në bazë të pohimit dhe aktgjykimi për shkak të mungesës, siç mund të ndodhë në procedura tjera kontestuese”, sepse gjatë studimit u vu re se nga statistikat zyrtare të KGJK-së, ka raste kur vendoset edhe me aktgjykim në bazë të pohimit, edhe me aktgjykim për shkak të mungesës, edhe pse një gjë e tillë është e ndaluar sipas dispozitave ligjore. Një rekomandim edhe për Akademinë e Drejtësisë, e cila organizon trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët, që ajo të organizojë më shumë trajnime në këtë drejtim, lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave ligjore.

Zgjidhja e martesave me shkurorëzim, si një mënyrë e zgjidhjes së martesës së vlefshme, ka pasoja të mëdha juridike. Ky studim propozon një mënyrë të thjeshtë, që të gjitha

institucionet t'i kushtojnë një rëndësi më të madhe zgjidhjes së martesës në përgjithësi dhe sidomos pasojave të saj, në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur.

Rekomandimet iu drejtohen edhe Qendrave të Punës Sociale – organeve të kujdestarisë, roli i të cilëve është shumë i madh në rastet familjare, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me fëmijë të mitur.

Një rekomandim iu drejtohet edhe punonjësve socialë të organeve të kujdestarisë. Hartimi i raporteve të tyre në rastet e zgjidhjes së martesave me fëmijë të mitur, nuk duhet konsideruar vetëm së një punë e tyre rutinë, por duhet të bëhet me përkushtimin sa më të madh dhe me hulumtimin e të gjitha rrethanave të secilit rast konkret, duke pasur parasysh në rend të parë interesin më të mirë të fëmijëve të mitur, sepse pasojat e zgjidhjes së martesës ndikojnë në një masë të madhe në mirërritjen e tyre, për shkak të moshës së tyre.

Rekomandimi i fundit i takon punës së mëtejshme, e cila duhet të konsistojë në radhë të parë në bashkëpunimin e të gjithë institucioneve shtetërore, të cilat janë kompetente në rastet e shkurorëzimeve, për zgjidhjen sa më të mirë të secilit rast konkret.

BIBLIOGRAFIA

LITERATURA

I. BURIME PARËSORE

1. Deklarata për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas, OKB, Rezoluta 2263 (XX II) datë 7.11.1967
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së Kanuni i Lekë Dukagjinit, Rilindja, Prishtinë, 1995 Kodi Civil i vitit 1929 i Mbretërisë Shqiptare
3. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, nr. 90/62 të datës 08.05.2003 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut 1950
4. Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, 1996
5. Konventa për të drejtat e fëmijëve, 20 nëntor 1989
6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
7. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 8417/21.10.1998
8. Ligji kundër diskriminimit i Kosovës, Ligji nr. 2004/3
9. Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 10/84
10. Ligji mbi procedurën kontestimore i Kosovës, 2008, Ligji nr. 03/L-006
11. Ligji për barazi gjinore i Kosovës, Ligji. Nr. 2/2004
12. Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji nr. 2004/32
13. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje i Kosovës, Ligji nr. 03/L-182
14. Ligji për procedurën jokontestimore i Kosovës, 2008, Ligji nr. 03/L-110
15. Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, Ligji nr. 03/L-154
16. Ligji për shërbime sociale dhe familjare i Kosovës, Ligji nr. 02/L-17
17. Ligji për trashëgiminë i Kosovës, Ligji nr. 2004/26

II. BURIME DYTËSORE

1. Alinçiq, Mira, Hrabor, Dubravka, Jakovac –Lloziq, Dijana dhe Graovac, Aleksandra, Zagreb, 2007
2. Aliu, Abdulla, Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë 2007
3. Allinçiq, Mira dhe Bakariç-Mihanoviç, Ana, Porodiqno pravo, Zagreb, 1980
4. Amram, M., D'Angelo, A., . La famiglia e il diritto fra diversità nazionali e l'iniziativa dell'Unione Europea, Milano: Cedam, 2011
5. Ardian, Nani, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë 2009
6. Babiq, Ilija, “Komentar Porodicnog Zakona”, Sluzbeni Glasnik, Beograd, 2014
7. Begeja, Santhipi, “E drejta familjare e Shqipërisë”, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 1985
7. Berisha, Ruzhdi, Detyrimi Ligjor për ushqim, IGJK, Prishtinë, 2012
8. Biavati, Paolo, Lupoi, Michele Angelo, Shtino, Redi Nazim, “E Drejta Procedurale Civile Europiane”, Geer, 2010
9. Bilali, Asllan dhe Bahtiri, Bedri, E Drejta Romake, Prishtinë, 2015
11. Blagojeviq, Borislav dhe autorë të tjerë, “Pravna Enciklopedija I”, Savremena Administracija, Beograd, 1985
10. Blagojeviq, Borislav dhe autorë të tjerë, “Pravna Enciklopedija II”, Savremena Administracija, Beograd, 1985
11. Bordas, Bernadet, Porodicni pravni odnosi u medunarodnom privatnom pravu, Novi Sad, 2000
12. Brestovci, Faik, E Drejta e Procedurës Civile, Prishtinë, 2000
13. Çalija, B., Gragjansko procesno pravo, Sarajevo, 1986
14. Choudry & Herring, “European Human Rights and Family Law”, Bloomsbury UK, 2010
15. European Parliament “Citizen's Rights and Constitutional Affairs –Which basis for Family Law? The Way Forward” Note from the European Parliament, 2012
16. Council Regulation (EC) No 1347/2000 of 29 May 2000 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in matrimonial matters and in matters of parental responsibility for children of both spouses.
17. Marina Rupp (ed) Die Situation von Kindern in gleichgeschlechtlichen Lebenspartnerschaften (Bundesanzeiger Verlag, Berlin, 2009)

18. I. Sammut, "Family Law in the EU's Acquis Communautaire: Where is it Going?", University of Malta
19. German Constitutional Court, judgment of 19 February 2013, 1 BvR 3247/09. See for an English translation Bundesverfassungsgericht "Judgment of 19 February 2013" (19 February 2013) .
20. Luise Hauschild "Abolition of Legal Discrimination and Implication of Highest-Court Case-law" in Bill Atkin (ed) International Survey of Family
21. M. Panforti & C. Valente, Comparative study on enforcement procedures of family rights" Department of Linguistic and cultural Studies, University of Modena
22. Chapin & Charpentier k. Francës (N.40183/07)
23. Schalk & Kopf k. Austrisë (N.301141/04)
24. D'Angelo, A. La famiglia e il diritto fra diversità nazionali e l'iniziativa dell'Unione Europea, Milano: Cedam, 2011
25. Djupe & Gilbert, "The political Influence of Churches" Cambridge University Press, 2008
26. Eudier, Federicue, Druit dela familje Armand Colin, Paris 1999
27. European Parliament "Citizen's Rights and Constitutional Affairs –Which basis for Family Law? The Way Forward" Note from the European Parliament Fantetti, F., Diritto di famiglia e diritti dei familiari, 8 ed. Rimini: Maggioli. 2011
28. Filipescu, I., Tratat de Dreptul familiei, Bukuresht: ALL., 1995
29. Fromant Michel, Sistemet e huaja më të mëdha të së drejtës, Tiranë, 2005
30. Galgano, Francesco, E Drejta Private, Tiranë, 1999
31. Gashi, Haxhi, Aliu, Abdulla, Vokshi, Adem, "Komentar i Ligjit të Kosovës për Familjen", 2012
32. Gega, Klodian dhe Hasani, Naureda, "Psikologu dhe Punonjësi Social në Drejtësinë për të Miturit", botim i Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara Klinika Ligjore për të Mitur, Tiranë, 2012
33. Georgievski, S., Gragjansko procesno pravo, Skopje. 2000
34. Goirovki-Tripinovska Liljana, Cemejeno pravo NIP Studensk izbor, Skopje 1997
28. Guyisaac-Marc, Blamquet, Modern Family Law - cases and materials" Law Aspen Law&Business, New York, 1998
35. Gjata, Rustem, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë 2010

36. Idrizi Nehat, Sallauka, Lumni, Totaj, Valon, Zogaj, Albert, “Moduli Drejtësia për Fëmijë, Aspekti Civil”, IGJK, Prishtinë, 2014
37. Janković, Milka, Janković, Zivota, Komentar Zakona o Parnicnom Postupku, Beograd, 1990
38. Janjić-Komar, Marina, Korać, Radoje, Ponjavić, Zoran, “Porodичno Pravo”, Beograd, 1999
39. Kondili, Valentina, E Drejta Civile I, Pjesa e përgjithshme, Geer, 2008
40. Kondili, Valentina, E Drejta Civile II, Pjesa e Posaçme, Geer, 2008
41. Luarasi, Aleks, Marrëdhëniet familjare, Tiranë, 2001
42. Majstorovic, Irena, Bracni Ugovor, Zagreb, 2005
43. Mandro, Arta, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009
44. Marina, Janiq, - Komar, Radoje, Korać, Zoran, Ponjavić, Porodичno pravo, Beograd, 1999
45. Marko, Mlladenović, Razvod Braka i uzrociza razvod braka, Beograd, 1974
43. Martin, Antonio- Peter Kluric, Gradjansko pravo, Zagreb, 1998
46. Morina, Izet dhe Nikçi, Selim, “Komentar i Ligjit për Procedurën Kontestimore”, Prishtinë, 2012
47. Omari, Sonila, E Drejta Familjare, Tiranë 2012
48. Oruçi Gani, “E Drejta Familjare - Ligjëratat të autorizuara”, Prishtinë, 1994
49. OSBE, Gjykimi i rasteve familjare në Kosovë: Çështjet lidhur me menaxhimin e lëndëve, 2011
50. Picard & Berman, “Introduction to French Law” Kluwer Law International, 2008
51. Podvorica, Hamdi dhe Podvorica, Fatlum, Klinika Juridike – E Drejta Familjare dhe Trashëgimore, Prishtinë, 2015
52. Podvorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005
53. Podvorica, Hamdi, Pengesat dhe ndalesat martesore, E drejta nr./5 Prishtinë Poznic, Borivoje, Komentar Zakona o Parnicnom Postupku, Beograd, 2009
54. Puhan, Ivo, E Drejta Romake, Prishtinë, 1980
55. Shala, Muharrem, Zogaj, Albert, Totaj, Valon dhe Leku, Zenel, “Doracaku i Gjyqtarëve për Procedurën Kontestimore”, IGJK-USAID-EROLL, Prishtinë, 2015
56. Traljić, Nerimana dhe Bubić, Suzana, Porodичno pravo, Sarajeva 1991
57. Vasili, Jani, Procedura Civile, Tiranë 2010
58. Zaçe, Valentina, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar, Tiranë 1999

III. VENDIME GJYQËSORE

1. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr., 1370, datë 21.06.2013
2. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr., 418, datë 27.11.2013
3. Gjykata Komunale në Gjilan, vendimi nr., 623, datë 21.12.2009
4. Gjykata Komunale në Pejë, vendimi nr., 1077, datë 10.09.2007.
5. Gjykata Themelore në Gjilan, vendimi nr., 787, datë 10.06.2013
6. Gjykata Komunale në Prishtinë, vendimi nr., 1176, datë 18.06.2012
7. Gjykata Komunale në Glllogoc, vendimi nr., 147, datë 24.09.2009
8. Gjykata Komunale në Podujevë, vendimi nr., 242, datë 10.08.2006
9. Gjykata Komunale në Prishtinë, vendimi nr., 389, datë 07.05.2004
10. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr., 1847, datë 12.09.2013
11. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi, nr. 158/2011, datë 11.07.2011
12. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 102/2011, datë 07.03.2011
13. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 76/2012, datë 08.05.2012
14. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 72/2010, datë 31.01.2012
15. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 60/2012, datë 08.05.2012
16. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 370/2012, datë 21.11.2012
17. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 235/2012, datë 23.10.2012
18. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 160/2012, datë 23.10.2012
19. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 136/2012, datë 24.09.2012
20. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 92/2012, datë 23.10.2012
21. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 558/2011, datë 12.12.2011
22. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 310/2010, datë 15.09.2010
23. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 322/2011, datë 18.11.2011
24. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 235/2012, datë 24.09.2012
25. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 47/2012, datë 23.10.2012
26. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 30/2011, datë 12.03.2012
27. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 310/2010, datë 15.09.2010
28. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 306/2011, datë 12.10.2011
29. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 175/11, datë 01.11.2011
30. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 306/2010, datë 16.02.2011
31. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 158/2010, datë 30.09.2010

32. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 111/2010, datë 29.07.2010
33. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 71/2009, datë 24.09.2010
34. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 47/2010, datë 22.12.2011
35. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, vendimi nr. 18/2011, datë 07.02.2011
36. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 1543/13, datë 11.09.2013
37. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 91/13, datë 13.12.2013
38. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 2457/13, datë 22.11.2013
39. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 523/12, datë 28.05.2013
40. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 369/13, datë 30.09.2013
41. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 72/12, datë 18.06.2013
42. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 53/12, datë 23.10.2013
43. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 51/13, datë 17.04.2013
44. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 3089/13, datë 27.11.2013
45. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 6/11, datë 06.11.2013
46. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 342/11, datë 07.11.2013
47. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 6/13, datë 07.11.2013
48. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 70/12, datë 03.12.2013.
49. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 414/12, datë 26.06.2014
50. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 310/12, datë 18.09.2013
51. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 25/12, datë 13.02.2013
52. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 291/05, datë 10.10.2013
53. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 563/10, datë 06.11.2013
54. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 458/11, datë 21.09.2013
55. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 221/12, datë 02.07.2014
56. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 30/13/11, datë 21.10.2013
57. Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimi nr. 416/12, datë 03.07.2014
58. Gjykata Themelore në Gjiilan, vendimi nr. 47/13, datë 27.11.2013
59. Gjykata Themelore në Gjiilan, vendimi nr. 31/13, datë 15.05.2013
60. Gjykata Themelore në Gjiilan, vendimi nr. 20/13, datë 29.04.2013
61. Gjykata Themelore në Gjiilan, vendimi nr. 4/14, datë 25.04.2014
62. Gjykata Themelore në Gjiilan, vendimi nr. 7/13, datë 06.08.2013
63. Gjykata Themelore në Gjiilan, vendimi nr. 32/13, datë 15.05.2013

64. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 1922, datë 18.01.2016
65. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 1924, datë 18.01.2016
66. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 9536, datë 18.01.2016
67. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 3109, datë 15.01.2016
68. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 1894, datë 14.01.2016
69. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 1799, datë 13.01.2016
70. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 1990, datë 15.01.2016
71. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 35, datë 14.01.2016
72. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 68, datë 15.01.2016
73. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 5936, datë 25.05.2016
74. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 3720, datë 25.05.2016
75. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 4747, datë 25.05.2016
76. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 1774, datë 25.05.2016
77. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 4397, datë 28.05.2016
78. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 7159, datë 28.05.2016
79. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 4428, datë 28.05.2016

80. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 4110, datë 15.01.2016
81. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor në Tiranë, vendimi nr. 1689, datë 13.01.2016
82. Gjykata Supreme e Kosovës, Përgjigje, GJA nr. 94/13, 2013 Prishtinë
83. Procesverbali i hartuar ne fshatin Sibovc-Podujevë, Kosovë, 18.11.2011
84. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1181/13, i datës 10.09.2015

VENDIMET E GJEDNJ-së :

1. Schalk & Kopf k. Austrisë (N.301141/04)
2. Chapin & Charpentier k. Francës (N.40183/07)
3. Schalk & Kopf k. Austrisë (N.301141/04)
4. Oliari e të tjerë k. Italisë (N.142394/3)
5. 194 Konig kundër Gjermanisë, GjEDNJ, aktgjykimi i 28 qershorit 1978.
6. 195 H kundër Francës, GjEDNJ, aktgjykimi i datës 24.10.1989.

GAZETAT DITORE

1. *Zëri*, Prishtinë, 2013